# FILMI

## NË MËSIMDHËNIE

MANUALI I BIBLIOTEKËS DIGJITALE PËR MËSIMDHËNËSIT

# PARATHËNIE

Sfida kryesore e departmanetit tonë të edukimit që menaxhon Qendrën e Produksionit të Filmit për të Rinjë dhe fuqizon mësimdhënësit në përdorimin e mjeteve audio-vizuele në procesin mësimor ishte adoptimi në një realiteti të ri që u krijua si rezultat i pandemisë globale.

Projekti ynë 'Edukim për Barazi' përkrahur nga "Programi i shoqërisë civile për Kosovë dhe Shqipëri" i financuar nga Ministria e Punëvë të Jashtme të Norvegjisë dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) në bashkëpunim me Partnerët shqiptarë për Zhvillim dhe Ndryshim (PA) kishte paraparë një seri të aktivitetetve fizike që do të krijonte mundësi për mësimdhënës të aplikojnë integrimin e mjeteve audiovizuale në procesin mësimor.

Por, pandemia ndryshoj gjithçka! Nuk na ndali, por na solli në një situatë ku i tërë ekipi i DokuFest filloj të hulumtonte zgjidhje në mënyrë që të krijohen kushte për mësimdhënësit dhe shkollat të vazhdojnë me aktivitete nga distanca. Këtu edhe lindi ideja e dizajnimit të Bibliotekës Digjitale të Mësimdhënësit e cila së pari u testua në Gjimnazet në Prizren, Gjakovë, Gjilan dhe Lipjan, dhe gjatë këtyre testimeve lindi ideja për metodologjinë e punës që do të krijonte hapësirë për mësimdhënës të ofrojnë programe të begatshme të filmave dokumentarë të karakterit edukativ nxënësve të tyre dhe njëkohësisht të krijojnë materiale didaktike në përputhje të plotë me Kornizën Kurrikulare të Republikës së Kosovës.

Mënyra e re e mësimdhënies në kushtet e imponuara nga pandemia COVID-19 na inkurajoi që të organizojmë më shumë seanca konsultuese me mësimdhënës,

drejtor të shkollave, akademinë, por edhe me vet nxënës dhe prindërit e tyre. Sipas tyre, përdorimi i filmit në klasë ka sjell përfitime të shumëfishta. Përveç zhvillimit të të menduarit kritik dhe inkurajimit të perspektivave jo-konvencionale që vijnë si rezultat i diskutimit kritik të ngjarjeve historike, përdorimi i tij ndihmon në krijimin e forumeve të pavaruara për diskutim dhe shkëmbim të ideve. Biblioteka Digjitale e Mësimdhënësit krijoj një platformë të pavarur për mësimdhënës të kenë qasje në filma dhe materiale përcjellëse arsimore dhe u ndihmojnë atyre ta bëjnë një orë mësimore më interesante dhe interaktive dhe njëkohësisht t'i ndihmojnë nxënësit e tyre të zhvillojnë njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet dhe prirjet që janë të domosdoshme për një shoqëri demokratike.

Ky botim është një përmbledhje e punës së paldhshme të mësimdhënsve që kanë krijuar materiale didaktike për përdorimin e filmit në klasë, një burim që neve në DokuFest na bënë shumë krenarë dhe na bënë të besojmë që arsimi në Kosovë ka potencial për ndyshime pozitive nëse bashkohen forcat e të gjithë neve që dëshirojmë një shoqëri të shëndoshë dhe prograsive.

Kjo hyrje u dedikohet të gjithë mësimdhënësve që kanë marrë pjesë në këtë program, profesorëve nga Departamenti i Psikologjisë në UP, nxënësve dhe prindërve që kanë besuar në këtë qasje inovative, dhe kolegëve të departamentit DokuLab, puna e të cilëve edhe në projektet tjera ka kontribuuar në publikimin e këtij doracaku.

Eroll Bilibani
Udhëheqës i programit DokuLab
DokuFest



përmbajtja


TIK 6-23

EDUKATË QYTETARE 24-43

GJEOGRAFI 48-51

FILOZOFI 44-47

GJUHË ANGLEZE 52-87

GJUHË SHQIPE 88-109

HISTORI 110-113

PSIKOLOGJI 114-159

SOCIOLOGJI 160-189



**Autorët e fletave të punës:**
Arbnesha Kusari,
Ardian Sallauka,
Beqir Mustafa,
Blerta Shehu,
Driton Mallaku,
Fatlume Hyseni,
Feride Thaçi,
Gentian Berisha,
Gyltene Isufi,
Jehona Luma-Reçica,
Jeta Rexha,
Kujtesa Salihu-Keka,
Litvane Spahija,
Merita Shala,
Nuhi Kuçi,
Sabina Halili-Dishallari,
Selvete Poniku.

**Bashkëpunëtorët:**
Associate Professor, Zamira Hyseni Duraku, PhD,
Prof. Ass. Kaltrina Kelmendi, PhD,

Albulena Murturi
Aurela Berisha
Dafina Arifi
Ermelindë Hoti
Eurisa Rukovci

**Ekipi i DokuLab:**
Eroll Bilibani
Malbora Krajku
Dren Shporta
Idriz Morina

**Dizajni dhe kopertina:**
Ersa Karahoda
Linda Dobroshi



skano këtu!

https://dokufest-lab.com/al/mesimdhenesit/tik

# TIK

Filma dokumentarë dhe materiale didaktike për lëndën e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit



Njësia mësimore

Navigimi në internet, Shërbimet e internetit.

# Anonymus

**Regjia: Vese Kelmendi & Eroll Bilibani**

Përgatitur nga
Litvane Spahija, SH. M. "Hajdar Dushi" Gjakovë

## Përshkrimi i filmit

Filmi rrëfen ngjarje të vërtetë të përjetuar nga përsonazhet e filmit: Anonimus dhe motra e tij. Si gjashtëmbëdhjetë vjeçare motra e Anonimus filloi rrugëtimin e saj të përjetimeve që rrallë kush i përjeton. Ajo bie viktimë e një mashtrimi duke u martuar së pari në moshë shumë të re e pastaj mashtrohet për të shkuar së bashku me burrin e saj në Siri për çka nuk ka qenë e informuar familja e saj e as vëllau i saj i cili këtë ikje të motrës e përjetoi shumë keq. Ajo nga martesa e parë lind një djalë dhe menjëherë i vritet burri në konfliktet në Siri. Detyrohet të martohet për të dyten herë vetëm e vetëm për të mos u izoluar në kampin e vejushave, në të cilin kamp nuk i lejojnë të komunikojnë me internet me familjarë, d.m.th. i izolojnë komplet nga bota. Edhe me burrin e dytë lind një fëmijë.

Ndodh që kërkon nga vëllau të holla për t'u kthyer në Kosovë, por mashtrohet dhe mbyllet në një kamp në Siri. Komunikimi me internet me vëllaun bëhet gjithnjë e me i vështirë dhe në sekuenca të caktuara të filmit, vërehet që përgjohet nga njerëz keqbërës. Kërkimi në internet për të gjetur kampin në të cilin e kanë mbyllur motren e Anonimus-it e orienton vendndodhjen e saj pasi që edhe pse kanë komunikuar me internet asnjëhërë nuk e ka bërë të ditur. Ndodh papritur pas një kohe të gjatë që motra e lajmëron vëllaun për kthimin e saj. Ajo i shkruan: "Po na kthejnë". Në prill të vitit 2019, 110 përsona qytetarë të Kosovës, të cilët ishin në zonat e konfliktit në Siri u kthyen në Kosovë 32 gra dhe 74 fëmijë. Filmi mundet të shikohet dhe të ndahet me nxënës rreth disa temave, njësive të ndryshme mësimore në fusha dhe lëndë të ndryshme. Unë e kam përzgjedhur që nxënësve t'iu shfaqi filmin Anonimus për realizimin e njësisë mësimore Navigimi në internet, ndërsa mund të shfaqet edhe për njësinë mësimore: Kërkimi në internet-Motorrët kërkues.

## Fushat e kurrikulës

Jeta dhe Puna

## Përshtatshëm për

Shkalla 5, 6. Klasa: X, XI, XII

## Kompetencat

I. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit – Komunikues efektiv (Përdor në mënyrë efektive programet e TIK-ut gjatë procesit të nxënies duke përfshirë edhe të nxënit në distancë, kryerjes së detyrave në një fushë të caktuar mësimore dhe prezantimit për auidiencave të ndryshme).
II. Kompetenca e të menduarit - Prezanton mënyrën e grumbullimit, të zgjedhjes dhe të klasifikimit të informatave për fusha të ndryshme mësimore apo për një temë të caktuar, ofron argumente për zhvillimet aktuale lidhur me temën përkatëse (p.sh., temë nga shkenca, kultura, arti, sporti, shëndetësia, shoqëria, mjedisi etj.).
III. Kompetenca e të nxënit – Nxënës i suksesshëm (Parashtron pyetje dhe shfaq mendime të strukturuara për zgjidhjen e një problemi apo detyre të një teme të caktuar, bën përmbledhjen e së paku dy veprimeve të përdorura të cilat përcaktojnë drejtimin e mëtejmë të të nxënit të vet për temën apo problemin e caktuar).

## Objektivat

Zhvillimi i përgjegjësisë ndaj vetes, ndaj të tjerëve, ndaj shoqërisë dhe ndaj mjedisit;
• Aftësimi për jetë dhe për punë në kontekste të ndryshme shoqërore e kulturore;
• Zhvillimi i ndërmarrësisë dhe përdorimi i teknologjisë për zhvillim të qëndrueshëm;
• Aftësimi për mësim gjatë gjithë jetës.

## Pikat e diskutimit

Çka është interneti?
Çka kuptoni me web-in, world wide web?
Çka ofron interneti, të ceken shërbimet e internetit?
Cila është përparësia kryesore e telefonisë në internet?
Për çfarë shërben File Transfer Protocol?
Çfarë pajisje hardverike dhe softverike na nevojiten për relizimin e komunikimit me mesazhe me internet?
Të interpretohen shërbimet e komunikimit psh. posta elektronike, telnet, newsgroup, Telefonia me internet VoIP, mesazhet e momentit-instant messaging etj.
Numëro perfitimet që na sjell komunikimi me internet.

## Aktivitetet

**Hapi I: Evokim - Stuhi mendimesh,**
Diskutohet me nxënës për internetin, navigimin në internet, shërbimet e internetit. Japin disa shembuj të navigimit në faqe të ndryshme dhe të sigurta në internet, shembuj nga ajo se çka dinë rreth temës.
**Hapi II: Rrjeti i Diskutimit (20 min)**
Pas mbarimit të filmit nxënësve u kërkohet të shfletojnë librin në njësinë mësimore "Navigimi në internet- shërbimet e internetit" dhe pastaj diskutojnë për pikat e diskutimit që janë të parapara më lartë, duke ju referuar filmit të shfaqur "ANONIMUS".
**Hapi III: Reflektim: Diskutim (5 min)**
Duke reflektuar rreth njohurive të përfituara gjatë kësaj ore mësimore, mësimdhënësi nxit në klasë një diskutim, ku pyet nxënësit nëse kanë diçka për të diskutuar për sjelljen e tyre si përdorues të internetit, rreth përdorimit të softverëve në kohë reale për komunikimin në largësi, përparësive dhe mangësive, etj. Nxënësit diskutojnë dhe argumentojnë mendimet e tyre duke sjellë shembuj konkretë nga jeta e përditshme dhe nga njohuritë e tyre si përdorues aktual të rrjeteve sociale, shërbimeve të ndryshme dhe navigimeve në faqe të shumta të world wide web.



Njësia mësimore

Interneti.

# Blinera n'rrjet

Regjia: Laberion Nitaj

Përgatitur nga
Litvane Spahija, SH. M. "Hajdar Dushi" Gjakovë

## Përshkrimi i filmit

Së pari, dije që nuk je i vetmi në këtë udhëtim. Mediat sociale kanë marrë mendjet e shumë vetave dhe tani është bërë qëllimi i jetës së adoleshentëve në të gjithë botën për ta bërë ushqimin e tyre sa më mahnitës. Ndonjëherë është në të vërtetë një mënyrë e mirë për të shprehur krijimtarinë. Ideja e mediave sociale, në përgjithësi, është një koncept i shkëlqyeshëm dhe një mënyre e mirë për të shprehur krijimtarinë. Problemi qëndron kur ne fillojmë të konsumohemi me sa pëlqime ose komente marrim në një postim.

Përfytyroni këtë: ju dhe familja juaj jeni në një pushim të bukur. Sapo keni blerë veshje të reja që mezi prisni të bëni fotografi në mënyrë që të mund të postoni fotografi në to. E gjitha është interesante dhe madhështore, por më pas kur më në fund postoni atë fotografi, e shihni veten duke vështruar telefonin tuaj, duke rifreskuar vazhdimisht faqen për të parë se sa pëlqime keni marrë në 10 minuta.

Nëse ai numër nuk është së paku ta zëmë 50, atëherë jeni i bindur që duhet ta fshini foton: MENJËHERË. Atëherë mendoni me veten tuaj se fotoja është shumë e mirë për t'u humbur, kështu që mbase mund të provoni ta ripostoni në një kohë tjetër kur ndjekësit tuaj janë më aktivë. Ajo që ka ndodhur me ju është që tani i keni kaluar të gjitha pushimet tuaja duke u përqëndruar në një aplikacion. Mirëpo menjëherë pas këtyre mendimeve e mbyllim aplikacionin, duke e hapur vetëm pas tre minutave më vonë.
Për disa arsye, ne e kemi regjistruar asi soji në kokë që nëse fotoja jonë nuk merr të paktën një numër të caktuar të pëlqimeve, atëherë ne kemi gabuar diku.
Nëse ne do të merrnim të gjithë energjinë që përdorim për t'u brengosur nëse do t'I bënim rrjetet tona sociale tona kaq të përsosura dhe ta shpenzonim këtë energji në qëllimet dhe aspiratat tona në jetë, atëherë imagjinoni sa të suksesshëm do të kishim qenë.

## Fushat e kurrikulës
Jeta dhe Puna, Gjuhët dhe Komunikimi, Shoqëria dhe Mjedisi, Shkencat e Natyrës.

## Përshtatshëm për
Shkallën 5 dhe 6 të Kurrikulës së Kosovës, Klasa X dhe XI.

## Kompetencat
Kompetenca e komunikimit dhe të të shprehurit - Komunikues efektiv
Kompetenca e të menduarit - Mendimtar kreativ
Kompetenca e të nxënit - Nxënës i suksesshëm

## Objektivat
Pyetje dhe përgjigje për temën e dhënë në njërën nga format e të shprehurit.

Bashkëpunon me të tjerët pavarësisht prejardhjes, aftësive dhe nevojave të veçanta për arritjen e një qëllimi të përbashkët në aktivitet në klasë/shkollë apo jashtë saj.

Identifkon vlera shoqërore që kultivohen në klasë, shkollë apo familje si p.sh., besimin e ndërsjellë, tolerancën, solidaritetin, respektin, mirësjelljen etj

## Pikat e diskutimit

Çka është interneti?
Çka ofron interneti, të ceken shërbimet e internetit?
Çka mund të bëni në internet konkretisht të ceken veprimet qe mundeni t'i kryeni në internet?
Sa mendoni që ka dobi shfytëzimi i internetit dhe të ceken disa prej tyre?
Nëse mendoni se ka mangësi shfrytëzimi i internetit të numërohen ato mangësi?
A mund të menagjoni kohën dhe mënyren e perdorimit të rrjeteve sociale për të minimizuar dëmët që i shkakton përdorimi jo i drejtë i tyre?
Sa përmbajnë lajme të rreme "fake", rrjete sociale dhe si ndikojnë ato te ju?

## Aktivitetet

### Evokim
Diskutohet me nxënës për përdorimin e internetit. Japin disa shembuj të përdorimit të rrjeteve sociale, navigimit në faqe të sigurta në internet.

### Rrjeti i diskutimit
Pas mbarimit të filmit nxënësve u kërkohet të shfletojnë librin në njësinë mësimore "Përparësitë dhe mangësitë e internetit" dhe pastaj diskutojnë për pikat e diskutimit që janë të parapara më lartë, duke ju referuar filmit të shfaqur "BLINERA N'RRJET" (shënohen në tabelë)



Kujdesi ndaj përdorimit të teknologjisë informative nga njeriu

# Devolucion

**Regjia: Endri Maloku**

Përgatitur nga
Litvane Spahija, SH. M. "Hajdar Dushi" Gjakovë

## Përshkrimi i filmit

Një shpirt i zbrazët është fotografuar përmes syve të Lorisit dhe botës së jashtme. Një nëntë vjeçar portretizon monotoninë e një jete të vazhdueshme pas një ekrani. Armët, dhuna që ai dëshmon gjatë ditës padyshim se po e prek atë në shëndetin mendor dhe fizik. Trashja, lidhja shoqërore, depresioni, vazhdimisht po rriten tek ai. Sidoqoftë, kur ai futet në stërvitjen e futbollit gjithçka ndryshon. Gjithçka bëhet reale. Por, rutina e tërheq atë përsëri në boshllëk.

Në ballafaqim me këtë botë përfshihen edhe varësia dhe sjelljet anti sociale. Në çdo moment të rinjtë dhe fëmijët janë të preokupuar me teknologjinë. Lojërat kompjuterike ndryshe i bëjnë të rinjtë, fëmijët aq të varur sa që nuk munden lehtë të dominojnë këtë varësi pa ndihmen e prindit apo përsonave përgjegjës.

Filmin ua shfaqi nxënësve me qëllim që ata të analizojnë sjelljet e tyre duke i krahasuar me sjelljet e personazhit të filmit Lorisit. Arsye kryesore është që të këshillohen se si duhet të vetëdijësohen, menaxhojnë kohën e përdorimit të video lojërave dhe lojërave kompjuterike në internet.

## Fushat e kurrikulës
Jeta dhe puna

## Përshtatshëm për
Shkalla V; Klasa: X, XI

## Kompetencat
I. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit – Komunikues efektiv (Përdor në mënyrë efektive programet e TIK-ut gjatë procesit të nxënies (duke përfshirë edhe të nxënit në distancë), kryerjes së detyrave në një fushë të caktuar mësimore dhe prezantimit për auidienca të ndryshme)
II. Kompetenca e të menduarit - (1. Prezanton mënyrën e grumbullimit, të zgjedhjes dhe të klasifikimit të informatave për fusha të ndryshme mësimore apo për një temë të caktuar, ofron argumente për zhvillimet aktuale lidhur me temën përkatëse (p.sh., temë nga shkenca, kultura, arti, sporti, shëndetësia, shoqëria, mjedisi etj.); 2. Krahason të paktën tri burime të ndryshme të informimit për trajtimin e temës së njëjtë, argumenton saktësinë, rrethanat, gjen ngjashmëritë dhe dallimet, duke u bazuar në kriteret e përcaktuara më parë, i prezanton gjetjet kryesore para të tjerëve në forma të ndryshme shprehëse, duke përdorur teknologjinë informative)
III. Kompetenca e të nxënit – Nxënës i suksesshëm (6. Shfrytëzon në mënyrë të pavarur dhe efektive teknologjinë informative dhe burime të tjera të informimit për të mbledhur materiale për zgjidhjen e një problemi apo detyre të caktuar, të cilat më pas i analizon, i klasifikon dhe i paraqet para të tjerëve përmes TIK-ut dhe ndonjë forme tjetër të shprehjes)

## Objektivat
Zhvillimi i përgjegjësisë ndaj vetes, ndaj të tjerëve, ndaj shoqërisë dhe ndaj mjedisit;
Aftësimi për jetë dhe për punë në kontekste të ndryshme shoqërore e kulturore;
Zhvillimi i ndërmarrësisë dhe përdorimi i teknologjisë për zhvillim të qëndrueshëm;
Aftësimi për mësim gjatë gjithë jetës.

## Pikat e diskutimit
Çka dini për paisjet teknologjike, spektrin e përdorimit të tyre? A kemi siguri dhe privatësi sa jemi duke blerë online apo duke luajtur lojëra kompjuterike online? Si ndikon përdorimi i paisjeve teknologjike në shëndetin e njeriut? Si ndikon përdorimi i tepruar i paisjeve teknologjike në të pamurit? A ka ndikim përdorimi i tepruar i paisjeve teknologjike në demtimin e boshtit kurrizor, sidomos te fëmijët dhe të rinjtë pasi dihet që janë në zhvillim?
Çka mendoni rreth sjelljes asociale, sjelljes agresive të përdoruesve të internetit dhe lojërave kompjuterike brenda dhe jashtë familjes, në shoqëri. Mendoni që këto sjellje janë rezultat i përdorimit të pakontrolluar të internetit? A mendoni që përdorimi i paisjeve teknologjike të avansuara në industri të ndryshme, ndikon edhe në zvogëlimin e vendeve të punës?
Një fëmijë nësë luan vazhdimisht lojëra kompjuterike në internet, mendoni që mundet në mësime të jetë shumë i koncentruar? Çka mund të bëjmë që të evitojmë në masë të madhe ndikimet negative gjatë përdorimit të teknologjisë informative?

## Aktivitetet
### Evokim - Stuhi mendimesh,
Nxënësve ju bëhet pyetja se çka dinë rreth temës: -Përdorimi i paisjeve teknologjike në ditët e sotme; -Për çka i përdorim më tepër dhe sa i përdorim?; Nxënësit inkuadrohen në diskutim rreth çështjes së shtruar nga mësimdhenësi/ja, duke u shprehur nga aspekti i praktikës së tyre.
### Rrjeti i Diskutimit (20 min.)
Pas mbarimit të filmit nxënësve u kërkohet të shfletojnë librin në njësinë mësimore "Kujdesi ndaj përdorimit të teknologjisë informative nga njeriu" dhe pastaj diskutojnë për pikat e diskutimit që janë të parapara më lartë, duke ju referuar filmit të shfaqur "Devolucion".
### Reflektim: Diskutim (5 min)
Duke reflektuar rreth njohurive të përfituara gjatë kësaj ore mësimore, mësimdhënësi nxit në klasë një diskutim, ku pyeten nxënësit nëse kanë diçka për të diskutuar për sjelljen e tyre si përdorues të paisjeve të ndryshme të teknologjisë informative duke filluar nga kompjuteri, tabletët, telefonët e mençur e tjera paisje. Diskutohet rreth përdorimit të softverëve për lojëra komjuterike, përparësive dhe mangësive.



Njësia mësimore

Multimedia, krijimi i sekuencave multimediale. Insertimi i sekuencave muzikore dhe insertimi i video sekuencave.

# Fmi i Hanës

**Regjia: Ajshe Gashi, Diellza Bylygbashi**

## Përshkrimi i filmit

Përgatitur nga
Litvane Spahija, SH. M. "Hajdar Dushi" Gjakovë

Në filmin Fmi i Hanës në sfond ndëgjohet muzika e cila është sinkronizuar shumë bukur me sekuencat filmike sipas stories filmike.

Muzika e Muharrem Qenës "Oj Hanë" dhe Shpat Deda "Shkëndije" e bën që audienca të ketë një kënaqësi të madhe gjatë shikimit të këtij filmi. Gjatë krijimit tetë-mujor të Zgjimit ai është vizituar nga një mik mikroskopik. Ky mik bëhet shoku i tij më i mirë dhe Zgjimi vendos ta çojë në Jetë. Ky mik në Jetë quhet një kromozom shtesë. Si mirënjohje, ky "mik" i dha Zgjimit fytyrën më të prerë dhe buzëqeshjen më të bukur në botë.

Pra, filmi tematikë kryesore e ka përditshmërinë e një fëmiu me sindromin down ku motra e tij shpalos para audiencës momente tepër të veçanta të kësaj përditshmërie.
Hyjnore është pamja e Zgjimit me sy si një pyll në mes të detit. Karakteri tepër i veçantë i Zgjimit si djalë me dëshira e me ëndrra si gjithë fëmijët tjerë, por që e karkterizon një sinqeritet fëmijëror i paparë që i bën të gjithë që janë afër tij të ndihen ashtu fëmijëror, të dashur e pabrenga.

## Fushat e kurrikulës
Shoqëria dhe Mjedisi

## Përshtatshëm për
Shkalla 5. Klasa X, XI.

## Kompetencat
I. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit – Komunikues efektiv;
II. Kompetenca e të menduarit – Mendimtar kreativ;
III. Kompetenca e të nxënit – Nxënës i suksesshëm;
IV. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis – Kontribues produktiv

## Objektivat
· Zhvillimi i përgjegjësisë ndaj vetes, ndaj të tjerëve, ndaj shoqërisë dhe ndaj mjedisit;
· Aftësimi për jetë dhe për punë në kontekste të ndryshme shoqërore e kulturore;
· Zhvillimi i ndërmarrësisë dhe përdorimi i teknologjisë për zhvillim të qëndrueshëm;
· Aftësimi për mësim gjatë gjithë jetës.

## Pikat e diskutimit

Çka është audio fajlli dhe si realizohet? Të tregohet ekstenzioni-prapashtesa e një audio fajlli?
Tregoni konkretisht ndonje softver që mundëson realizimin e audio sekuencës.
Çka është video fajlli dhe si realizohet?
Të numërohen paisjet hardverike që e mundësojnë praktikisht realizimin e audio dhe video sekuencave si dhe sinkronizimin e tyre në një film të vetëm.
Sa mendoni që ka dobi shfytëzimi i sekuencave muzikore dhe të ceken disa prej tyre?

## Aktivitetet

### Hapi I: Evokim - Stuhi mendimesh,
Diskutohet me nxënës për: Çfarë është multimedia? Shtrohet për diskutim: - Çka dini për multimedia? - Keni njohuri se si krijojmë multimedia? - Çka na mundëson krijimin e multimedias? Japin disa shembuj të përdorimit sekuencave multimediale dhe softverë që mundësojnë krijime të tilla.

### Hapi II: Realizim (20 min)
Nxënësve u ipen instruksione praktike se si bëhet realizimi i krijimeve multimediale, insertimet audio dhe video fajllave. Instrukcionet ipen me aplikacione dhe softerë si: Filmora dhe MS Officce Power Point. Ora mësimore relizohet në kabinet të informatikës duke përdorur PC, projektor dhe zmadhues zëri. Nxënësit praktikojnë në kompjuterët e tyre dhe punojnë individualisht ose në grup nga dy nxënës.

### Hapi III: Reflektim: Diskutim (5 min)
Pyetën nxënësit nëse kanë diçka për të diskutuar rreth krijimit dhe përdorimit të mutimedias, për vështirësitë dhe sfidat që mund të shfaqen gjatë dizajnimeve praktike multimediale, etj



Njësia mësimore

Multimedia.

# Kjo është Tringa

**Regjia: Tringa Berisha**

## Përshkrimi i filmit

Përgatitur nga
Litvane Spahija, SH. M. "Hajdar Dushi" Gjakovë

Media sociale është një mjet që po bëhet mjaft popullor këto ditë për shkak të veçorive të tij miqësore, mirëpo a po miqësohemi edhe në realitetin ku po jetojmë? Kjo është historia e Tringës që ka vendosur ta ndajë me shumë njerz e që në ditët e sotme shumë nxënës të tjerë përjëtëojnë të njejtat ngjarje me të e duke mos mundur që të flasin rreth këtyre temave.

Nga ajo që shohim në mediat sociale, shumë të rinjëve u imponohet që në moshë të re që të mendojmë se ekziston vetëm një tip ideal i trupit, jemi të bombarduar me imazhe të jetës perfekte, por jo gjithmonë duhet t'a besojmë atë që na ofrohet përpara nesh. Duhet të kuptojmë se pas këtyre fotografive që shohim 'online' shumicën e kohës pas tyre fshihen trajnerë personal, dieta të planifikuara, artist grimi, stilist dhe veçanërisht armiku më i madh i vetëbesimit: Photoshop!

E gjithë bota është në majë të gishtave tanë të gjitha falë mediave sociale. Rinia është veçanërisht një nga përdoruesit më dominues të mediave sociale, andaj duhet të kemi kujdes si ju drejtohemi atyre. E gjithë kjo të bën të pyesësh se diçka kaq e fuqishme dhe me një shtrirje kaq masive nuk mund të jetë e gjitha e mirë. Ashtu si ka gjithmonë dy anë të një monedhe, e njëjta gjë vlen edhe për mediat sociale.

## Fushat e kurrikulës
Jeta dhe Puna, Gjuhët dhe Komunikimi, Shoqëria dhe Mjedisi, Shkencat e Natyrës.

## Përshtatshëm për
Shkallën e 5 dhe 6 të Kurrikulës së Kosovës, klasa X dhe XI. Mundet të përdoret edhe në shkallën 4.

## Kompetencat
I. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit (Ritregon ngjarjen e një teksti të dëgjuar nga mjetet auditive, audiovizuale apo nga mësimdhënësi; Shpreh për 3-5 minuta para moshatarëve dhe të tjerëve përjetimet dhe emocionet që e kanë shoqëruar gjatë shikimit të filmit "THIS IS TRINGA", rreth mënyrës së realizimit të filmit të shikuar.
II. Kompetenca e të menduarit (Parashtron pyetje dhe u përgjigjet pyetjeve për temën/problemin/ e dhënë në njërën nga format e të shprehurit)
III. Kompetenca personale (Bashkëpunon me të tjerët pavarësisht prejardhjes, aftësive dhe nevojave të veçanta për arritjen e një qëllimi të përbashkët në aktivitet në klasë/shkollë apo jashtë saj)
IV. Kompeteca qytetare (Identifkon vlera shoqërore që kultivohen në klasë, në shkollë apo në familje si p.sh., besimin e ndërsjellë, tolerancën, solidaritetin, respektin, mirësjelljen etj.).

## Objektivat
Kjo njësi mësimore mundëson që të prezentohet para nxënësvë sekuenca filmike, krijimi i sekuencave filmike, bashkangjitja e titrave, zërit - audio sekuencës dhe sekuencës vizuele. Instrument për arritje të qëllimit të orës mësimore është përdorur filmi i shkurtër dokumentar THIS IS TRINGA, i cili mund të shfaqet gjatë orës mësimore, ose mund të dërgohet linku te nxënësit si detyrë që ta shikojnë paraprakisht në shtëpi.

## Pikat e diskutimit
Cili program aplikativ mundëson realizimin e një filmi të tillë?
Cilat paisje mundësojnë krijimin e sekuencës filmike, numëro disa paisje të tilla?
Si mendoni që realizohet insertimi i fajllave audio në sekuencat filmike?
A është e mundur që të realizohet insertimi i titrave filmike, nëse po si bëhet insertimi i tyre?
Si mendoni se është bërë sinkronizimi i zërit videos dhe titrave në këtë film?
Të spjegohet se siështe realizuar hap pas hapi realizimi i filmit të shikuar?

## Aktivitetet
### Evokim
Në fillim të mësimore pyesim nxënësit se çfarë njohurie kanë për sekuencën filmike dhe realizimin e sekuencës filmike. Bëjmë një hyrje të shkurtër dhe shkëmbejmë pyetje dhe përgjigje rreth asaj se çka kemi në fokus. Më pas shikojmë filmin.

### Realizim
Ditari dy pjesësh Reflektim -Pas përfundimit të filmit marrim mendimet e përgjithshme për filmin, më pastaj nxënësit i informojmë për referencat që do të marrin në lidhje me filmin, ku do të kenë mundësinë të shënojnë në fletë ndonjë detaj nga ajo që shohin, që do të ju shërbej si pikë reference për diskutim. Ndahen në dy grupe dhe shënojnë pikat e diskutimit që do të realizohen.

### Reflektim
Pyeten nxënësit nëse kanë diçka për të diskutuar për aplikimit dhe realizimit të sekuencave filmike, vështirësive që hasen gjatë krijimit dhe këshillat që duhet t'u permbahen rreth fajllave multimedial, etj.



Njësia mësimore

MS Office Power Point. Krijimi i një prezantimi të ri bazuar në Templates.

# Këta jemi ne

**Regjia: Arta Elezi**

## Përshkrimi i filmit

Përgatitur nga
Litvane Spahija, SH. M. "Hajdar Dushi" Gjakovë

Një dokumentar për një familje që synon t'i tregojë audiencës se jo çdo gjë që shohim në sipërfaqe është e vërtetë. Shpesh ka gjëra të fshehura pas një buzëqeshjeje dhe fytyreje të lumtur dhe jo çdo gjë është ashtu siç duket. Tek e fundja, shpesh herë ngatërrojmë kripën për sheqer.

"Një fotografi thonë vlenë sa njëmijë fjalë"- Paramendoni sa vlenë një album i fotografive. Albumin e fotografive na e ofron të gatshëm libraria e programit aplikativ të paketës së MS Office Power Point. Pasi t'a marrim të gatshëm, shfrytëzuesit i mbetet vetëm vendosja e fotografive personale, familjare etj.

Nga ky film nxënësi motivohet të praktikojë edhe individualisht të zbatojë në praktikë prezentimet e gatshme te programit Power Point pasi që filmi flet për rrugëtimin e familjes shqipëtare, copëza historie të kësaj familjeje përmes albumit të fotografive familjare dhe video inçizimeve amatere por shumë të rëndësishme për familjen në fjalë.

## Fushat e kurrikulës
Gjuhë dhe komunikim, Shoqëria dhe mjedisi

## Përshtatshëm për
Shkalla 5, Klasa X

## Kompetencat
I. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit – Komunikues efektiv (Përdor në mënyrë efektive programet e TIK-ut gjatë procesit të nxënies (duke përfshirë edhe
të nxënit në distancë), kryerjes së detyrave në një fushë të caktuar mësimore dhe prezantimit për auidienca të ndryshme)
II. Kompetenca e të menduarit (Modelon zgjidhjen e një problemi të dhënë (në klasë, apo jashtë saj) për një temë të caktuar nga një fushë mësimore, duke e zbërthyer në hapa të vegjël dhe jep sqarime të nevojshme për hapat e ndjekur në zgjidhjen e problemit, duke përdorur forma të ndryshme të të shprehurit)
III. Kompetenca e të nxënit – Nxënës i suksesshëm (Shfrytëzon në mënyrë të pavarur dhe efektive teknologjinë informative dhe burime të tjera të informimit për të mbledhur materiale për zgjidhjen e një problemi apo detyre të caktuar, të cilat më pas i analizon, i klasifikon dhe i paraqet para të tjerëve përmes TIK-ut apo ndonjë forme tjetër të shprehjes)
IV. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis (Harton një projekt (individualisht ose në grup) për organizimin e një aktiviteti me karakter edukativ brenda ose jashtë shkollës, në të cilin identifikon dhe vlerëson resurset e nevojshme njerëzore dhe materiale që mundësojnë arritjen e objektivave të caktuara)

## Objektivat
Zhvillimi i përgjegjësisë ndaj vetes, ndaj të tjerëve, ndaj shoqërisë dhe ndaj mjedisit;
Aftësimi për jetë dhe për punë në kontekste të ndryshme shoqërore e kulturore;
Zhvillimi i ndërmarrësisë dhe përdorimi i teknologjisë për zhvillim të qëndrueshëm;
Aftësimi për mësim gjatë gjithë jetës.

## Pikat e diskutimit
Çka është prezentimi i ri në Power Point dhe si e krijojmë?
Çka kuptoni me prezentim te gatshëm template dhe si e aktivizojmë?
Çka ofron foto albumi i gatshëm në MS Power Point?
Si mundeni me e realizu një shabllon-template të gatshëm duke u bazuar në një temë të caktuar?
Numëro perfitimet që na sjell insertimi i një prezentimi te gatshëm template.

## Aktivitetet
**Hapi I: Evokim - Stuhi mendimesh,**
Diskutohet me nxënës rreth krijmit të prezantimit: 1. Si krijohet një prezantim në PowerPoint ? 2. Nëse dëshirojmë të krijojmë me shembuj të gatshëm, si mund ta realizojmë atë? Japin disa shembuj të projekteve që kanë pasur rastin të punojnë në lëndët e caktuara, shembuj nga ajo se çka dinë rreth temës.
**Hapi II: Rrjeti i Diskutimit (20 min)**
Pas mbarimit të filmit mësimdhënësi/ja demonstron krijimin e shembujve të prezantimeve përmes atyre të gatshme dhe pastaj diskutojnë për pikat e diskutimit që janë të parapara më lartë, duke ju referuar filmit të shfaqur "KËTA JEMI NE". Çka është prezentimi i ri në Power Point dhe si e krijojmë? Çka kuptoni me prezentim te gatshëm template dhe si e aktivizojmë? Çka ofron foto albumi i gatshëm në MS Power Point? Si mundeni me e realizu një shabllon-template të gatshëm duke u bazuar në një temë të caktuar psh. temën e filmit të shikuar si mendoni që e kishit realizuar? Numëro perfitimet që na sjell insertimi i një prezentimi te gatshëm template.
**Hapi III: Reflektim: Diskutim (5 min)**
Nxënësit ndahen në grupe dhe planifikojnë të krijojnë një projekt bashkë. Mund të jetë i lëndëve të ndryshme, por duhet të përcaktojnë modelin adekuat të gatshëm në PowerPoint që plotëson dizajnin, fontin e shkronjave, stilin etj. Gjatë punës praktike mësimdhënësi vëzhgon nxënësit për realizim korrekt. Duke reflektuar rreth njohurive të përfituara gjatë kësaj ore mësimore, mësimdhënësi nxit në klasë një diskutim, ku pyeten nxënësit nëse kanë diçka për të diskutuar për sfidat e tyre gjatë krijimit të prezentimit të gatshëm, përparësive dhe mangësive të një prezentimi të gatshëm etj. Rikujtim i mënyrave të krijimit të tyre, duke cekur menytë, komandat e opcionet e duhura për realizimin e tyre.



Njësia mësimore

MS Office Excel, Funksionet dhe insertimi i tyre.

# Një ditë me fat

**Regjia: Dija Krasniqi, Husamedin Luma**

Përgatitur nga
Litvane Spahija, SH. M. "Hajdar Dushi" Gjakovë

## Përshkrimi i filmit

Një ditë në jetën e Rrahman Beqirit, minator në kompleksin e gjerë industrial afër qytetit të ndarë të Mitrovicës në Kosovë. Beqiri, një veteran i grevës së famshme të vitit 1989 që sinjalizoi shpërbërjen e ish-Jugosllavisë, endet nëpër tunelet e thella të minierave dhe luginave të gjera që e rrethojnë atë, duke kujtuar të kaluarën ndërsa merakoset për të ardhmen e Kosovës.

Rrahmani përshkruan vështirësitë e ditëve të punës së tij dhe kolegëve të tij. Tregon se shumë pasiguri ka të punosh si një minator, deri sa pagesa nuk është e nivelit të përmbushjes së kërkesave të një familje.

Rrahmani tregon se si vet e ka ushtruar këtë profesion tërë jetën e tij, por këtë profesion nuk dëshiron që ta zgjedhë djali i tij, bazuar në ato vështirësi që i ka kaluar e po i kalon edhe në ditët e sotme personalisht së bashku me shokët e tij të punës.

Filmin e kam shqyrtuar në aspektin e tipeve të dhënave në MS Office Excel si dhe llogaritjeve të vlerës mesatare, kalkulimit të pagës së punëtorëve e tjera llogaritje që ofron programi Excel. Prandaj duke e shikuar këtë film nxënësit krijojnë idenë e zbatimit praktik të MS Office Excel-it

## Fushat e kurrikulës
Jeta dhe Puna

## Përshtatshëm për
Shkalla 5, Klasa X

## Kompetencat
I. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit – Komunikues efektiv (Përdor në mënyrë efektive programet e TIK-ut gjatë procesit të nxënies (duke përfshirë edhe të nxënit në distancë), kryerjes së detyrave në një fushë të caktuar mësimore dhe prezantimit për auidienca të ndryshme)
II. Kompetenca e të menduarit (Gjykon vërtetësinë e një rezultati të dhënë (p.sh., rezultatin e një detyre nga matematika, shkencat, shoqëria, mjedisi etj.) i cili mund të jetë gjetur me zbatimin e formulave të njohura ose me përdorimin e procedurave të caktuara dhe nxjerrë përfundime për vërtetësinë e gjykimit të dhënë.
III. Kompetenca e të nxënit – Nxënës i suksesshëm (Zgjidh një problem të caktuar mësimor ose një situatë nga jeta e përditshme. Në bazë të një planifikimi të dhënë dhe në bazë të rezultatit të fituar vërteton saktësinë e planifikimit dhe tregon me shembuj se si do të zbatojë strategjinë e ndjekur edhe në situata dhe kontekste të tjera gjatë të nxënit. Shfrytëzon në mënyrë të pavarur dhe efektive teknologjinë informative dhe burime të tjera të informimit për të mbledhur materiale për zgjidhjen e një problemi apo detyre të caktuar, të cilat më pas i analizon, i klasifikon dhe i paraqet para të tjerëve përmes TIK-ut dhe ndonjë forme tjetër të shprehjes.)

## Objektivat
-Zhvillimi i përgjegjësisë ndaj vetes, ndaj të tjerëve, ndaj shoqërisë dhe ndaj mjedisit;
-Aftësimi për jetë dhe për punë në kontekste të ndryshme shoqërore e kulturore;
-Zhvillimi i ndërmarrësisë dhe përdorimi i teknologjisë për zhvillim të qëndrueshëm;
-Aftësimi për mësim gjatë gjithë jetës.

## Pikat e diskutimit
Çka kuptoni me funksionet?
Çka kuptoni me formulat?
Çka ofron MS Office Excel për kalkulime me funksione në formulat ?
Cila është mënyra se si i aktivizojmë këto veprime?
Si bëhet ekzekutimi i funksioneve elementare?

## Aktivitetet
**Hapi I: Pjesa hyrëse (Stuhi mendimesh)**
Mësimdhënësi/ja paraqet në programin MS Office Excel me projektor, disa praktika me funksionet e paraqitura më poshtë dhe pyet nxënësit se sa kanë njohuri rreth kryerjes së veprimeve me funksionet si më poshtë: Shuma =SUM; Mesatarja =AVERAGE; Minimumi =MIN; Maksimumi =MAX Numërimi i anëtarëve =COUNT; Prodhimi =PRODUCT; Nxënësit ndajnë shkurt përvojat dhe praktikat e deritanishme se si i kanë kryer veprimet e kërkuara deri më tani duke përdorur programin aplikativ Excel.
**Hapi II: Realizimi (20 min)**
Pas mbarimit të filmit nxënësve u kërkohet të aplikojnë llogaritjen e vlerës mesatare, pagës së minatorëve, llogaritjen e ditëve të punës se sa orë pune mesatarisht qëndrojnë në minierë, vlerës së shumës, prodhimit si dhe numërimi i vlerave psh. vlerave të numëruara në situata të ndryshme të shfaqura në filmin e shikuar nga nxënësit. Formulat janë ekuacione të cilat llogarisin vlerat e të dhënave të pasqyruara në fletën e punës. Ndërsa funksionet përdoren për të kryer llogaritje të ndryshme në Excel. Funksionet mund të insertohen në FORMULAS dhe INSERT FUNCTION. Për çdo funksion mësimdhënësi praktikon dhe demonstron në formë vizuale te nxënësit.
**Hapi III: Reflektim: Diskutim (5 min)**
Pas përfundimit të detyrave prezentojnë në klasë dhe diskutojnë rreth rezultateve të detyrave. Duke reflektuar rreth njohurive të përfituara gjatë kësaj ore mësimore, mësimdhënësi nxit në klasë një diskutim, ku pyeten nxënësit nëse kanë diçka për të diskutuar rreth sfidave gjatë përdorimit të funksioneve dhe formulave praktikisht. Nxënësit diskutojnë dhe argumentojnë mendimet e tyre duke sjellur shembuj konkretë. Mësimdhenësi me këshilla praktike ofron ndihmë nxënësve sipas nevojës.



Njësia mësimore

Orientim dhe Këshillim në Karrierë.

# Shtojzovalle

**Regjia: Flutura Balaj**

Përgatitur nga
Litvane Spahija, SH. M. "Hajdar Dushi" Gjakovë

## Përshkrimi i filmit

Shtojzovallet njihen si krijesa të vogla, me një bukuri të jashtëzakonshme e me fuqi të mbinatyrshme. Ato janë krijesa delikate dhe të padukshme e që në pyje e kullota hedhin valle dhe muzike duke jetuar të lira e të gëzuara. Me aftësitë e tyre të mahnitshme, i mundësojnë të fluturojnë gjatë ditës e të rrotullojnë fillin e ekzistencës gjatë natës. Ato shihen nga vetë njerëzit në raste mjaft të rralla.

Pas shekujsh që jetojnë rreth nesh, ata na ftojnë në realitetet e tyre mistike. Duke na lënë të takojmë superfuqitë e tyre, botën e tyre të bukur dhe dëshirën për muzikë, këto Shtojzovalle na ndihmojnë të reflektojmë për mundësitë e humbura që na është dashur të shohim dhe vlerësojmë çdo Shtojzovalle në jetën reale.

Ndoshta ne jo gjithmonë i vlerësojmë aq sa ato e meritojnë, mirëpo ato gjithmonë e ndriçojnë ambientin tonë në mënyrën më unike të vetën e që na ndez të gjithëve atë shojzovallen e vogël brenda nesh! Filmi na bën të fokusohemi dhe të përqëndrohemi në pikat e forta dhe të dobëta tona, në deshirat dhe synimet e qëllimet tona.

Ajo që e bën të veçantë filmin është se në film shtojzovallet analizojnë veten dhe interesat e dëshirat, preferencat dhe vlerat e tyre, analizë kjo që ndërlidhet me fushën "Jeta dhe Puna" Lënden e TIK-ut, modulin e Orientimit dhe Keshillimit në Karrierë.

## Fushat e kurrikulës
Jeta dhe Puna, Gjuhët dhe Komunikimi, Shoqëria dhe Mjedisi, Shkencat e Natyrës.

## Përshtatshëm për
Shkallë; 5, 6. Mund të përdoret edhe në shkallën 4. Klasa X, XI

## Kompetencat
I. Kompetenca e komunikimit dhe të të shprehurit - Komunikues efektiv
II. Kompetenca e të menduarit - Mendimtar kreativ
III. Kompetenca e të nxënit - Nxënës i suksesshëm

## Objektivat
-Ritregon ngjarjen e një teksti të dëgjuar nga mjetet auditive, audiovizuale apo nga mësimdhënësi; Shpreh për 3-5 minuta para moshatarëve dhe të tjerëve përjetimet dhe emocionet që e kanë shoqëruar gjatë shikimit të filmit.
-Parashtron pyetje dhe u përgjigjet pyetjeve për temën/problemin/ e dhënë në njërën nga format e të shprehurit.
-Bashkëpunon me të tjerët pavarësisht prejardhjes, aftësive dhe nevojave të veçanta për arritjen e një qëllimi të përbashkët në aktivitet në klasë/shkollë apo jashtë saj.
-Identifkon vlera shoqërore që kultivohen në klasë, në shkollë apo në familje si p.sh., besimin e ndërsjellë, tolerancën, solidaritetin, respektin, mirësjelljen etj.

## Pikat e diskutimit

A mendoni që gjendja emocionale dhe sociale e individit ndikon vetnjohjen dhe arritjen e vetëbesimit të tij?
Çka mendoni cila moshë te nxënësit është me një udhëkryq të madh në vendimarrje rreth zgjedhjes së profesionit?
Si e vlerësoni rolin e familjes dhe shoqërisë në zgjedhje të profesionit të nxënësit e niveleve të ndryshme të arsimit parauniversitar?
A mendoni që profesioni që zgjedhet për të ushtruar në të ardhmen nga ju mundet dhe duhet të sjell kënaqësi gjatë ushtrimit?
Tregoni për qëllimet dhe planifikimet e karrierës, se çfarë jeni të aftë të bëni.
Shpjegoni se si mundeni të arrini qëllimet për të zhvilluar karrierën.

## Aktivitetet
### Evokim – Stuhi mendimesh
Diskutim në çift dhe grup. Cilat janë qëllimet tuaja në karrierë? Hapet diskutimi për të marrë mendimet rreth qëndrimeve të tyre.

### Realizimi i njësisë mësimore.
Planifikimi i karrierës është një proces i përjetshëm që fokusohet në bërjen e zgjedhjeve për t'ju ndihmuar të menaxhoni punën tuaj dhe jetën personale. Mësimdhënësi sqaron si bëhet planifikimi, pse bëhet dhe kur bëhet. Më pas parashtron pyetje për vendimmarrje: Pse duhet të marrim vendime? Çfarë roli ka vendimmarrja në orientim në karrierë? Kërkohet nga nxënësit të shkruajnë planet për karrierën e tyre dhe më pas të shohin cilat janë kërkesat e tyre.

### Reflektim: Diskutim i lirë.
Pyeten nxënësit nëse kanë diçka për të diskutuar për deshirave të tyre si për profesionin e ardhshëm, pengesave rreth realizimit të tyre, etj. Nxënësit i drejtojnë pyetje njëri tjetrit për punën e bërë.



skano këtu!

https://dokufest-lab.com/al/mesimdhenesit/edukate-qytetare

# Edukatë qytetare

Filma dokumentarë dhe materiale didaktike për lëndën e Edukatës Qytetare



Zhvillimi i të menduarit kritik tek nxënësit trajton tema të ndryshme që evokojnë fenomene të ndryshme sociale dhe kulturore

# Burrë

**Regjia: Dafina Daka**

Përgatitur nga
Gyltene Isufi, SH.M. "Zenit" Prishtinë

## Përshkrimi i filmit

Ky film dokumentar trajton temën e të qenurit burrë ku diskutohen të gjitha premisat se çka e bënë të fuqishëm një djalë që të duket më burrëror sipas mentalitetit tonë shoqëror. Pothujase në të gjitha shoqëritë, individët apo grupet shoqërore janë të prirura me perceptime të ndryshme qoftë për vajzat apo për djemtë. Vajzat apo gratë përceptohen fizikisht më të dobëta në krahasim me djemtë apo burrat dhe poashtu ndjenjave emocionale u japin kahje gjinore, që don të thotë që vetë shoqëria është ajo që na përcakton pothuajse çdo emocion tonin si dhe në disa raste na bënë të veprojmë sipas perceptimeve që ata kanë për rolet tona në jetë.

Nga ky film nxënësit do të kenë mundësi të shohin guximin e një djaloshi të ri në moshë për të ndjekur dhe realizuar ëndrrën e tij, të bëhet balerin. Përkundër faktit që ai vazhdimisht paragjykohet, ngacmohet nga shoqëria për përzgjedhjen e profesionit që ka bërë dhe madje e humbet totalisht vetëbesimin, dashuria e madhe për baletin dhe ndodhitë e fundit përkundrazi i ndihmojnë pozitivisht që ai të mos dorëzohet nga të ushtruarit e ëndrrës së tij. Në anën tjetër në film kemi një perzonash tjerët ku rrëfen disa nga përceptimit që shoqëria i bënë karshi burrave për gratë. Ai thotë se burri nuk guxon të shpreh emocionet e tij sepse në qoftë se qanë do të përqeshet si "grua" nga shoqëria jonë, do të thotë se ai sprovohet me qenë i dobët sepse po i shpreh emocionet që ka për një çështje të caktuar. Madje edhe ndjenjën e gëzimit apo hidhërimit nuk duhet ta shpreh haptas, pra vetë shoqëria e detyron t'i shtyp ndjenjat e tij vetëm për t'u shfaqur burrë. shoqëria na e përcakton se çka duhet lejuar apo vepruar për çdo gjë që ka të bëjë me veprimet që duam t'i bëjmë në jetë.

Me një fjalë burri duhet githësesi të jetë i fortë për t'u pranuar si burrë për së vërteti, përndryshe ai mund të merr edhe epitete të lloj llojshme. Sipas tij burrat janë të prirur të ushtrojnë dhunë qoftë psiqike apo fizike, ndërsa gratë janë qenie që ofrojnë vetëm dashuri ngaqë janë fiziksht dhe emocionalisht më të dobëta se burrat. Mund të themi se rregullat e pa shkruara që shoqëria i përcakton se si duhet të veprojmë në jetërat tona, mbesin vetëm perceptime dhe asgjë më shumë

## Fushat e kurrikulës
Shoqëria dhe mjedisi.

## Përshtatshëm për
Shkallën 4, 5, 6 Klasat IX, X, XII

## Kompetencat
Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit; Kompetenca e të menduarit, Kompetenca për jetë, punë dhe mjedis; Kompetenca qytetare.

## Objektivat
Aftësim për mësim gjatë gjithë jetës; Përgjegjësia ndaj vetës dhe të tjerëve; Respektimi i të drejtave të njeriut; Evitimi i paragjykime në baza gjinore dhe profesionale.

## Pikat e diskutimit

Si e përceptoni termin burrë?
Cilat janë elementet e të qenurit burrë?
Cilat janë stereotipet gjinore më të shpeshta që j'u bëhen burrave dhe grave në shoqërinë tonë?
Shprehjet emocionale a vlejnë të njejta si për gratë ashtu edhe për burrat?
A është e duhur që profesionet ti ndajmë varësisht prej gjinisë?

## Aktivitetet

### Evokim – Stuhi mendimesh
Pas përfundimit të filmit, së pari marrim përshtypjet e para për filmin që nxënësit shikuan dhe më pas fillojmë të diskutojmë rreth pyetjeve të lartëshënuara.

### Realizimi – Këndet
Në fazën e realizimit bëjmë diskutim interaktiv me nxënësit rreth çështjeve të ngritura duke e lënë nxënësin në qendër të diskutimit duke replikuar me njëri tjetrin, sugjeruar apo krahasuar në lidhje me temën e filmit. Nxënësit gjithashtu do të jenë të lirë të shprehin opinionet e tyre po gjithashtu të marrin informacione shtesë për tema të caktuara.

### Reflektim – Diskutim përmes shqyrtimit të përbashkët
Në fazën e reflektimit nxënësve do t'u jipet detyrë të shkruajnë shkurtimisht reflektimin e tyre mbi diskutimin e bërë, nëpërmjet disa pyetjeve që mund të jenë: 1. Çfarë mendimi keni për një djalë që ushtron balet? 2. Çfarë mendimi keni për një vajzë që vozitë autobusin e trafikut urban? 3. Dhe cili është mendimi juaj për ta? Më pas seancën e përfundojmë me një përmbledhje të përgjithshme të diskutimit.



Njësia mësimore

Identiteti personal, Revolucioni ideologjik

# Drejto dhe gjuaj

Ardian Sallauka, SH. M. "Jeta e Re" Suharekë
Kujtesa Salihu – Keka, SH. M. "Xhavit Ahmeti" Gjilan
Selvete Poniku, "Shkolla e kompetencave" Prizren
Gyltene Isufi, SH. M. "Zenit" Prishtinë
Fatlume Hyseni, SH. M. "Zenel Hajdini" Gjilan
Beqir Mustafa, SH. M. "Xhelal Hajda" Rahovec

**Regjia: Marshall Curry**

## Përshkrimi i filmit

Me përdorimin e gjerë të telefonave të mençur dhe mënyrat e lehtësuara të shpërndarjes së videove në internet, mediat digjitale kanë ndryshuar mënyrën se si i shohim dhe dëgjojmë për ngjarjet aktuale. Kur pothuajse të gjithë në një protestë ose në zonë lufte kanë një kamerë, vija e hollë mes gazetarisë dhe formave të tjera të lajmeve shpesh janë të paqarta.

Përmes klipeve nga ky film nxënësit do të kenë mundësi të hulumtojnë ndikimin e këtyre paqartësive në perceptimin e përgjithshëm dhe të kuptojnë se çfarë e bën gazetarinë e sinqertë të veçantë. Filmi përcjell rrugëtimin e mahnitshëm të Matt VanDyke, një 26 vjeçar me çrregullim obsesiv-kompulsiv që u largua nga shtëpia e tij në vitin 2006 për ta sfiduar veten me "testin e burrërisë".

Ai e bleu një motoçikletë dhe një kamerë dhe filloj rrugëtimin disa vjeçarë nga Afrika e Veriut në drejtim të Lindjes së Mesme. Kur revolucioni shpërtheu në Libi, ai iu bashkua rebelëve që luftonin kundër Muamar Gadafit, por u kap, duke dërguar aventurën e tij në një drejtim të ri e të frikshëm.

Filmi pasqyron se si sot përdoren kamerat jo vetëm për të regjistruar tregime, por edhe për ti krijuar ato.

## Fushat e kurrikulës
Shoqëria dhe mjedisi, Gjuhët dhe Komunikimi, Jeta dhe Puna.

## Përshtatshëm për
Shkallën kurrikulare 5 dhe 6, Klasat X, XI, XII

## Kompetencat
Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit, Kompetenca e të mësuarit, Kompetenca qytetare.

## Objektivat
-Promovimi i vlerave të përgjithshme kulturore dhe qytetare;
-Evitimi i paragjykimeve;
-Aftësimi për mësim gjatë gjithë jetës.

## Pikat e diskutimit

A vlen kjo edhe për ne të cilët nuk jemi në beteja por jemi duke krijuar lajme për jetën tonë personale?
Si ka ndikuar përdorimi i kamerave, telefonëve mobil dhe prania e rrjeteve sociale në mënyrën se si ne e "portretizojmë" jetën private?
A krijojmë imazhe të idealizuara të vetëvetes për t'i paraqitur botës?
A do të ndikojë fakti se dokumentimi ndikon si veprojmë apo prezantohemi në kamera?

## Aktivitetet

### Evokim – Stuhi mendimesh
Pyetni nxënësit se çka kuptojnë me termin "Diversitet". Pyetni se sa e njohin kulturën në Lindjen e Mesme (10 Min).

### Realizim
Lëshoni pjesën e filmit për pjesën përkatëse. Ndani nxënësit në grupe dhe kërkoni nga ata që të diskutojnë dhe argumentojnë dallimin e kulturave. Kërkoni shembuj konkret nga inserti i shikuar. (20 Min).

### Reflektim
Përgatitni paraprakisht një kuiz për lëndën përkatëse. Testoni njohuritë e përfituara nga këto aktivitete. (15 Min).



Njësia mësimore

Identiteti si pjesë e një grupi dhe e një komuniteti.

# Exit

**Regjia: Karen Winther**

## Përshkrimi i filmit

Përgatitur nga
Merita Shala, SH. M. "Ahmet Gashi" Prishtinë

Filmi EXIT paraqet histori sa fascionuese aq edhe interesante lidhur me pikëpamje të ndryshme lidhur me lëvizjet radikale në Gjermani, Norvegji, Danimarkë dhe vende tjera si dhe ndikimin e propagandës në shoqëri. Bashkimi në lëvizje ekstremiste të krahut të djathtë, neo-nazistëve, grupeve militante fashiste për shumë adoleshent ka qenë strehë dhe vend për të shprehur ekstremizëm të dhunshëm përmes veprimeve të tyre sa mizore po aq edhe të frikshme dhe të turpshme. Manipulimi dhe ndikimi nga këto grupe kishte ndikim të madhë sidomos tek moshat prej 13 deri 16 vjeçare, kohë kur kriza e personalitetit dhe krijimi i identitetit është sfidë për këto grup mosha. Dhe se çfarë ndodhë kur një person i ri bashkohet një lëvizje radikaliste/ ekstremiste dhe frymëzimi që kanë marrë për tu larguar nga lëvizjet duke kërkuar ndihmë përmes programeve të ndryshme.

Një nga personazhet më të rëndësishme dhe interesante Manuel do ta trajtoj gjatë përshkrimit të filmit dokumentar EXIT për shkak të rëndësisë dhe ndikimit që mund të ketë gjatë rrëfimit të tij.Manueli kurrë nuk mund të ja falë vetës dhe është arsyeja pse i jep vajzës se tij aq shumë dashuri dhe vëmendje. Dhe ndoshta nëpërmes vajzës disi po këkron falje. Manuel ka pasur një trajtim psikologjik pasi u largua nga lëvizja "Por unë kurrë nuk mund ta falë veten" thote ai.

## Fushat e kurrikulës
Shoqëria dhe Mjedisi;
Jeta dhe Puna.

## Përshtatshëm për
Shkalla V, VI.
Klasa X, XI, XII

## Kompetencat
I. Kompetenca e komunikimit dhe të të shprehurit - Komunikues efektiv;

II. Kompetenca e të menduarit - Mendimtar kreativ;

III. Kompetenca e të nxënit - Nxënës i suksesshëm.

## Objektivat
-Promovimi i vlerave demokratike, kulturore dhe qytetare;
-Aftësimi për mësim gjatë gjithë jetës;
-Zhvillimi i identitetit personal dhe njohja, si dhe respektimi i identiteteve dhe përkatësive të ndryshme sociale, etnike, gjinore, fetare, seksuale, racore, kulturore etj.

## Pikat e diskutimit
Ç'është identiteti?
Identiteti im si pjesë e një grupi (Identifikimi me grupin/lëvizjen)
Cilët janë faktorët që ndikojnë që individët i bashkohen grupeve të caktuara?
Unë i pranoj dhe respektoj të tjerët.
Ksenofobia - frika ndaj të huajve.
Radikalizmi, racizmi.
Ekstremizmi i dhunshëm në shoqëri.
Seated in small groups, students watch the documentary, and while watching it, individually, they take short notes and compare them with their thoughts/ideas that they've shared while analyzing the picture. After watching the documentary, in pairs, they construct sentences / write a short paragraph in English (this part can be differentiated based on student's level of English) where they explain and compare their findings / information they get while watching the documentary with their thoughts (given at the beginning while analyzing the picture). They are expected to give clear and constructive answers by using adjectives (grade 10) and by constructing sentences in present/past perfect based on the context. They are expected to use adjectives and the relevant tenses after previously explaining adjective degrees, and present and past perfect tense.

### Reflection
The group is divided in two, with half of them forming a tight circle in the center of the room. The remaining students then pair up with someone in the circle (by always trying to keep the distance). The teacher then poses one of the discussion questions for each pair to answer in one or few minutes. Then, either the inner or outer circle is asked to rotate "x" spaces to the right or left. Another question is asked for the new pair to discuss.



Njësia mësimore

The risk of playing computer games for too long.

# Matrix

**Rexhia: Martin Xhoxhi**

Përgatitur nga
Blerta Shehu, SH. M. "Adem Kastrati" Gjilan

## Përshkrimi i filmit

This short documentary shares information about a whole new world among Prizren's streets.
A world that challenges people of different ages with dependency and anti-social behavior due to the continuous enhancement and use of technology.

## Fushat e kurrikulës
Languages and communication.

## Përshtatshëm për
Scale: VI, grade: 12

## Kompetencat
The competencies that should be attained by using this short film, based on Kosovo curriculum are: communication, expression, learning and the civic competence.

## Objektivat
The objectives that should be attained by using this short film, based on Kosovo curriculum are: Students analyze and estimate the time on playing computer games for too long. They are expected to construct /write clear sentences and paragraphs in English and share their thoughts/ perspectives , and discuss about the documentary.

## Pikat e diskutimit

Do you often play computer games?
Do you think that gaming has a positive impact on your life and health?
What game have you spent the most amounts of hours on?
Do you think that the people/ youngsters in the documentary are having tremendous fun while gaming?
Do you feel that they jeopardize their social life?
Do you believe that gaming affects your mental health and social life?

## Aktivitetet
### Analyze the pictures
What do you think the on picture1 people are doing? (10 youngsters playing PlayStation) What is picture 2 about? (A Matrix movie scene) Do you have any idea what the documentary is about? (Estimated time: 5 – 7 minutes)

### Learning activities
Seated in small groups, students watch the documentary, and while watching it, individually, they take short notes and compare them with their thoughts/ideas that they've shared while analyzing the picture. After watching the documentary, in pairs, they construct sentences / write a short paragraph in English (this part can be differentiated based on student's level of English) where they explain and compare their findings / information they get while watching the documentary with their thoughts (given at the beginning while analyzing the picture). They are expected to give clear and constructive answers in English based on the context.

### Reflection
The teacher or facilitator makes a statement to the group, to which members can strongly agree, agree, disagree, or strongly disagree. Groups form around each of the four responses to the statement, showing the group's "differences." Members from each opinion group are asked to explain their stance/point of view, fleshing out the many facets of the issue. Students must listen carefully, and can change positions if they change perspectives. This activity helps everyone learn to disagree without being disagreeable, but must be carefully facilitated. Questions are intentionally stated to allow for personal interpretation and to limit responses to one of the four categories. Several group members will want to take some sort of an intermediate stance, but should be encouraged to choose the stance about which they feel the strongest, or which is their instinctive response.

### Extension/Optional
Part of processing this activity can then be discussion how it felt to be so limited and to be categorized. *Note: this activity can be easily performed in the classroom by keeping the needed physical distance.



Njësia mësimore

Passive Voice

# Nosotros

**Regjia: Nazmi Latifi, Albulena Kurti**

Përgatitur nga
Blerta Shehu, SH. M. "Adem Kastrati" Gjilan

## Përshkrimi i filmit

"Nosotros" is a documentary that makes us aware about the importance of preserving the environment. Through all the images that this documentary offers, we can clearly see what damage we cause to the nature/environment by throwing the litter or garbage.

"Nosotros" është një dokumentar që na ndërgjegjëson si shoqëri për ruajtjen e ambientit. Përmes pamjeve që ky dokumentar na ofron, e shohim se çfarë është duke i shkaktuar ambientit/natyrës faktori njeri, duke hedhur mbeturina.

## Fushat e kurrikulës
Languages and communication; Environment and society

## Përshtatshëm për
Scale V, VI;
Grades 10 and 11;

## Kompetencat
The competencies that should be attained by using this short film, based on Kosovo curriculum are: communication, expression, critical thinking, creativity, learning and the civic competence.

## Objektivat
Students analyze and estimate the information/scenery the documentary offers.

They construct clear sentences in passive voice. Moreover, they express ideas and feelings, as well as understand and respect the perspectives of others.

## Pikat e diskutimit

Why this documentary is titled "Nosotros"?
What do you think? Why there isn't involved any dialogue in this documentary?
Do you think that our planet or the environment we live in is threatened by us, people?
How can this situation be changed?
What dialogue could be integrated in this documentary?

## Aktivitetet

### Starter Activity (Estimated time: 5-7 minutes)
Analyze the picture (Tree on Climate Change) and answer the question: What do you see in this picture? How can this image be interpreted?

### Main learning activities (Estimated time: 25 - 30 minutes)
Students watch the documentary as a group, and take short notes. After watching it ask them to work in small groups and discuss why at the beginning of the documentary there are shown scenes with beautiful and clean landscapes, whereas, afterwards there is shown a different scenery? Students prepare their answers in written form in posters (using the passive voice), afterwards present them.

### The Cube of Reflection (Estimated time: 10 minutes)
Students have a tangible cube that they roll to help them reflect together. In this cube they will have the three guiding questions which they have to answer. They are expected to understand, analyze and evaluate the content.

### Homework
Students write one paragraph about their feelings while they watched the documentary. Would they recommend it to their other peers? Students can submit the homework to the teacher via email (or if possible at the DokuFest online platform).



Njësia mësimore

Tradita (how to behave abroad)

Fjalia kushtore (second conditional)

Kohët e foljes (past simple, present perfect)

Të shkruarit: rrëfim

# Nën duvak

Përgatitur nga
Arbnesha Kusari, SH. M. "Hajdar Dushi" Gjakovë
Gyltene Isufi, SH. M. "Zenit" Prishtinë
Sabina Dishallari, SH. M. "Gjon Buzuku" Prizren

## Përshkrimi i filmit

"Paqi nevojë për mu, aq sa keni për pare" Filmi dokumentar "Nën Duvak" trajton martesën tradicionale në Malësinë e Hasit, se si në të kaluarën vajzat janë martuar. Shikuar në mënyrë kronologjike vajzat dhe gratë në shoqërinë tonë në përgjithësi më shumë kanë shërbyer në kujdesin familjar në përgjithësi, thuajse as pak nuk janë marrë në konsideratë mendimet apo vendimet që kanë të bëjnë me jetën e tyre, siç janë; shkollimi apo martesa.

Tek ky film gjejmë kryesisht se cila ka qenë mundësia në mes të përzgjedhjes apo dëshirave në raport me familjen lidhur me vendimin e martesës, që do të thotë se përzgjedhja e partnerëve për martesë nuk përcaktohej nga dashuria por ishin prindërit ata që vendosni për fëmijët e tyre sa i përket martesës, ku imponimi ndërlidhet si mohimi i të drejtave të njeriut.

Qysh nga fëmijëria vajzat janë rritur me idenë se duhet të hynë në martesë, të krijojnë familje, janë këshilluar brez pas brezi në këtë mënyrë jetese. Kujdesi për mirëqenien e saj, psiko-social, nuk ka ekzistuar, por është krijuar izolimi dhe neglizhimi ndaj dëshirave, qëllimeve dhe ëndrrave të vajzave. E gjithë kjo mund të ketë ndikuar në mos krijimin e identitetit personal dhe përgjithësimin e tipareve të vetëpersonalitetit.

Kur e analizojmë në kontekstin kohor të tanishëm, ajo trajtohet më shumë si vegël materiale dhe shfrytëzuese për familjen ku do të jetoj. Në vazhdimësi të filmit kemi inserte se si gruaja trajtohet si pronë e burrit, e në ato rrethana një gjë e tillë konsiderohet si çështje normale, ku burri është ai që merr vendime për jetën e saj. Krahasimi i jetës familjare dhe i marrëdhënieve martesore në ditët e sotme me ato të priudhave të hershme, tregon se familja ka ndryshuar në mënyrë të dukshme si i përket mënyrës së stilit të jetesës.

## Fushat e kurrikulës
Shoqëria dhe mjedisi, Gjuhë dhe komunikim.

## Përshtatshëm për
Shkallën 4, 5, 6 Klasat IX, X, XII.

## Kompetencat
Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit, Kompetenca e të menduarit, Kompetenca për jetë, punë dhe mjedis, Kompetenca qytetare.

## Objektivat
Aftësim për mësim gjatë gjithë jetës, Promovimi i vlerave kulturore dhe qytetare.

## Pikat e diskutimit

Si e perceptoni martesën në këtë film?
Cili është roli vendimmarrës i personave në këtë film?
Cilat janë pasojat e martesave të hershme?
Krahasimi i martesave në periudha kohore.
Çfarë ndikimi ka imponimi i martesës në gjendjen emocionale?
Mungesa shkollore, pasojë e inferioritetit në shoqëri.
Patriarkaliteti dominant në familje dhe shoqëri.

## Aktivitetet

### Evokim – Brainstorming (Stuhi mendimesh)
Në fillim të orës mësimore pyesim nxënësit se çfarë njohurie kanë për martesën tradicionale në shoqërinë tonë dikur dhe tani. Bëjmë një hyrje të shkurtër dhe shkëmbejmë pyetje dhe përgjigje rreth asaj se çka kemi në fokus. Më pas shikojmë filmin.

### Realizimi – Këndet

Pas përfundimit të filmit marrim mendimet e përgjithshme për filmin, më pastaj nxënësit i informojmë për referencat që do të marrin në lidhje me filmin, ku do të kenë mundësinë të shënojnë në fletë ndonjë detaj nga ajo që shohin, që do të ju shërbej si pikë reference për diskutim. Ndahen në dy grupe dhe shënojnë pikat e diskutimit që do të realizohen.

### Reflektim
Pasi përcaktohemi për pikat e diskutimit i ndajmë nxënësit në dy grupe ku diskutohet. Grupi i parë do të mbrojë pikën e diskutimit: Martesa bashkëkohore dhe rolet gjinore; Grupi i dytë do të mbrojë pikën e diskutimit: Martesa tradicionale dhe rolet gjinore. Të dy nga grupet, do të mbrojnë gjithë përmbledhjen e diskutimit. Detyrë për nxënësit: Sygjerojmë nxënësit në mënyrë individuale të mbledhin më shumë materiale për këto dy pika diskutimi dhe të reflektojnë me një ese të analizuar me kritikën e tyre.



Njësia mësimore

Filmi dokumentar si një instrument për përmirësimin e procesit të mësimdhënies, si dhe zhvillimin e të menduarit kritik tek nxënësit trajton tema të ndryshme që evokojnë fenomene të ndryshme sociale.

# Presidenti ynë i ri


Përgatitur nga
Gentian Berisha, SH. M. "Jeta e Re" Suharekë
Feride Thaçi, SH. M. "Ulpiana" Lipjan
Jehona Luma, SH. M. "Ulpiana" Lipjan


## Përshkrimi i filmit

Filmi dokumentar "Presidenti ynë i ri" është një satirë në lidhje me mediat ruse gjatë ndjekjes së fushatës presidenciale të vitit 2016 të Donald Trump. Nëpërmjet filmimeve kuptohet se si mediat ruse të sponzoruara nga shteti tejkaluan zgjedhjen e Trump në një mënyrë të orientuar nga Rusia, duke falsifikuar informacionin që transmetohej në popullatën ruse.

Historia e zgjedhjes së Donald Trumpit thuhet tërësisht përmes propagandës ruse. Taktikat e "luftës moderne" të informacionit me anë të lajmeve të rreme arrijnë të ndikojnë në krijimin e bindjeve, qëndrimeve, paragjykimeve dhe stereotipeve të ndryshme në popull.

## Fushat e kurrikulës
Gjuhët dhe Komunikimi, Shoqëria dhe Mjedisi

## Përshtatshëm për
Shkalla kurrikulare 5;
Klasa XI, XII.

## Kompetencat
Kompetenca e të menduarit,
Kompetenca qytetare,
Kompetenca personale,
Kompetencat e komunikimit dhe të shprehurit.

## Objektivat
-Komunikimi dhe të menduarit e shëndoshë: Zhvillimi i të menduarit kritik, Pasurimi me njohuri të reja, Promovimi i vlerave demokratike dhe qytetare, Zhvillimi i identitetit personal, Njohja dhe respektimi i diversitetit.

## Pikat e diskutimit

Roli i mediave në krijimin e qëndrimeve dhe bindjeve.
Ndikimi i mediave në zgjedhje.
Format e ndikimit social.
Mediat e pavarura në Kosovë.
Propaganda si mjet për arritjen e qëllimeve.
Realiteti vs realiteti virtual.
Dallimi mes lajmeve të rreme dhe atyre të vërteta.
A ndikojnë mediat në vendimet tona të përditshme?
Ndikimi i gjuhëve të huaja në krijimin e bindjeve.
A duhet të bëhet centralizimi i mediave që japin lajme?

## Aktivitetet

### Evokim – Shkrim i lirë (10 minuta)
Nxënësve u ipet tema "Ndikimi i mediave në krijimin e opinionit publik," pastaj lexohen disa shkrime të tyre të përzgjedhura rastësisht.

### Realizimi – Ruaje fjalën e fundit për mua (20 minuta)
Nxënësit udhëzohen që gjatë leximit të tekstit të përcaktohen për një apo më shumë pjesë që për ata janë më interesante dhe në ndërkohë mund të bëjnë ndërlidhjen edhe me sekuenca të caktuara nga filmi dokumentar. Pjesët e zgjedhura dhe numri i faqes ku është marrë pjesa shkruhen në një fletë, ndërsa, në anën tjetër të fletës shkruhet një koment për citim (pse e ka zgjedh atë pjesë, cili është mesazhi, rendësia, etj.). Njëri nga nxënësit e tregon faqen ku e ka zgjedh pjesën, e lexon atë, ndërsa të tjerët e përcjellin në libër gjatë leximit. Pas leximit, nxënësit tjerë diskutojnë rreth citatit. Në fund të diskutimit nxënësi i cili është përcaktuar për pjesën, lexon komentin e tij për atë citat. E njëjta ecuri e leximit të citatit dhe komentimit, praktikohet edhe tek nxënës të tjerë.

### Reflektim - Pesëvargëshi
Në tabelë shkruhet pyetja: A duhet të kontollohen mediat nga shteti ose nga ndonjë organizate "botërore" e gazetarisë? Pastaj nxënësve u kërkohet të argumentojnë pse janë për dhe pse janë kundër. Në pjesën "Po" renditen përgjigjet dhe argumentet përse duhen të merren masa të tilla. Ndërsa në pjesën "Jo" argumentohet përse nuk duhet të merren këto masa



Njësia mësimore

Emigrimi. Imigrimi. Dyndjet e popullësisë.

fenomene të ndryshme sociale.

# Rrëfimet e Emigrantit

Përgatitur nga
Gyltene Isufi, SH. M. "Zenit" Prishtinë
Jeta Rexha, SH. M. "Hajdar Dushi" Gjakovë
Merita Shala, SH. M. "Ahmet Gashi" Prishtinë

**Regjia: Gazmir Lame**

## Përshkrimi i filmit

Filmi dokumentar "Rrëfimet e emigrantit" trajton fenomenin e migrimit gjatë periudhës së migrimeve masive në vitin 2014 / 2016 në Kosovë. Papunësia dhe gjendja e rëndë ekonomike si dhe mungesa e përspektivës kanë ndikuar që shumë të rinjë të mësyejnë rrugët e Europës. Migrimet e para të shqiptarëve datojnë nga kohët më të lashta, por janë të njohura dyndjet masive në periudha të ndryshme përgjatë historisë.

Si shumica e qytetarëve të Kosovës në mungesë të liberalizimit të vizave dhe lëvizjes së lirë në vendet e Bashkimit Europian edhe Lundrimi është njëri ndër ata që nuk e ka bërë asnjë hap jashtë Kosovës, e që udhëtimi me autobus natën për në Serbi është vërtetë stresues. Kjo ishte dita më stresuese dhe më e gjatë për Lundrimin, edhe pse ai shfaq përsëri durim ani pse 10km. rrugë për në Suboticë dhe se kalimi nga Serbia për Hungari përmes malit është i rrezikshëm dhe mund të arrestohet nga policia. "Kurrë nuk përfundon," ofshan Lundrimi gjersa tymi i cigarës i'a mbulon fytyrën e dëshpëruar.

Çfarë ndodhë me migrantët kur nuk kanë para më? Lundrimi është i dëshpëruar, pa para, dhe nuk ka para për taksi për ta dërguar në kufi...

Lundrimi më në fund është me fat, takon një trafikant emigrantësh në stacion i cili ka ardhë më i marrë disa refugjatë... Largimi i qytetarëve të Kosovës për në vendet e Bashkimit Evropian vazhdon edhe sot e kësaj dite, mirëpo përmes marrjes së vizave të punës. Sfidë për autoritetet shtetërore është riatdhesimi i të ikurve dhe ripranimi i tyre në bazë të standardeve që i kërkon BE-ja.

## Fushat e kurrikulës
Shoqëria dhe mjedisi, Gjuhë dhe komunikim.

## Përshtatshëm për
Shkallën 5, 6. Klasa X, XI

## Kompetencat
Nxënës i suksesshëm, Mendimtar kreativ, Komunikues efektiv

## Objektivat
-Promovimi dhe kultivimi i vlerave kulturore dhe qytetare;
-Përgjegjësia ndaj mjedisit;
-Përdorimi i teknologjisë;
-Aftësimi për punë dhe jetë.

## Pikat e diskutimit

Migrimet e shqipëtarëve në periudha të ndryshme kohore (Historiku i migrimeve).
Motivet që ndikojnë në migrimin e njerëzve.
Migrimet e jashtme/brendshme përkohshme/përhershme.
Faktorët (shkaktarët) e migrimeve.
Pasojat e migrimeve.
Integrimi/Riintegrimi.
Asimilimi dhe format e shprehjes së tij.
Mungesa e përspektivës te të rinjët.
Orientimi në tregun e punës.
Ballafaqimi me kultura/realitet tjetër.

## Aktivitetet

### Evokim –Stuhi mendimesh
1. Tendencat e njerëzve për lëvizje gjeografike dhe sociale. 2. Cilët janë faktorët që ndikojnë që individi apo grupi të migrojnë? 3. Pasojat e migrimeve: demografike, ekonomike, sociale, kulturore dhe politike. 4. Asimilimi dhe shembuj të funksionimit të modelit të asimilimit.

### Realizimi – ndahen nxënsit në grupe
1. Migrimet për shkaqe/arsye shkollimi/arsimimi si dhe pasojat. 2. Migrimet për shkaqe/arsye ekonomike/politike si dhe pasojat. 3. Migrimet për shkaqe/arsye konflikti/luftëra si dhe pasojat. 4. Migrimet për shkaqe sociale/kulturore si dhe pasojat.

### Reflektim - Pesëvargëshi
1. Emër. 2. Dy mbiemra. 3. Folje. 4. 1 fjali/mesazh. Shkrim i lirë: Arsyet pse duhet ne duhet të qëndrojmë në Kosovë?



Njësia mësimore

Filmi dokumentar si një instrument për përmirësimin e procesit të mësimdhënies, si dhe zhvillimin e të menduarit kritik tek nxënësit trajton tema të ndryshme që evokojnë

# Rrëfimi

**Regjia: Ashish Ghadiali**

Përgatitur nga
Merita Shala, SH. M. "Ahmet Gashi" Prishtinë

## Përshkrimi i filmit

"Ky është vendi im, pse ka rëndësi të ma kujtoni këtë" Filmi dokumentar "The Confession" është një histori e bazuar në jetën e Mozzam Begg i cili përmes një interviste sjellë fakte rreth jetës së tij, ku është rritur duke përjetuar kriza identiteti dhe etiketimi duke i thënë "Paki go home".

Moazzam Begg ka lindur në Birmingham, djalë i një menaxheri bankash që emigroi në Britani nga Pakistani. Ai ishte arsimuar në një shkollë hebraike dhe pyetja e tij për identitetin e tij dhe vendimin për të përqafuar Islamin përputhej me trazirat e mëdha në botë, nga pastrimi etnik në Bosnje deri në sulmet e 11 shtatorit.

Gjatë intervistës së tij në dokumentar, Begg shpjegon përfshirjen në konflikte të armatosura, duke filluar nga vizita e tij në Bosnje dhe Hercegovinë, Çeceni, Afganistan për të përfunduar në Siri. Meqenëse Begg është i përfshirë në organizata botërore nga muxhahedinët në Bosnje e deri në grupin e talibanëve në Afganistan, ai shihet si person islamik radikal i dhunshëm dhe i rrezikshëm në sytë e Britanisë së Madhe. Mirëpo Begg pohon se bashkimi me organizata ka qenë për kurreshtje, për të eksploruar, studiuar përreth këtyre vendeve. Ai pohon se nuk iu bashkua grupit të talibanëve, thjeshtë dëshironte të rrinte, jetonte me ta, meqenëse kishte dëgjuar se talibanët nuk lejonin shkollimin/edukimin e vajzave/grave, gjë që sipas përvojës së tij nuk ishte e vërtetë, sepse ata lejonin shkollimin e tyre. Gjithashtu ai kundërshtonte dhe nuk pajtohej me al-Kaidan, e njohur si organizatë terroriste dhe ishte zë i fuqishëm kundër ISIS.

Begg është arrestuar në vitin 2001 nën akuza për vepra terroriste, akuza që janë hedhur poshtë nga gjykata, ku është vërtetuar pafajësia e tij, dhe asnjëherë nuk është dëshmuar e kundërta, nuk kishte prova që kishte kryer ndonjë krim, aludohej në alibi. Megjithatë ai thotë "Unë nuk jam antishtet, shteti është anti unë" duke i rikujtuar torturat psikologjike, fizike, kërcënimet dhe shantazhimin, panikun e përjetuar, rikthimin në familje e komunitet, pas qëndrimit në burg përreth tri vitesh.

## Fushat e kurrikulës
Shoqëria dhe mjedisi, Jeta dhe puna, Gjuhët dhe komunikimi.

## Përshtatshëm për
Shkallën kurrikulare 5 dhe 6, klasat XI -XII.

## Kompetencat
Kompetenca e të mësuarit, Kompetenca qytetare, Kompetenca personale, Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit.

## Objektivat
Bazuar në Kurrikulën e re të Kosovës objektivat që synohen të arrihen përmes këtij filmi dokumentar janë: Promovimi i vlerave demokratike, kulturore dhe qytetare, Aftësimi për mësim gjatë gjithë jetës, Zhvillimi i identitetit personal dhe njohja dhe respektimi i identiteteve dhe përkatësive të ndryshme sociale, etnike, gjinore, fetare, sekulare, racore, kulturore etj.

## Pikat e diskutimit
Identiteti dhe kriza e tij. Kush jam unë? Ku jam duke shkuar? Humbja e identitetit. Zgjedhja e krizes së personalitetit?
Si identifikohemi: në bazë të gjinisë, nacionalitetit, përkatësisë etnike, religjionit, background-it familjar, kulturës etj.
Izolimi nga moshatarët, familja, shoqëria.
Radikalizimi - rrymë dhe qëndrim politik, synimi i fjalës "Radikalizëm".
Koncepti i terrorizmit dhe metodat e tij.
Çka konsiderohet "Ekstremist" apo "Radikal"?
Përdorimi i termit "Radikal"- etiketimi, manipulimi dhe përjashtimi.
Motivet e bindjeve radikale.
Faktorët që ndikojnë në rritjen e rrezikut dhe kërcënimi nga radikalizimi.
Pasojat e radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm si dhe parandalimi.
Toleranca fetare dhe format ekstreme të Islamit.
Torturat fizike/ psikike.
Ndikimi i medias dhe "Propagandës" në botë.
Pikat e forta, dobësitë, mundësitë dhe rreziqet e radikalizimit në kontekstin social dhe kulturor në Kosovë.

## Aktivitetet
### Evokim –Stuhi mendimesh
Mësimdhënësi kërkon nga nxënësit që në fletët e tyre të vendosin nocionet psh, identitet, radikalizëm, ekstremizëm etj. Pastaj kërkon nga nxënësit që të japin mendimet dhe idetë e tyre që janë të lidhura me temën si dhe bëjnë degëzimin e tyre. Nxënësit mendojnë individualisht për temën dhe mund të punojnë në çifte apo grupe. Ata pastaj japin idetë dhe njohuritë e tyre për temën, si dhe bëjnë shkëmbimin e ideve të tyre në grup.

### Reflektim – Rrjeti i diskutimit
Së bashku konkludojnë rolin, rëndësinë e personalitetit dhe ndikimin që ka në shoqëri, rolin e familjes, shkollës dhe masmediave në nxitjen/ parandalimin e radikalizmit/ekstremizmit të dhunshëm, riintegrimin në familje, shoqëri, toleranca fetare, konteksti i Kosovës në përhapjen dhe luftën kundër radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm etj. Vlerësimi: Vlerësimi i nxënësit mbështet në rezultatet e të nxënit në kompetencat e fushës sipas temës mësimore. Vlerësimi është i vazhdueshëm dhe formues.

### Realizimi
Ndërtimi i njohurive të reja. Mbajtja e strukturuar e shënimeve (krahaso-dallo), harta e konceptit: Klasa ndahet në grupe, mësimdhënësi drejton nxënësit të analizojnë pjesë të caktuara të filmit (paragrafë/fjali) me qëllim dallimin e situatave varësisht nga konteksti social dhe kulturor në Kosovë.



Njësia mësimore

Whatever makes you happy - I Love what I do

# Tar on Fingers

**Regjia: Emina Adlovic, Branko Avramovski**

Përgatitur nga
Arbnesha Kusari, SH. M. "Hajdar Dushi" Gjakovë

## Përshkrimi i filmit

Ky film është një rrëfim mbi mbledhjen dhe përpunimin e duhanit.

Një grup që në paraqitje duken familjar, shpërfaq sfidën e këtij zanati.

## Fushat e kurrikulës
Gjuhët dhe komunikimii

## Përshtatshëm për
Shkalla V; Klasa: X

## Kompetencat
Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit;
Kompetenca e të menduarit;
Kompetenca e të mësuarit;
Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis;

## Kompetenca personale;
Kompetenca qytetare.

## Objektivat
Kultivimi i identitetit personal, kombëtar, i përkatësisë shtetërore e kulturore;
Promovimi i vlerave të përgjithshme kulturore dhe qytetare;
Zhvillimi i përgjegjësisë ndaj vetes, ndaj të tjerëve, ndaj shoqërisë dhe ndaj mjedisit;
Aftësimi për jetë dhe për punë në kontekste të ndryshme shoqërore e kulturore.

## Pikat e diskutimit

Kultivuesja e re e duhanit.
Traditat familjare.
Rëndësia e ruajtjes së zanateve të vjetra.
Nevoja për modernizim të teknikave në prodhim.

## Aktivitetet

### Evokim
Lexohen ngjarjet e dy personazheve në libër (5 min); Diskutohet rreth tyre me pyetjet në libër (5 min).

### Realizim
Nxënësit e shohin filmin për 15 minuta dhe udhëzohen të marrin shënime mbi ngjajshmëritë e personazheve në libër; Për 10 minuta diskutohet për filmin ku pyetjet janë të ngjajshme me ato të librit.

### Reflektimi
Diskutohet për tekstin nga aspketi gramatikor (5 min).



Njësia mësimore

Morali. Ndërgjegjja.

# Ushtarët që dhunojnë

Përgatitur nga
Arbnesha Kusari, SH. M. "Hajdar Dushi" Gjakovë
Jeta Rexha, SH. M. "Hajdar Dushi" Gjakovë

## Përshkrimi i filmit

Për një kohë të gjatë dhuna seksuale në konflikt është përdorur si një armë e heshtur dhe e efektshme në konfliktet anembanë botës. Historikisht përdhunimi është përdorur si një strategji për spastrim etnik dhe gjenocid, si një mjet për të shkatërruar familjet dhe komunitetet, si një metodë e nxitjes së terrorit dhe nxjerrjes së informacionit.

Për një kohë të gjatë dhuna seksuale ishte pothuajse e padukshme. Të mbijetuarit vuanin në heshtje, të turpëruar për diçka që nuk ishte faji i tyre, të turpëruar nga familjet e tyre, të stigmatizuar, të lënë për t'+u përballur me veten dhe gjithmonë pa mirëkuptim dhe ndihmë.

Në Republikën Demokratike të Kongos, përdhunimi në masë i grave nga ushtarët, është një armë e pranueshme e luftës. Në filmin dokumentar një numër ushtarësh tregojnë
historitë e tyre, në një përpjekje për të njohur mizoritë që ata kanë kryer, derisa vjen takimi me viktimën...

## Fushat e kurrikulës
Gjuhët dhe Komunikimi, Shoqëria dhe Mjedisi, Jeta dhe Puna.

## Përshtatshëm për
Shkallën 4, 5, 6. Klasat IX, X, XII

## Kompetencat
Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit;
Kompetenca e të mësuarit;
Kompetenca qytetare.

## Objektivat
-Promovimi i vlerave të përgjithshme kulturore dhe qytetare;
-Aftësimi për mësim gjatë gjithë jetës.

## Pikat e diskutimit

Shprehjet emocionale a vlejnë të njejta si për gratë ashtu edhe për burrat?
Morali i temës së filmit.

## Aktivitetet

### Evokim
Pas përfundimit të filmit, së pari marrim përshtypjet e para për filmin që nxënësit shikuan dhe më pas fillojmë të diskutojmë rreth pyetjeve të lartëshënuara.

### vRealizimi
Në fazën e realizimit bëjmë diskutim interaktiv me nxënësit rreth çështjeve të ngritura duke e lënë nxënësin në qendër të diskutimit duke replikuar me njëri tjetrin, sugjeruar apo krahasuar në lidhje me temën e filmit. Nxënësit gjithashtu do të jenë të lirë të shprehin opinionet e tyre po gjithashtu të marrin informacione shtesë për tema të caktuara.

### Reflektimi
Në fazën e reflektimit nxënësve do t'u jipet detyrë të shkruajnë shkurtimisht reflektimin e tyre mbi diskutimin e bërë.



skano këtu!

https://dokufest-lab.com/al/mesimdhenesit/gjuhe-shqipe

# Gjuhë shqipe

Filma dokumentarë dhe materiale didaktike për lëndën e Gjuhës Shqipe



Njësia mësimore

Letërsi Shqiptare-Realizmi, Tema e Mjerimit në letërsinë shqipe.

# Ergys

**Regjia: Rina Celina**

Përgatitur nga
Nuhi Kuçi, SH. M. "Skënderbeu" Kaçanik

## Përshkrimi i filmit

Në këtë film dokumentar përjetojmë shpirtin fëmijëror të një djaloshi të quajtur Ergys, i cili është një lypës nga Shqipëria por që tash e një kohë jeton në Prizren. Gjithçka që ai ka tani janë vëllai i tij i madh, shokët e shoqet të cilët jo gjithmonë janë të mirë me të, si dhe atë shpresën e vogël e cila e mban gjallë. Ditët e tij duken gati gjithmonë njësoj, por ajo që i mungon atij janë prindërit e tij. Pavarësisht të gjithave ai sërish ka shpirtin e një fëmie sikurse të gjithë moshatarët e tij dhe mundohet të gjejë kënaqësi në gjithçka dhe çdo moment.

Përgjithësisht ky dokumentar lidhet me veprat e Migjenit në të cilat trajtohet tema e mjerimit, skamjes, vuajtjes, etj. Kërkimi i lëmoshës është i pranishëm në shumë krijime të Migjenit, andaj përmes këtij dokumentari ne mund t'i kuptojmë shumë mirë veprat e tij.

## Fushat e kurrikulës

Gjuhët dhe Komunikimi, Jeta dhe Puna, Shoqëria dhe Mjedisi.

## Përshtatshëm për

Shkallën V dhe VI të Kurrikulës së Kosovës, Klasa XI dhe XII

## Kompetencat

I. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit (1. Ritregon ngjarjen e një teksti të dëgjuar nga mjetet auditive, audiovizuale apo nga mësimdhënësi; 2. Shpreh për 3-5 minuta para moshatarëve dhe të tjerëve përjetimet dhe emocionet që e kanë shoqëruar gjatë shikimit të filmit "Ergys")
II. Kompetenca e të menduarit (Parashtron pyetje dhe u përgjigjet pyetjeve për temën/problemin e dhënë në njërën nga format e të shprehurit).

III. (Kompetenca personale (Bashkëpunon me të tjerët pavarësisht prejardhjes, aftësive dhe nevojave të veçanta për arritjen e një qëllimi të përbashkët në aktivitet në klasë/shkollë apo jashtë saj)
IV. Kompeteca qytetare (Identifkon vlera shoqërore që kultivohen në klasë, në shkollë apo në familje si, p.sh. besimin e ndërsjellë, tolerancën, solidaritetin, respektin ndaj familjes, mirësjelljen ndaj të tjerëve, etj.)

## Objektivat

Të njohim personazhet e Migjenit, Diskutojnë për angazhimin e fëmijëve në punë, Roli i shoqërisë për ti mbrojtur fëmijët nga diskriminimi, Analizon personazhet e Migjenit dhe raportet me shoqërinë e mjedisin ku kanë jetuar.

## Pikat e diskutimit

Ekonomitë familjare dikur dhe sot
Cilët janë disa faktorë që i detyrojnë fëmijët të kërkojnë rrugëve "bukën e gojës"?
Roli i shoqërisë, i prindërve në edukimin e fëmijëve.

## Aktivitetet

### Pjesa Hyrëse: Stuhi mendimesh (5 min)

Diskutohet me nxënës për faktorët që i detyrojnë fëmijët të dalin rrugëve. Tregojnë ndonjë rast që kanë parë fëmijë në rrugë duke kërkuar lëmoshë.

### Pjesa Kryesore: Shikimi i filmit (10 min)

Nxënësve u kërkohet që gjatë prezantimit të filmit "Ergys" të mbajnë shënime dhe pas mbarimit të filmit të diskutojnë për to.

### Rrjeti i Diskutimit (20 min)

Pas mbarimit të filmit nxënësve u shpërndahen fletë me një fragment nga vepra e Migjenit "Poema e Mjerimit" njërit grup dhe "Luli i Vocërr" grupit tjetër, pastaj diskutojnë për pikat që janë të parapara më lartë (shënohen në tabelë).

### Pjesa përfundimtare: Stuhi mendimesh (5 min)

Pyeten nxënësit nëse kanë diçka për të diskutuar për mjerimin. Japin ndonjë këshillë për edukimin e fëmijëve që të mos dalin të kërkojnë lëmoshë rrugëve.



Njësia mësimore

Letërsi shqipe, Kronikë në gur - Ismail Kadare

# Kapllan

**Regjia: Kenan Pallusha**

## Përshkrimi i filmit

Përgatitur nga
Nuhi Kuçi, SH. M. "Skënderbeu" Kaçanik

Në filmin dokumetar "Kapllan" trajtoht fati i një çifti të vjetër që jeton i vetëm në një fshat, i cili është braktisur nga fshatarët gjatë luftës. Pas luftës nuk ka ndryshuar asgjë.

Ky çift tregon besimin e fshatit. Plaku ka qenë në burg për vrasje dhe ai tregon një histori për luftën.

Ky dokumentar përshtatet me një fragment të romanit të Kadaresë "Kronikë në Gur" në të cilën trajtohet fati i një plaku i cili tregon përjetimet që ka pasur në atë fshat.

Pjesa titullohet "Babazoti" në të cilën Kadareja e lidhë historinë e fshatit me historinë e plakut dhe që kanë pasur përjetime të njëjta edhe fshati, edhe plaku.

## Fushat e kurrikulës

Gjuhët dhe Komunikimi;
Jeta dhe Puna;
Shoqëria dhe Mjedisi.

## Përshtatshëm për

Shkalla V, VI. Klasa: XI, XII

## Kompetencat

I. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit (Paraqet para një audience të caktuar, përmes së paku një forme të komunikimit çështjet thelbësore të ngritura në këtë pjesë. Shpreh mendimin e lirë, opinionin dhe qëndrimin për një temë të caktuar nga jeta duke përdorur forma të ndryshme të komunikimi me gojë, me shkrim, film dokumentar, krijim, letrar etj.)
II. Kompetenca e të menduarit (Bën hulumtim në mënyrë të pavarur për një çështje të caktuar, pra, për jetën në fshat. Interviston ndonjë të moshuar. Përpunon në mënyrë kritike informatat e mbledhura nga burime të ndryshme për ndonjë temë të ndjeshme në shoqëri, formon qëndrim kritik dhe e paraqet atë gjatë një debati me moshatarë dhe me të tjerë për çështjen e ngritur, 'për' ose 'kundër')
III. Kompetenca personale (Diskuton në grup për mënyrat e bashkëpunimit me të tjerët për të zgjidhur një situatë të re mësimore.)
IV. Kompeteca qytetare (Prezanton mënyrën e funksionimit të mjedisit shoqëror në nivel lokal dhe me gjerë, si dhe me shembuj konkret tregon kontributin e vet në ruajtjen dhe trashëgimisë kulutore).

## Objektivat

-Identifikon tematikën që trajtohet në këtë vepër;
-Analizon fatin e plakut shqiptar që lidhet me historinë e fshatit;
-Diskuton për raportet mes gjeneratave.

## Pikat e diskutimit

Çka duhet të bëjmë që t'i ruajmë traditat tona?
Si t'a ruajmë të kaluarën tonë?
Raportet familjare dikur dhe sot.

## Aktivitetet

**Pjesa Hyrëse: Stuhi mendimesh (5 min).**
Bashkëbisedojmë me nxënës për raportet familjare, jetën në fshat dhe lidhjen e jetës shqiptare me të kaluarën tonë. Tregojnë ndonjë moment kur kanë vizituar ndonjë fshat të tillë, ose ndonjë të moshuar.
**Pjesa Kryesore: Shikimi i filmit "Kapllan" (10 min).**
Nxënësve u kërkohet që gjatë prezantimit të filmit "Kapllan" të mbajnë ndonjë shënim, ndonjë fjalë dhe pas mbarimit të filmit të diskutojnë për të.
**Rrjeti i Diskutimit dhe stuhi mendimesh (20 min).**
Pas mbarimit të filmit nxënësve u shpërndahen fletë me fragmentin "Babazoti" nga vepra e Ismail Kadaresë "Kronikë në Gur", në të cilin fragment trajtohet fati i plakut Babazot, që lidhet me historinë e fshatit shqiptar. Pastaj bashkëbisedojnë për pikat e diskutimit që janë të parapara më lartë, (shënohen në tabelë). 1. Çka duhet të bëjmë që t'i ruajmë traditat tona? 2. Si t'a ruajmë të kaluarën tonë? 3. Raportet familjare dikur dhe sot.
**Pjesa përfundimtare: Bashkëbisedim (5 min).**
Pyeten nxënësit nëse kanë diçka për të diskutuar për jetën dikur dhe sot. Bashkëbisedojmë për shprehjen "Më mirë vonë se kurrë"

**Vlerësimi.**
Përgjatë kësaj ore mësimi, bëjmë vlerësim të vazhdueshëm me gojë për përparimin e nxënësve, me qëllim identifikimin e njohurive, interesave, aftësive apo shkathtësive që kanë fituar nxënësit në lidhje me tematikën e trajtuar gjatë mësimit. Këtë vlerësim mund ta shoqërojmë edhe me shënime specifike për nivelet e të nxënit sipas rastit, pra mund të vendosi edhe notë në tabelarët për vlerësim.

**Detyrë shtëpie.**
1. Përshkruaje ndonjë fshat të braktisur. 2. Intervistë me një të moshuar.



Njësia mësimore

Letërsi shqiptare, Fati i Dijës si femër te romani "Sikur të isha djalë" i Haki Stërmillit

# Kjo është Tringa

**Regjia: Tringa Berisha**

Përgatitur nga
Nuhi Kuçi, SH. M. "Skënderbeu" Kaçanik

## Përshkrimi i filmit

Në filmin dokumetar "Kjo është Tringa" përshkruhet historia e Tringës, e cila tregoj përvojën e saj gjtë shkollës së mesme. Tregon se shpeshherë është ndjerë e vetmuar, edhe pse në fotot e saj që i ka postuar në rrjete sociale shihet sikur është e lumtur.

Ajo tregon se ka qenë e lënë anash nga bashkëmoshatarët, e nënçmuar, por Tringa është munduar që këtë brengë të mos e shpreh para të tjerëve. Për këtë qëllim ajo poston foto ku shihet e lumtuar, por pas atyre fotove është një person krejt ndryshe, e mbyllur në vetëvete, e vuajur.

Përmes këtij filmi dokumentar ne mund të kuptojmë shumë mirë fatin e Dijës si femër te vepra e Haki Stërmillit, e cila jeton jetën e vet ndërmjet relitetit dhe ëndrrës. Në këtë vështrim Dija nuk është tregim i një fati njerëzor, por edhe sibolizim i një jete shoqërore. Në këtë mënyrë, në vend të veprimit të rebeluar , kemi flijimin sentimental siç ngjet në letërsi, në shumë vepra të autorëve.

## Fushat e kurrikulës
Gjuhët dhe Komunikimi, Jeta dhe Puna, Shoqëria dhe Mjedisi.

## Përshtatshëm për
Shkalla V, VI. Klasa XI, XII.

## Kompetencat
I. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit (Paraqet para një audience të caktuar, përmes së paku një forme të komunikimit çështjet thelbësore të ngritura në një vepër. Shpreh mendimin e lirë, opinionin dhe qëndrimin për një temë të caktuar nga jeta duke përdorur forma të ndryshme të komunikimi me gojë, me shkrim, film dokumentar, krijim letrar etj.)

II. Kompetenca e të menduarit (Bën hulumtim në mënyrë të pavarur për një çështje të caktuar, pra, për emancipimin e femrës shqiptare; Përpunon në mënyrë kritike informatat e mbledhura nga burime të ndryshme për ndonjë temë të ndjeshme në shoqëri, formon qëndrim kritik dhe e paraqet atë gjatë një debati me moshatarë dhe me të tjerë për çështjen e ngritur, 'për' ose 'kundër").

III. Kompetenca personale (Diskuton në grup për mënyrat e bashkëpunimit me të tjerët për të zgjidhur një situatë të re mësimore).

IV. Kompeteca qytetare (Prezanton mënyrën e funksionimit të mjedisit shoqëror në nivel lokal dhe me gjerë, si dhe me shembuj konkretë tregon kontributin e vet në ruajtjen dhe kultivimin e vlerave të mjedisit).

## Objektivat
-Identifikon tematikën që trajtohet në këtë vepër;
-Analizon fatin Dijës si femër shqiptare në kohën kur është shkruar vepra;
-Diskuton për kapërcimin e kësaj çështjeje edhe në kohën e sotme.

## Pikat e diskutimit

Pse femrat kanë qenë të diskriminuara në shumë aspekte?
A mund të themi se femrat janë më të ndjeshme?
A duhet ta mbajmë sekretin...?

## Aktivitetet

### Pjesa Hyrëse: Studi mendimesh (5 min)
Bashëbisedojmë me nxënës për botën mashkullore dhe femërore, emocionat që kanë për të njëjtën gjë. Tregojnë ndonjë moment kur janë ndjerë të diskriminuar.

### Pjesa Kryesore: Shikimi i filmit "This is tringa" (10 min)
Nxënësve u kërkohet që gjatë prezantimit të filmit "This is Tringa " të mbajnë ndonjë shënim, ndonjë fjalë dhe pas mbarimit të filmit të diskutojnë për të.

### Rrjeti i Diskutimit dhe stuhi mendimesh ( 20 min )
Pas mbarimit të filmit nxënësve u shpërndahen fletë me një fragment nga vepra e Haki Stërmillit, në të cilën tratohet fati i Dijë si femër dhe pastaj bashkëbisedojnë për pikat e diskutimit që janë të parapara më lartë, (shënohen në tabelë): -Pse femrat kanë qenë të diskriminuara në shumë aspekte? A mund të themi se femrat janë më të ndjeshme? A duhet ta mbajmë sekretin...?



Njësia mësimore

Letërsi shqiptare, Vepra " Doktor Gjilpëra zbulon rrënjët e dramës së Mamurrasit"

# Këta jemi ne

**Regjia: Arta Elezi**

Përgatitur nga
Nuhi Kuçi, SH. M. "Skënderbeu" Kaçanik

## Përshkrimi i filmit

Në filmin dokumetar "Këta jemi ne" trajtohet fati i një familjeje shqiptare e cila emigron në Gjermani për një jetë më të mirë, por pas dite viteve qëndrimi atje, ata vendosin të kthehen në Kosovë.

Tregojnë përjetimet që kanë pasur atje në vend të huaj dhe mungesa e shumë gjërave shqiptare, sidomos mungesa e gjuhës shqipe. Tani jetojnë në Kosovë, edhe pse nuk kanë shumë kushte të mira ekonomike, por janë të lumtur që jetojnë në vendin e tyre, edukohen sipas traditave shqiptare dhe flasin shqip.

Përmes këtij filmi dokumentar ne mund të gjejmë ngjashmëri me veprën e Faik Konicës "Doktor Gjilpëra zbulon rrënjët e dramës së Mamurrasit" në të cilën protaganisti Dr.
Gjilpëra studion jashtë Shqipërisë dhe vendos që të kthehen në atdhe e t'i shërbej vendit.

## Fushat e kurrikulës
Gjuhët dhe Komunikimi, Jeta dhe Puna, Shoqëria dhe Mjedisi

## Përshtatshëm për
Shkalla V, VI. Klasa XI, XII

## Kompetencat
I. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit (Paraqet para një audience të caktuar, përmes së paku një forme të komunikimit çështjet thelbësore të ngritura në një vepër.
-Shpreh mendimin e lirë, opinionin dhe qëndrimin për një temë të caktuar nga jeta duke përdorur forma të ndryshme të komunikimi me gojë, me shkrim, film dokumentar, krijim letrar etj. Angazhohet dhe kontribuon në një diskutim me të tjerët për një temë të caktuar, p.sh. për edukimin medial, duke paraqitur argumente të bazuara në fakte për rolin dhe ndikimin e televizionit, radios, shtypit dhe mjeteve të tjera të informimit në shoqëri, në procesin e përgatitjes së të rinjve për jetë të pavarur dhe orientim në karrierë)
II. Kompetenca e të menduarit (Përpunon në mënyrë kritike informatat e mbledhura nga burime të ndryshme për ndonjë temë të ndjeshme në shoqëri, formon qëndrim kritik dhe e paraqet atë gjatë një debati me moshatarë dhe me të tjerë për çështjen e ngritur, 'për' ose 'kundër")
III. Kompetenca personale (Diskuton në grup për mënyrat e bashkëpunimit me të tjerët për të zgjidhur një situatë të re mësimore)
IV. Kompeteca qytetare (Me shembuj argumenton ndërlidhjet midis punës, profesionit dhe karrierës, në një punim/prezantim me shkrim prej jo më pak se 1000 fjalësh, në përmbledhje të punimit/prezantimit ofron shembuj të shfrytëzimit të mundësive në dispozicion për arsimim dhe përgatitje profesionale ose këshillim në karrierë)

## Objektivat
-Njeh portretizimin dituror, moral e shpirtëror të protaganistit të veprës;
-Njeh subjektin e veprës së Konicës;
-Analizon personazhet, marrëdhëniet ndërmjet tyre, mjedisin, rolin dhe funksionin e tyre.

## Pikat e diskutimit

Cilët janë disa faktorë që kanë ndikur për të shkuar shqiptarët në mërgim?
Përparësitë dhe mangësitë e mërgimit!
A duhet të kthehemi në atdhe?

## Aktivitetet

### Pjesa Hyrëse: Studi mendimesh (5 min)
Bashkëbisedojmë me nxënës për mërgimin, plagë e pashëruar. Tregojnë ndonjë përvojë që kanë pasur vetë, ose me familarët tyre në mërgim.

### Pjesa Kryesore: Shikimi i filmit (10 min)
Nxënësve u kërkohet që gjatë prezantimit të filmit " Këta jemi ne" të mbajnë ndonjë shënim, ndonjë fjalë dhe pas mbarimit të filmit të diskutojnë për të. Rrjeti i Diskutimit dhe stuhi mendimesh (20 min) Pas mbarimit të filmit nxënësve u shpërndahen fletë me një fragment nga vepra e Konicës "Dr. Gjilpëra..." dhe pastaj bashkëbisedojnë për pikat e diskutimit që janë të parapara më lartë, ( shënohen në tabelë ) -Cilët janë disa faktorë që kanë ndikur për të shkuar shqiptarët në mërgim? -Përparësitë dhe mangësitë e mërgimit! -A duhet të kthehemi në atdhe?



Njësia mësimore

"Akuza për kopje" Aziz Nesin, pjesë nga vepra "Fëmijët e Sotëm"

# Mes Rreshtave

**Regjia: Lum Borovci, Ideal Nrecaj, Freskim Nrecaj**

Përgatitur nga
Nuhi Kuçi, SH. M. "Skënderbeu" Kaçanik

## Përshkrimi i filmit

Arsimi i Lartë në Kosovë vështirë po zhvillohet, pasi ekosistemi i tij akademik është pllakosur vazhdimisht nga shembuj të plagjiaturës së qartë. Ky fenomen dhe implikimet e tij në komunitetet e fakulteteve dhe më gjerë paraqiten përmes lenteve të aktivistëve, profesionistëve të arsimit dhe inovatorëve, secili duke dhënë perspektivën e tyre unike mbi situatën. Arsimi konsiderohet si themeli i të gjithë zhvillimit dhe prosperitetit shoqëror; në rastin e Kosovës, fati i saj mbetet i rrethuar nga pasiguria.

Ky film është i përshtatshëm për romanin e autorit Aziz Nesin "Fëmijët e Sotëm", pikërisht te pjesa me titull "Akuza për kopje" në të cilën flitet për një grup nxënësish që bashkëbisedojnë për kopjimet që i kanë bërë në shkollë. Pra, ata tregojnë mënyrat që i kanë përdorur edhe prindërit e tyre në shkollë gjatë testeve në lëndë të ndryshme. Ata tregojnë se "Kopja është një turp i madh. Me kopje nuk gënjen tjetrin, por veten".

## Fushat e kurrikulës
Gjuhët dhe komunikimi

## Përshtatshëm për
Shkalla VI; Klasa XII.

## Kompetencat
Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit - Paraqet para një audience të caktuar, përmes së paku një forme të komunikimit çështjet thelbësore të ngritura në një vepër-film; Shpreh mendimin e lirë, opinionin dhe qëndrimin për një temë të caktuar nga jeta duke përdorur forma të ndryshme të komunikimi me gojë, me shkrim, film dokumentar, krijim letrar etj.; Angazhohet dhe kontribuon në një diskutim me të tjerët për një temë të caktuar, p.sh. për edukimin medial, duke paraqitur argumente të bazuara në fakte për rolin dhe ndikimin e kopjimit–plagjiaturës, në procesin e përgatitjes së të rinjve për jetë të pavarur dhe orientim në karrierë.

Kompetenca e të menduarit - Përpunon në mënyrë kritike informatat e mbledhura nga burime të ndryshme për ndonjë temë të ndjeshme në shoqëri, formon qëndrim kritik dhe e paraqet atë gjatë një debati me moshatarë dhe me të tjerë për çështjen e ngritur, 'për' ose 'kundër" kopjimit.

Kompetenca personale - Diskuton në grup për mënyrat e bashkëpunimit me të tjerët për të zgjidhur një situatë të re mësimore, pra për të mos kopjuar.

## Objektivat
Njohin temën që është përdorur në film dhe tregim;
Diskutojnë për pasojat e kopjimit-plagjiaturës;
Analizojnë pasojat që i ka kopjimi.

## Pikat e diskutimit

Pse njerëzit përdorin kopjimin-plagjiaturën?
Si mund ta eliminojmë kopjimin?
Pse loja dhe humori janë shpesh motive të rëndësishme në letërsi?

## Aktivitetet

### Stuhi mendimesh (5 min.)
Bashkëbisedojmë me nxënës për autorin dhe veprën, japin mendime të përgjithshme me njohuritë që kanë. Tregojnë për periudhën, tematikën e veprave të autorit.

### Rrjeti i diskutimit (30 min.)
Fillimisht lëshoj filmin "Mes Rreshtave" dhe nxënësve u sugjerohet që të mbajnë ndonjë shënim gjatë kohës sa shikojnë filmin, ndonjë moment që iu bënë përshtypje, ndonjë fjalë dhe e diskutojmë pas shfaqjes. Pas filmit nxënësve u shpërndahen fletë me një fragment nga romani "Fëmijët e Sotëm" i autorit Aziz Nesin, pra pjesën me titull "Akuza për kopje" dhe u kërkohet që ta lexojnë. Shënoj në tabelë pikat për diskutim: 1. Pse njerëzit përdorin kopjimin-plagjiaturën ? 2.Si mund ta eliminojmë kopjimin - pasojat e tij? 3. Pse loja dhe humori janë shpesh motive të rëndësishme në letërsi?

### Braimstorming (5 min.)
Nxënësit diskutojnë diçka që kanë shkruar gjatë filmit apo gjatë leximit të pjesës së leximit. Tregojnë ndonjë përvojë të tyre gjatë kopjimit në shkollë.



Njësia mësimore

Kultura tradicionale (Kl. X )

Kanuni i Lekë Dukagjinit, ( kl. X )

Krijimtaria gojore shqiptare ( kl. X )

# Nën Duvak

**Regjia: Entela Hoxha**

Përgatitur nga
Nuhi Kuçi, SH. M. "Skënderbeu" Kaçanik

## Përshkrimi i filmit

"Paqi nevojë për mu, aq sa keni për pare" Filmi dokumentar "Nën Duvak" trajton martesën tradicionale në Malësinë e Hasit, se si në të kaluarën vajzat janë martuar. Shikuar në mënyrë kronologjike vajzat dhe gratë në shoqërinë tonë në përgjithësi më shumë kanë shërbyer në kujdesin familjar në përgjithësi, thuajse as pak nuk janë marrë në konsideratë mendimet apo vendimet që kanë të bëjnë me jetën e tyre, siç janë; shkollimi apo martesa.

Tek ky film gjejmë kryesisht se cila ka qenë mundësia në mes të përzgjedhjes apo dëshirave në raport me familjen lidhur me vendimin e martesës, që do të thotë se përzgjedhja e partnerëve për martesë nuk përcaktohej nga dashuria por ishin prindërit ata që vendosni për fëmijët e tyre sa i përket martesës, ku imponimi ndërlidhet si mohimi i të drejtave të njeriut. Qysh nga fëmijëria vajzat janë rritur me idenë se duhet të hynë në martesë, të krijojnë familje, janë këshilluar brez pas brezi në këtë mënyrë jetese. Kujdesi për mirëqenien e saj, psiko-social, nuk ka ekzistuar, por është krijuar izolimi dhe neglizhimi ndaj dëshirave, qëllimeve dhe ëndrrave të vajzave. E gjithë kjo mund të ketë ndikuar në mos krijimin e identitetit personal dhe përgjithësimin e tipareve të vetëpersonalitetit.

Kur e analizojmë në kontekstin kohor të tanishëm, ajo trajtohet më shumë si vegël materiale dhe shfrytëzuese për familjen ku do të jetoj. Në vazhdimësi të filmit kemi inserte se si gruaja trajtohet si pronë e burrit, e në ato rrethana një gjë e tillë konsiderohet si çështje normale, ku burri është ai që merr vendime për jetën e saj. Krahasimi i jetës familjare dhe i marrëdhënieve martesore në ditët e sotme me ato të priudhave të hershme, tregon se familja ka ndryshuar në mënyrë të dukshme si i përket mënyrës së stilit të jetesës.

## Fushat e kurrikulës
Shoqëria dhe mjedisi, Gjuhë dhe komunikim.

## Përshtatshëm për
Shkallën 4, 5, 6 Klasat IX, X, XII.

## Kompetencat
Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit;
Kompetenca e të menduarit;
Kompetenca për jetë, punë dhe mjedis;
Kompetenca qytetare.

## Objektivat
-Aftësim për mësim gjatë gjithë jetës;
-Promovimi i vlerave kulturore dhe qytetare.

## Pikat e diskutimit

Si e perceptoni martesën në këtë film?
Cili është roli vendimmarrës i personave në këtë film?
Cilat janë pasojat e martesave të hershme?
Krahasimi i martesave në periudha kohore.
Çfarë ndikimi ka imponimi i martesës në gjendjen emocionale?
Mungesa shkollore, pasojë e inferioritetit në shoqëri.
Patriarkaliteti dominant në familje dhe shoqëri.

## Aktivitetet

### Evokim – Stuhi mendimesh
Në fillim të orës mësimore pyesim nxënësit se çfarë njohurie kanë për martesën tradicionale në shoqërinë tonë dikur dhe tani. Bëjmë një hyrje të shkurtër dhe shkëmbejmë pyetje dhe përgjigje rreth asaj se çka kemi në fokus. Më pas shikojmë filmin.

### Realizimi – Këndet
Pas përfundimit të filmit marrim mendimet e përgjithshme për filmin, më pastaj nxënësit i informojmë për referencat që do të marrin në lidhje me filmin, ku do të kenë mundësinë të shënojnë në fletë ndonjë detaj nga ajo që shohin, që do të ju shërbej si pikë reference për diskutim. Ndahen në dy grupe dhe shënojnë pikat e diskutimit që do të realizohen.

### Reflektim
Pasi përcaktohemi për pikat e diskutimit i ndajmë nxënësit në dy grupe ku diskutohet. Grupi i parë do të mbrojë pikën e diskutimit: Martesa bashkëkohore dhe rolet gjinore; Grupi i dytë do të mbrojë pikën e diskutimit: Martesa tradicionale dhe rolet gjinore. Të dy nga grupet, do të mbrojnë gjithë përmbledhjen e diskutimit. Detyrë për nxënësit: Sygjerojmë nxënësit në mënyrë individuale të mbledhin më shumë materiale për këto dy pika diskutimi dhe të reflektojnë me një ese të analizuar me kritikën e tyre.



Njësia mësimore

Letërsi shqiptare, Ndre Mjeda - "Andrra e jetës"

# Pa vlla

**Regjia: Alba Demiri, Genta Sefa**

Përgatitur nga
Nuhi Kuçi, SH. M. "Skënderbeu" Kaçanik

## Përshkrimi i filmit

Në filmin dokumentar "Pa Vlla" katër gra, një histori. E rrëfyer në gjithë Kosovën. Barra e të qenit vajzë, në familjet pa djem. Plot ankth, paragjykim dhe guxim. Pa vlla! Një film i kapërcimit të streotipit gjinor!

Kjo temë është trajtuar në disa vepra të autorëve shqiptarë, sepse është një brengë që i ka brengusur të gjitha nënat shqiptare. Shumë familje kanë qenë të paragjykuara nga mungesa e një mashkulli në shtëpi, por tani kjo temë në shumicën e familjeve është tejkaluar dhe nuk e kanë më këtë brengë.

Një temë e tillë është trajtuar edhe nga Ndre Mjeda te vepra "Andrra e Jetës" për fatin e Lokës dhe vajzave të saj Trinës dhe Zogës. Lokja brengoset se nuk ka trashëgimtar.

## Fushat e kurrikulës
Gjuhët dhe Komunikimi;
Jeta dhe Puna;
Shoqëria dhe Mjedisi.

## Përshtatshëm për
Shkalla V, VI. Klasa: XI, XII

## Kompetencat
I. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit (Paraqet para një audience të caktuar, përmes së paku një forme të komunikimit çështjet thelbësore të ngritura në një vepër. Shpreh mendimin e lirë, opinionin dhe qëndrimin për një temë të caktuar nga jeta duke përdorur forma të ndryshme të komunikimi me gojë, me shkrim, film dokumentar, krijim letrar etj).

II. Kompetenca e të menduarit (Bën hulumtim në mënyrë të pavarur për një çështje të caktuar, pra, jetën pa djem, pa burra në shtëpi etj. Përpunon në mënyrë kritike informatat e mbledhura nga burime të ndryshme për ndonjë temë të ndjeshme në shoqëri, formon qëndrim kritik dhe e paraqet atë gjatë një debati me moshatarë dhe me të tjerë për çështjen e ngritur, 'për' ose 'kundër").

III. Kompetenca personale (Diskuton në grup për mënyrat e bashkëpunimit me të tjerët për të zgjidhur një situatë të re mësimore).

IV. Kompeteca qytetare (Prezanton mënyrën e funksionimit të mjedisit shoqëror në nivel lokal dhe me gjerë, si dhe me shembuj konkret tregon kontributin e vet në ruajtjen dhe kultivimin e vlerave të mjedisit).

## Objektivat
-Identifikon tematikën që trajtohet në këtë vepër;
-Analizon fatin e Lokës që nuk ka trashëgimtarë;
-Diskuton për kapërcimin e kësaj çështjeje edhe në kohën e sotme.

## Pikat e diskutimit

Roli i mashkullit në familjet shqiptare.
Roli i femrës sot, në familjet shqiptare.
Emancipimi i familjeve shqiptare.

## Aktivitetet

### Pjesa Hyrëse: Studi mendimesh (5 min).
Bashkëbisedoj me nxënës për botën mashkullore dhe femërore, raportet që kanë pasur në familje, familjet pa mashkull në shtëpi, motrat pa vëlla. Tregojnë ndonjë moment kur janë ndjerë të diskriminuar.

### Pjesa Kryesore: Shikimi i filmit (10 min).
Nxënësve u kërkohet që gjatë prezantimit të filmit "Pa Vlla" të mbajnë ndonjë shënim, ndonjë fjalë dhe pas mbarimit të filmit të diskutojnë për të.

### Rrjeti i Diskutimit dhe stuhi mendimesh (20 min).
Pas mbarimit të filmit nxënësve u shpërndahen fletë me një fragment nga vepra e Mjedës "Andrra e Jetës" në të cilën trajtohet fati i Lokës dhe vajzave të saj Trinës dhe Zogës. Këto simbolizojnë fëmijërinë, rininë dhe pleqërinë. Lokja bregoset që nuk ka trashëgimtar dhe nuk ka kush ta ripërtërij oxhakun. Pas leximit të fragmentit, në tabelë i shënojmë pikat për diskutim.



Njësia mësimore

Letërsi shqiptare, Faik Konica - “Malli i atdheut”

# Provimi

**Regjia: Lulzim Zeqiri**

Përgatitur nga
Nuhi Kuçi, SH. M. "Skënderbeu" Kaçanik

## Përshkrimi i filmit

Filmi dokumetar “Provimi” është një dokumentar prekës e personal duke dokumentuar një pesëdhjetë e katër vjeçare, emigrante nga Kosova derisa përpiqet të kalojë një provim shumë të rëndësishëm në gjuhën gjermane. Piktori dhe video-artisti Zeqiri etablon një Austri të ftohtë dhe të pafalshme përmes dritares së banesës së nënës së tij, ndërsa lufton përmes fjalëve dhe frazave të vështira.

Pra, përshkruhet jeta e vështirë në dhe të huaj, vështirësitë që kanë shqiptarët në mërgim.

Ky film dokumentar përshtatet me tekstin e Faik Konicës “Malli i Atdheut” në të cilin Konica shpreh ndjenjat e një të mërguari, i cili në fillim niset me plot gëzim për mërgim, por me kalimin e kohës gazi shuhet pak nga pak.

Vetëm ai që e ka përjetuar jetën në mërgim e kupton këtë ndjenjë, mungesën e vendlindjes, gjuhës dhe kulturës.

## Fushat e kurrikulës
Gjuhët dhe Komunikimi;
Jeta dhe Puna;
Shoqëria dhe Mjedisi.

## Përshtatshëm për
Shkalla V, VI. Klasa XI, XII

## Kompetencat
I. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit (Paraqet para një audience të caktuar, përmes së paku një forme të komunikimit çështjet thelbësore të ngritura në një vepër. Shpreh mendimin e lirë, opinionin dhe qëndrimin për një temë të caktuar nga jeta duke përdorur forma të ndryshme të komunikimi me gojë, me shkrim, film dokumentar, krijim letrar etj)
II. Kompetenca e të menduarit (Bën hulumtim në mënyrë të pavarur për një çështje të caktuar, pra, jetën e shqiptarëve në mërgim, gjuhën e tyre, kulturën etj. Përpunon në mënyrë kritike informatat e mbledhura nga burime të ndryshme për ndonjë temë të ndjeshme në shoqëri, formon qëndrim kritik dhe e paraqet atë gjatë një debati me
moshatarë dhe me të tjerë për çështjen e ngritur, 'për' ose 'kundër")
III. Kompetenca personale (Diskuton në grup për mënyrat e bashkëpunimit me të tjerët për të zgjidhur një situatë të re mësimore)
IV. Kompeteca qytetare (Prezanton mënyrën e funksionimit të mjedisit shoqëror në nivel lokal dhe me gjerë, si dhe me shembuj konkretë tregon kontributin e vet në ruajtjen dhe kultivimin gjuhës dhe kulturës shqiptare në përgjithësi)

## Objektivat
–Përshkruan jetën në dhe të huaj;
–Tregon ndjenjat e të mërguarit;
–Analizonë porosinë në fund të tregimit.

## Pikat e diskutimit
Pse shqiptarët kanë qenë të detyruar ta marrin rrugën e mërgimit?
Gurbeti dikur dhe sot, të diskutohet.
Mërgimi - çfarë duhet të bëjmë që të shërohet kjo plagë?

## Aktivitetet
**Pjesa Hyrëse: Stuhi mendimesh (5 min).**
Bashkëbisedojmë me nxënës për rrugëtimin e shqiptarëve gjatë viteve, jetën e tyre në mërgim. Tregojnë ndonjë moment kur kanë provuar të emigrojnë, ose kanë dëgjuar ndonjë histori nga të tjerët për jetën në dhe të huaj.
**Pjesa Kryesore: shikimi i filmit "Provimi" (10 min).**
Nxënësve u kërkohet që gjatë prezantimit të filmit të mbajnë ndonjë shënim, ndonjë fjalë dhe pas mbarimit të filmit të diskutojnë për të.
Rrjeti i Diskutimit dhe stuhi mendimesh (20 min).
Pas mbarimit të filmit nxënësve u shpërndahen fletë me tekstin "Malli i Atdheut" të Faik Konicës. Pastaj bashkëbisedojnë për pikat e diskutimit që janë të parapara më lartë, (shënohen në tabelë). 1. Pse shqiptarët kanë qenë të detyruar ta marrin rrugën e mërgimit? 2. Gurbeti dikur dhe sot. 3. Çfarë duhet të bëjmë që të shërohet kjo plagë – Mërgimi?
**Pjesa Përfundimtare: Bashkëbisedim (5 min).**
Pyeten nxënësit nëse kanë diçka për të diskutuar për mërgimin, pasojat nga kjo dukuri, etj.

**Vlerësimi.**
Përgjatë kësaj ore mësimi, bëjmë vlerësim të vazhdueshëm me gojë për përparimin e nxënësve, me qëllim identifikimin e njohurive, interesave, aftësive apo shkathtësive që kanë fituar nxënësit në lidhje me tematikën e trajtuar gjatë mësimit. Këtë vlerësim mund ta shoqërojmë edhe me shënime specifike për nivelet e të nxënit sipas rastit, pra mund të vendosi edhe notë në tabelarët për vlerësim.

**Detyrë shtëpie.**
Hulumtoni mes librave dhe në internet për shpërnguljen e shqiptarëve në vende tjera. Bisedoni me një mërgimtar.



Njësia mësimore

Letërsi popullore shqiptare, Mitologjia, Përrallat shqiptare

# Shtojzovalle

**Regjia: Flutura Balaj**

Përgatitur nga
Nuhi Kuçi, SH. M. "Skënderbeu" Kaçanik

## Përshkrimi i filmit

Shtojzovallet, janë krijesa magjike e mitologjisë shqiptare që posedojnë fuqi supernatyrore dhe bukuri të jashtëzakonshme. Shpesh të hasura duke vallëzuar e kënduar në pyje, Shtojzovallet më në fund shihen edhe nga sytë e njerëzve. Pas shekujsh jetese rreth nesh, ato na ftojnë në realitetin e tyre mistik.

Duke na lënë të njoftohemi me superfuqitë e tyre, botën e tyre të bukur dhe pasionin për muzikën. Këto Shtojzovalle na ndihmojnë të reflektojmë mbi tërë mundësitë e humbura që kemi pasur për t'i parë dhe vlerësuar ato.

Në letërsinë shqiptare është mjaft e njohur figura mitologjike shtojzovalle. Në letërsinë popullore ka disa tregime ku e përmendin këtë figurë mitologjike me këto karakteristika, sidomos përmendet në përrallat shqiptare.

## Fushat e kurrikulës
Gjuhët dhe Komunikimi, Jeta dhe Puna, Shoqëria dhe Mjedisi

## Përshtatshëm për
Shkallën V dhe VI të Kurrikulës së Kosovës, Klasa XI dhe XII.

## Kompetencat
I. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit (1. Ritregon ngjarjen e një teksti të dëgjuar nga mjetet auditive, audiovizuale apo nga mësimdhënësi; 2. Shpreh për 3-5 minuta para moshatarëve dhe të tjerëve përjetimet dhe emocionet që e kanë shoqëruar gjatë shikimit të filmit "Shtojzavalle").

II. Kompetenca e të menduarit (Parashtron pyetje dhe u përgjigjet pyetjeve për temën Mitologjia/problemet e dhënë në njërën nga format e të shprehurit)

III. Kompetenca personale ( Bashkëpunon me të tjerët pavarësisht prejardhjes, aftësive dhe nevojave të veçanta për arritjen e një qëllimi të përbashkët në aktivitet në klasë/shkollë apo jashtë saj)

IV. Kompeteca qytetare (Identifkon vlera shoqërore që kultivohen në klasë, në shkollë apo në familje si, p.sh. besimin e ndërsjellë, tolerancën, solidaritetin, respektin ndaj familjes, mirësjelljen ndaj të tjerëve, etj.)

## Objektivat
–Njohin figurën e shtojzovalles që përmendet në përrallat shqiptare,
–Diskutojnë për rolin e tyre në shoqëritë primitive,
–Mos ekzistenca e shtojzovalleve, figurave mitologjike.

## Pikat e diskutimit

Cilat figura mitologjike janë të njohura në letërsinë popullore?
Roli i Shtojzovalleve në përrallat shqiptare.
Sa janë të besueshme në popull këto figura?

## Aktivitetet

### Pjesa Hyrëse: Stuhi mendimesh (5 min)
Diskutohet me nxënës për figurat mitologjike shqiptare. Tregojnë ndonjë rast që kanë dëgjuar për ndonjë figurë mitologjike

### Pjesa Kryesore: Shikimi i filmit (10 min)
Nxënësve u kërkohet që gjatë prezantimit të filmit "Shtojzavalle" të mbajnë shënime dhe pas mbarimit të filmit të diskutojnë për to.

### Rrjeti i Diskutimit (20 min)
Pas mbarimit të filmit nxënësve u shpërndahen një fletë me një përrallë shqiptare në të cilën përmendet edhe figura mitologjike e shtojzovalles. Në tabelë shënohen pikat për diskutim: Cilat figura mitologjike janë të njohura në letërsinë popullore? Roli i Shtojzovalleve në përrallat shqiptare.

### Pjesa përfundimtare: Stuhi mendimesh (5 min)
Pyeten nxënësit nëse kanë diçka për të diskutuar për Mitologjinë.



Njësia mësimore

Letërsi botërore, Raportet Familjare, Barazia gjinore

# Çika

**Regjia: Rrita Berisha**

## Përshkrimi i filmit

Përgatitur nga
Nuhi Kuçi, SH. M. "Skënderbeu" Kaçanik

Çika është film për lidhjen e një vajze me babain e saj. Ajo provon t'a përmirësoj atë në disa mënyra dhe më pas vendosë t'i bëj atij një befasi.

Ky film dokumentar lidhet me disa njësi mësimore të lëndës së letërsisë shqipe. Në shumë njësi të letërsisë përmenden raportet familjare, andaj edhe te filmi "Çika" trajtohen këto raporte ndërmjet një vajze dhe prindit të saj.
Vajza këkon ti rregulloj raportet me babain e saj dhe për këtë bënë shumë përpjekje, madje duke i organizuar atij edhe një befasi.

## Fushat e kurrikulës

Gjuhët dhe Komunikimi, Jeta dhe Puna, Shoqëria dhe Mjedisi

## Përshtatshëm për

Shkallën V dhe VI të Kurrikulës së Kosovës, Klasa XI dhe XII.

## Kompetencat

I. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit (1. Ritregon ngjarjen e një teksti të dëgjuar nga mjetet auditive, audiovizuale apo nga mësimdhënësi, 2. Shpreh për 3-5 minuta para moshatarëve dhe të tjerëve përjetimet dhe emocionet që e kanë shoqëruar gjatë shikimit të filmit "Çika")

II. Kompetenca e të menduarit (Parashtron pyetje dhe u përgjigjet pyetjeve për temën/problemin e dhënë në njërën nga format e të shprehurit)

III. Kompetenca personale (Bashkëpunon me të tjerët pavarësisht prejardhjes, aftësive dhe nevojave të veçanta për arritjen e një qëllimi të përbashkët në aktivitet në klasë/shkollë apo jashtë saj)

IV. Kompeteca qytetare (Identifkon vlera shoqërore që kultivohen në klasë, në shkollë apo në familje si, p.sh. besimin e ndërsjellë, tolerancën, solidaritetin, respektin ndaj familjes, mirësjelljen ndaj të tjerëve, etj.)

## Objektivat

–Njeh subjektin e romanit,
–Përcakton temën dhe idenë e tij,
–Dallon strukturën dhe elemente të stilit,
–Analizon personazhet, marrëdhëniet ndërmjet tyre, mjedisin, rolin dhe funksionin e tyr

## Pikat e diskutimit

Raportet familjare dikur dhe sot.
Cilat janë disa faktorë që kanë ndikuar në raportet familjare?
Roli i prindit në edukimin e fëmijës.

## Aktivitetet

### Evokimi: Rrjeti i Diskutimit (5 min)

Diskutohet me nxënës për raportet familjare Japin disa shembuj për respektimin e prindërve dhe kujdesin ndaj tyre.

### Realizim kuptimi: Shikimi i filmit (10 min)

Nxënësve u kërkohet që gjatë prezantimit të filmit "Çika" të mbajnë shënime dhe pas mbarimit të filmit të diskutojnë për to.

### Rrjeti i Diskutimit dhe stuhi mendimesh (20 min)

Pas mbarimit të filmit nxënësve u shpërndahen fletë me një fragment nga vepra e Balzakut "Xha Gorio " dhe pastaj diskutojnë për pikat e diskutimit që janë të parapara më lartë, (shënohen në tabelë). - Raportet familjare dikur dhe sot. - Cilat janë disa faktorë që kanë ndikuar raportet familjare? - Roli i prindit në edukimin e fëmijës.

### Reflektim (5 min)

Pyeten nxënësit nëse kanë diçka për të diskutuar për raportet familjare sot Japin ndonjë këshillë për respektimin e prindërve dhe fëmijëve.



skano këtu!

https://dokufest-lab.com/al/mesimdhenesit/histori

# Historí

Filma dokumentarë dhe materiale didaktike për lëndën e Historisë



Filmi dokumentar si një instrument për përmirësimin e procesit të mësimdhënies, si dhe zhvillimin e të menduarit kritik tek nxënësit trajton tema të ndryshme që evokojnë fenomene të ndryshme sociale.

# I kujt është flamuri?

**Regjia: Baris Karamuço**

Përgatitur nga
Gyltene Isufi, SH. M. "Zenit" Prishtinë

## Përshkrimi i filmit

Dihet se me gjenerata të tëra kanë jap jetën për flamurin kombëtar Kuq e Zi, nuk ka kuptim ta kemi këtë flamur, kur as me referendum, as me votë nuk e kemi pas të drejtën me zgjedhë". Filmi dokumetar "I kujt është flamuri" trajton temën e simbolit të flamurit të shtetit të ri të Kosovës dhe identitetin kosovar.

Gjithashtu në këtë film bëhet gërshetimi i flamurit Kuq e Zi dhe flamurit të Kosovës që njihet si flamur me gjashtë yje, e që ngareh linja paralele në mes të këtyre dy identiteve të përkatësisë kombëtare dhe identitetit.

Gëzuar ditëlindjen Kosovë!

## Fushat e kurrikulës
Gjuhët dhe Komunikimi, Shoqëria dhe Mjedisi.

## Përshtatshëm për
Shkallën kurrikulare 5 dhe 6, klasa XI - XII.

## Kompetencat
I. Kompetenca e të mësuarit,

II. Kompetenca qytetare,

III. Kompetenca personale,

IV. Kompetencat e komunikimit dhe të shprehurit.

## Objektivat
–Kultivimi i identitetit personal, kombëtar, përkatësia etnike,
–Promovimi i vlerave të përgjithshme kulturore dhe qytetare,
–Zhvillimi i përgjegjësinë ndaj vetes, ndaj të tjerëve, ndaj shoqërisë dhe ndaj mjedisit.

## Pikat e diskutimit
Identitet kombëtar, etniciteti, dilemat.
Cili flamur e përfaqëson identitetin e qytetarëve të Kosovës?
Perceptimet e qytetarëve lidhur me simbolet e Republikës së Kosovës.
Pranimi ose mohimi i simbolevekonkretisht flamurit të Kosovës nga gjeneratat e reja dhe të vjetra.
Perceptimi i simbolit të flamurit të Kosovës nga komunitetet tjera që jetojnë në Kosovë.
Dashuria për simbolet e shtetit të Kosovës, respekti, krenaria.
Lidhja emocionale me flamurin e Kosovës dhe flamurin Kuq e Zi: si një kujtim dhe marrëdhënie me kombin shqipëtar të cilit i përkasin.
Si kanë ndikuar rrethanat shoqërore në perceptimin dhe pranimin e indentitetit të kosovarëve?
Pjesa përbërëse e historisë në raport me flamurin Kuq e Zi dhe flamurin e Kosovës.
Ndikimi i institucioneve e sidomos ato arsimore në arsimimin e gjeneratave dhe ngritjene vetëdijës për simbolet shtetërore.
Sa i përfaqëson kosovarët flamuri dhe sa e paraqet thelbin e shtetit?
Tekstet shkollore në paraqitjen e historisë së Kosovës deri te shpallja e Pavarësisë dhe krijimit të simboleve shtetërore.

## Aktivitetet
### Evokim – Stuhi mendimesh
Ora e mësimit fillon diskutimin lidhur me dy çështje kryesore për debat: Me cilin flamur identifikoheni dhe cila është përkatsia e juaj etnike? Flamuri kuq e zi apo flamuri i Kosovës me yje? Kosovar apo Shqipëtar? Cila është lidhja emocionale që keni në raport me këta flamuj? Dashuri, respekt, krenari, kujtim, mohim, apati.

### Realizimi – Ditari dy pjesësh
Nxënësit zgjedhin nga një paragrafë nga teksi apo shkëpusin pjesë nga filmi dokumentar, për të komentuar arsyen e zgjedhjes. Më pas i tregohet nxënësve që fleta të ndahet në mes me një vijë vertikale kurse në anën e majtë shkruhen citatet nga teksti, kurse në të djathtë komentet.

### Reflektim - Diskutim në çift dhe grup
Nxënësit ndahen në dy grupe (Pro dhe Kundër) dhe diskutohet çështja e pranimit apo mohimit të flamurit të Kosovës dhe identitetit Kosovar.



skano këtu!

https://dokufest-lab.com/al/mesimdhenesit/psikologji

# Psikologji

Filma dokumentarë dhe materiale didaktike për lëndën e Psikologjisë



Njësia mësimore

Stresi dhe përballimi i tij

# Blinera n'rrjet

**Regjia: Laberion Nitaj**

Përgatitur nga
Jeta Rexha, SH. M. "Hajdar Dushi" Gjakovë

## Përshkrimi i filmit

Filmi dokumentar "Blinera në rrjet" është një film i cili flet për ndikimin e rrjeteve sociale tek të rinjtë, varësinë dhe stresin që shkakton.
Blinera, një vajzë 17 vjeçe tregon për peripecitë e saj të përditshme të postimit në instagram. Rrjeti nuk është gjë tjetër veçse magji për të, ajo tashmë po bëhet sfiduese.
Ngjarja zhvillohet në formën e intervistës.
- Në pyetjen që i bëhet Blinerës në lidhje me shpeshtësinë e postimeve në rrjetet sociale, ajo përgjigjet: "Postimet e mia varen nga ndjenjat e mia."
- Pastaj pyetet për kohëzgjatjen e të mos pasurit qasje në telefon. "Varet nga dita në ditë, por mendoj që 48 orë mundem me qëndru," përgjigjet ajo.
- A mendon se media sociale është bërë një shprehi e keqe që po na largon prej realitetit, apo diçka shumë e mirë për kohën që po jetojmë ne? Ajo pranon që media sociale na ka larguar nga realiteti, mirëpo vetë median sociale e quan realitet.
- A ka ndonjë moment që ke dashur me i mbyll krejt rrjetet sociale? "Ka pasur momente që kam dasht me i mbyll për shkak të ngarkesës dhe stresit që të krijojnë."
- A varet disponimi yt nëse merr shumë pëlqime? "Është shumë keq me thonë po, por po, disponimi im varet prej pëlqimeve në rrjete sociale."

## Fushat e kurrikulës
Shoqëria dhe Mjedisi

## Përshtatshëm për
Shkallën; 5, 6. Klasa: XI dhe XII.

## Kompetencat
I. Kompetenca e komunikimit dhe të të shprehurit - Komunikues efektiv (1. Shprehet përmes një forme të komunikimit, për një temë të caktuar në një material (prezantim) prej 200 fjalësh dhe veçon çështjet kryesore të ngritura në material/prezantim); (2. Diskuton në grup në mënyrë konstruktive, një diskutim në gjuhë amtare, apo në gjuhë angleze, në kohëzgjatje jo më shumë se 10 minuta, duke dhënë dhe duke marrë informata kthyese për një temë të caktuar nga ndonjë fushë mësimore formale dhe joformale etj.)
II. Kompetenca e të menduarit - Mendimtar kreativ (Në forma të ndryshme të të shprehurit prezanton mënyrën e grumbullimit, të zgjedhjes dhe të klasifikimit të informatave për fusha të ndryshme mësimore apo për një temë të caktuar, ofron argumente për zhvillimet aktuale lidhur me temën përkatëse p.sh., temë nga shkenca, nga kultura, nga arti, nga sporti, nga shëndetësia, nga shoqëria, nga mjedisi etj.).
III. Kompetenca e të nxënit - Nxënës i suksesshëm (Demonstron shkathtësi funksionale në lexim-shkrim, në matematikë, në jetën e përditshme, në përmbushjen e kërkesave të ndryshme për kryerjen e një detyre apo aktiviteti dhe gjatë të nxënit të dijeve të reja në ndoz
IV. Kompetenca personale - Individ i shëndoshë (1. Bënë zgjidhje të bazuara në informata dhe në përvoja të drejtpërdrejta për të mbrojtur shëndetin dhe mirëqenien nga rreziqet e ndryshme në jetën e përditshme p.sh., nga përdorimi i tepruar i teknologjisë; 2. Në jetën e përditshme vepron në mënyrë të pavarur dhe të përgjegjshme, duke përzgjedhur mënyra të shëndetshme jetese, apo duke iu përgjigjur në mënyrë të duhur situatave të rrezikshme me të cilat mund të ndeshet në jetën e përditshme).

## Objektivat
–Zhvilluar përgjegjësitë ndaj vetes, ndaj të tjerëve, ndaj shoqërisë dhe ndaj mjedisit.

## Pikat e diskutimit
Çfarë kuptoni me stres?
Cilat janë burimet e stresit?
Përmendni disa grupe stresorësh?
Përmendni disa strategji të përballimit të stresit?
A janë mediat sociale (instagram, facebook, snapchat) përvoja frustruese në jetën tuaj?
Si keni reaguar në situata të tilla? A mendoni që keni përdorur një apo më shumë strategji përshtatëse apo vetërregulluese?

## Aktivitetet
**Stuhi mendimesh.**
Çfarë është stresi për ju?

**Punë në grupe.**
Mësimdhënësi/ja i organizon duke i ndarë në tri grupe. Çdo grup zgjedh përfaqësuesin e tij. Më pas mësimdhënësi/ja ndan temat për secilin prej tyre: 1. Burimet e stresit: Stresorët 2. Reagimet ndaj stresit 3. Përballimi i stresit: Strategjitë Secili prej grupeve punon në mënyrë të pavarur për evidentimin dhe shtjellimin e çështjeve kryesore të trajtuara në çdo tematikë.

**Imagjinatë e drejtuar.**
Imagjinoni si do të ishte bota pa stres?



Njësia mësimore

Perspektiva mbi motivimin

# Ergys

**Regjia: Rina Celina**

## Përshkrimi i filmit

Përgatitur nga
Jeta Rexha, SH. M. "Hajdar Dushi" Gjakovë

Filmi dokumentar "Ergys" flet për një djal me emrin Ergys me prejardhje nga Shqipëria, por që jeton një kohë në Prizren. Që nga mosha 8 vjeçare Ergysi jeton vetëm me vëllain e tij adoleshent. Ata mbijetojnë duke kërkuar lëmoshë në rrugët e Prizrenit me shpresën se dikush do ta ndjejë lëkurën e tij duke u treguar human me të. Me një palë xhinse të papastra e me një bluzë ngjyrë kafe, Ergysi rri ulur mbi urën e gurit në Prizren, duke soditur kalimtarët tek lëvizin andej pari. Herë pas here ai tregon shpirtin e tij fëminor duke luajtur me bashkëmoshatarët të së njejtës etni.

Megjithëse jeta e ka sfiduar herët Ergysin, ai prap gjen kënaqësi në gjëra të vogla. Thuhet se njeriu që kënaqet me asgjë, i ka të gjitha që i duhen. Pjesën më të madhe të ditës e kalon në rrugë, herë i humbur e i dërmuar, e herë me shpresën dhe dëshirën për të vazhduar ditën ashtu siç i vie. Ergysi ka një talent prej vogëlushi e që është zëri i tij. Një grup të rinjësh kishin rrethuar Ergysin duke dëgjuar zërin e tij, tek pasqyronte pasionin e tij për këngën.

## Fushat e kurrikulës
Shoqëria dhe Mjedisi

## Përshtatshëm për
Shkallën; 5, 6. Klasa: XI dhe XII

## Kompetencat
I. Kompetenca e komunikimit dhe të të shprehurit - Komunikues efektiv (1. Shprehet përmes një forme të komunikimit, për një temë të caktuar në një material (prezantim) prej 200 fjalësh dhe veçon çështjet kryesore të ngritura në material (prezantim); 2. Lexon rrjedhshëm një tekst në gjuhën amtare, të përbërë prej 3-5 paragrafëve, u përgjigjet pyetjeve të shtruara për llojin e tekstit, stilet e të shkruarit, tregon qëllimin dhe lidhjen ndërmjet përmbajtjes së paragrafëve)

II. Kompetenca e të menduarit - Mendimtar kreativ (Në forma të ndryshme të të shprehurit prezanton mënyrën e grumbullimit, të zgjedhjes dhe të klasifikimit të informatave për fusha të ndryshme mësimore apo për një temë të caktuar, ofron argumente për zhvillimet aktuale lidhur me temën përkatëse p.sh., temë nga shkenca, nga kultura,
nga arti, nga sporti, nga shëndetësia, nga shoqëria, nga mjedisi etj.)

III. Kompetenca e të nxënit - Nxënës i suksesshëm (1. Demonstron shkathtësi funksionale në lexim-shkrim, në matematikë, në jetën e përditshme, në përmbushjen e kërkesave të ndryshme për kryerjen e një detyre apo aktiviteti dhe gjatë të nxënit të dijeve të reja në ndonjë fushë të caktuar mësimore. 2. Parashtron pyetje dhe shfaq mendime të strukturuara për zgjidhjen e një problemi apo detyre të caktuar)

## Objektivat
–Promovon vlerat e përgjithshme kulturore dhe qytetare

## Pikat e diskutimit
Çfarë kuptoni me motivacion?
Ku ndryshojnë motivet nga motivacioni?
Bëni klasifikimin e motiveve sipas nevojave.
Shpjegoni teoritë mbi motivimin.
Bazuar në historinë e djaloshit (motivin e tij për jetën) cila perspektivë motivuese do ta shpjegonte më lehtë këtë sjellje dhe pse?

## Aktivitetet
### Harta e konceptit
Mësimdhënësja u drejton pyetje nxënësve, për të marrë përgjigje rreth konceptit: Çfarë kuptoni me motivacion?

### Veprimtari me lexim të drejtuar (VLD)
Klasa ndahet në dy grupe. I orienton nxënësit të marrin informacion rreth çështjeve të mësimit. Grupi 1: Pikëpamjet biologjike dhe frojdiste për motivimin Grupi 2: Pikëpamjet kognitive dhe humaniste për motivimin Nxënësve u lihet kohë në dispozicion për të marrë informacionin e nevojshëm nga teksi mësimor. Ata nxiten që gjatë leximit të mendojnë dhe të parashikojnë rreth asaj që po lexojnë. Pasi nxënësit janë gati, ata i diskutojnë informacionet me mësimdhënësin/en. Njohuritë e nxënësve pasurohen me informacione të tjera nga mësimdhënësi/ja, që mban gjallë interesin e nxënësve deri në fund të temës mësimore.

### Hapi III: Shkrim i lirë
Si motivoheni ju në jetën tuaj?



Njësia mësimore

Zhvillimi njerëzor - Adoleshenca; Perspektiva mbi personalitetin;

Marrëdhëniet shoqërore - Ndikimi social

# Exit

**Regjia: Karen Winther**

Përgatitur nga
Jeta Rexha, SH. M. "Hajdar Dushi" Gjakovë

## Përshkrimi i filmit

Filmi dokumentar Exit trajton temën e ekstremizmit të dhunshëm si një nga format më të përhapura të shprehjes së dhunës dhe urrejtjes njerëzore. Brenda filmit rrëfehen histori të ndryshme të personazheve, të cilët kanë qenë pjesë e ekstremizmit të dhunshëm duke shfaqur anën e dobët të personalitetit, problemet me identitetin, refuzimin nga shoqëria si dhe traumat psikologjike nëpër të cilat po kalojnë.

Ekstremizmi i dhunshëm është problem global dhe ky fenomen ka përfshirë edhe Kosovën. Në përfshirjen e të rinjëve kosovarë në luftra të përgjakshme kanë ndikuar niveli i ulët i shkollimit të të rinjëve, rrymat e ndryshme ekstreme të pasluftës që kanë ardhur në Kosovë përmes organizatave të ndryshme, pakënaqësia shoqërore, mungesa e perspektivës, përdorimi i pakontrolluar i rrjeteve sociale etj. Ky film dokumentar tregon historitë e disa personazheve nga momenti kur kanë vendosur të jenë pjesë e lëvizjes deri në kohën kur kanë marr vendimin për t'u larguar nga lëvizja. Gjatë rrëfimit të historive të tyre personale të bie në sy mosha. Pothuajse të gjithë kishin marrë vendim që të bëheshin pjesë e lëvizjes nga mosha 15 vjeç, ku shkencërisht njihet si një nga moshat më delikate dhe me kriza të thella të konfuzionit të identitetit.

Në min. 1:21 Kur isha 16 vjeç u bashkova me lëvizjen e ekstremit të djathtë

Min. 11:47 Manueli ishte udhëheqësi i një grupi paramilitar neo-nazist. U rrit në Gjermaninë Lindore. Kur ishte 13 vjeç, ai u bashkua me një grup neo-nazist. DDR kishte pushuar se ekzistuari. Prindëritë e mi ishin të papunë. Dhe... Miqtë e mi të gjithë i'u bashkuan krahut të djathtë, dhe kështu bëra unë.

Min. 16:00 u bashkova me lëvizjen radikale të krahut të majtë. Shkova në një protestë antifashiste në Lund, në Suedi.

Min. 25:00 Historia e Angelas dhe periudha dhejtë vjeçare e jetës së saj si një ekstremiste.

Min. 51:41 Davidi ishtë anëtar i grupit islamik të armatosur, dhe besonte plotësisht në xhihad. Davidi u rrit me nënën e tij katolike në periferi jashtë Lyonit. Kur ishte 15 vjeç, ai u largua nga shkolla për t'u konvertuar në Islam.

## Fushat e kurrikulës
Shoqëria dhe Mjedisi

## Përshtatshëm për
Shkallën: 5, 6. Klasa XI, XII

## Kompetencat
Kompetenca e komunikimit dhe të të shprehurit - Komunikues efektiv;
Kompetenca e të menduarit - Mendimtar kreativ;
Kompetenca e të nxënit - Nxënës i suksesshëm.

## Objektivat
Sipas Kurrikulës së Kosovës objektivat që synohen të arrihen përmes këtij filmi dokumentar janë:
-Duke zhvilluar përgjegjësitë ndaj vetes, ndaj të tjerëve, ndaj shoqërisë dhe ndaj mjedisit,
-Kultivuar identitetin personal, kombëtar, të përkatësisë shtetërore e kulturore.

## Pikat e diskutimit

Çfarë ndjesish përjetuat pasi shikuat filmin?
Çka dmth të jesh adoleshentë?
Pse rrezikojnë të rekrutohen të rinjtë kryesisht adoleshentët?
Cilat shoqëri mund të ndikojnë më tepër në krizën e identitetit në adoleshencë?
Si mund të ndikojë personaliteti autoritar i prindërve në fëmijëri?
Çfarë ndikimi kanë faktorët mjedisor në ekspozimin e adoleshentëve ndaj faktorëve të rrezikut?
Çfarë roli kanë moshatarët në adoleshencë?
Si mund të ndikojë ekspozimi i madh ndaj teknologjisë në veçanti mediat sociale në adoleshencë?

## Aktivitetet

### Hapi I: Stuhi mendimesh
Nxënësit nxiten në një diskutim oër pyetjen: Çfarë përfaqëson adoleshenca?

### Hapi II: Ditari trepjesësh
Nxënësve u kërkohet që të lexojnë temën mësimore: Adoleshenca? Ata udhëzohen të nënvizojnë pjesë që u bëjnë përshtypje dhe që për to janë informacion i ri, pjesët që i bëjnë përshtypje për të cilat duan të thonë diçka apo që kanë pyetje. Në kolonën e parë shënohen pjesët që nxënësit kanë shkëputur nga teksti. Në kolonën e dytë shënohen komentet apo shënimet që nxënësit kanë. Kolona e tretë i lihet mësuesit për të bërë komentet. - 1. Çfarë është adoleshenca? - 2. Cilat janë karakteristikat e kësaj moshe? - 3. Cili është roli i familjes dhe i moshatarëve në adoleshencë?

### Hapi III: Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura
Nxënësit reflektojnë në mënyrë kritke: A mendoni se adoleshenca dhe karakteristikat e saj njihen nga të gjithë? Mësuesja nxit diskutimin midis rolit të familjes dhe moshatarëve gjatë moshës së adoleshencës.



Njësia mësimore

Perspektivat mbi sjelljen jonormale.

Perspektiva për trajtimin e çrregullimeve psikologjike .

# Fjalët e heshtura

**Regjia: Leart Rama, Adis Cena**

Përgatitur nga
Jeta Rexha, SH. M. "Hajdar Dushi" Gjakovë

## Përshkrimi i filmit

Filmi dokumentar "Fjalë të heshtura" përshkruan jetën e personave me sëmundje mendore në Spitalin Psikiatrik në Shtime. Këta persona flasin me anë të sjelljeve të tyre, ku sjellja është një faktor kryesorë të cilën e studion psikologjia.

Këta pacientë, shpalosin botën e tyrë që është ndryshe nga realiteti, të cilën botë shumë pak njerëz ua kuptojnë, si dhe në të njëjtën kohë tregojnë pabarazinë që bëjnë institucionet, familjarët dhe në përgjithësi shoqëria ndaj këtyre individëve.

Në këtë film do të keni mundësinë t'i shikoni pamjet që nuk keni pasur dhe ndoshta nuk do të keni mundësinë për t'i parë, paragjykimet e gabuara, dhe shumë fjalë nga pacientët, por megjithatë mbretëron një qetësi e madhe.

## Fushat e kurrikulës
Shoqëria dhe Mjedisi

## Përshtatshëm për
Shkallën; 5, 6. Klasa: XI

## Kompetencat
I. Kompetenca e komunikimit dhe të të shprehurit - Komunikues efektiv (Shpreh mendimin e lirë, opinionin dhe qëndrimin për një temë të caktuar nga jeta, shkenca, shoqëria, duke përdorur forma të ndryshme të komunikimit me gojë, me shkrim, etj.)
II. Kompetenca e të menduarit - Mendimtar kreativ (Në forma të ndryshme prezanton mënyrën e grumbullimit, të zgjedhjës dhe të klasifikimit të informatave për një temë të caktuar, ofron argumente për zhvilimin aktual lidhur me temën përkatëse)

III. Kompeteca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm (Demonstron veprime të ndryshme që shprehin tolerancë, respekt dhe qëndrim të hapur ndaj dallimeve në komunitetin ku jeton (në klasë, në shkollë, në lagje dhe më gjerë) dhe i shpjegon ato në një debat me të tjerët)

## Objektivat
-Përgjegjësia ndaj vetës si dhe shoqërisë

## Pikat e diskutimit

Çfarë kuptoni me sjellje jonormale?
Përshkruani procedurën e diagnostifikimit të një sjellje jonormale.
Tregoni dallimet mes psikologut dhe psikiatrit.
Bazuar në film, çka kishit ndryshuar tek pacientët në Spitalin Psikiatrik në Shtime, por edhe në përgjithësi për këtë grup shoqëror?

## Aktivitetet

### Harta e konceptit
Për të bërë lidhjen me temën e re, mësimdhënësi kërkon nga nxënësit të thonë çfarë dinë rreth termit sjellje njerëzore.

### Veprimtari me lexim të drejtuar (VLD) dhe shikimi i filmit
Fillimisht nxënësve ju lëshohet filmi dhe pastaj klasa ndahet në dy grupe. Mësimdhënësi i orienton nxënësit të marrin informacion rreth këtyre çështjeve të mësimit. Grupi 1: Diagnostifikimi i sjelljes jonormale Grupi 2: Diagnostifikimi dhe trajtimet Psiko-terapeutike Nxënësve u lihet kohë në dispozicion për të marrë informacionin e nevojshëm nga teksti mësimor. Pasi ata e shikojnë edhe filmin besojë që janë të motivuar të mendojnë dhe të parashikojnë rreth asaj që po lexojnë. Kur nxënësit janë gati, ata i diskutojnë informacionet me mësimdhënësin/en. Njohuritë e nxënësve plotësohen me informacione të tjera nga mësimdhënësi/ja.

### Shkrim i lirë
Duke u bazuar në njohuritë që përfituat nga libri, çka mendoni? cilat terapi duhet përdorur tek pacientët në spitalet psikiatrike?



Njësia mësimore

Sjelljet dhe qëndrimet që nxisin shëndetin.

# Giulia

**Regjia: Rigers Shimaj**

Përgatitur nga
Jeta Rexha, SH. M. "Hajdar Dushi" Gjakovë

## Përshkrimi i filmit

Filmi dokumentar "Giulia" flet për një vajzë 18 vjeç e cila jeton në Tiranë. Pasioni i saj është biçikleta. Downhill është një sport ku ajo e gjen vetën, natyra është ajo që e bënë këtë sport akoma dhe më të bukur. Ajo përjeton ndjenja fantastike teksa ecën me biçikletë mes pemëve dhe zbulon shtigje të ndryshme. Ajo përjeton adrenalinën në maksimum dhe teksa vozitë biçikletën nuk mendon asgjë tjetër përveç shtegut që ndjek dhe zhurmat e gjetheve të tokës apo frenave të biçikletës.

Downhill-in si sport e kam filluar në 2015 thotë Gulia, bashkë me dy shokë tjerë, duke zbuluar kodra të ndryshme. Mirëpo sfidat që kishte me biçikletën e detyruan atë që të punonte punë të përkohshme në call center për të mbledhur disa para dhe për të blerë një biçikletë. Nuk e kishte mbështetjen as të familjes për pasionin e saj. Mirëpo pavarësisht kësaj, Giulia filloi të merrte pjesë në gara të ndryshme dhe të triumfojë duke marrë medalje.

## Fushat e kurrikulës
Shoqëria dhe Mjedisi.

## Përshtatshëm për
Shkallën 5. Klasa: XI.

## Kompetencat
I. Kompetenca e komunikimit dhe të të shprehurit - Komunikues efektiv (1. Shprehet përmes një forme të komunikimit, për një temë të caktuar në një material (prezantim) prej 200 fjalësh dhe veçon çështjet kryesore të ngritura në material (prezantim); 2. Diskuton në grup në mënyrë konstruktive, një diskutim në gjuhë amtare, apo në gjuhë angleze, në kohëzgjatje jo më shumë se 10 minuta, duke dhënë dhe duke marrë informata kthyese për një temë të caktuar nga ndonjë fushë mësimore formale dhe joformale etj.).

II. Kompetenca e të menduarit - Mendimtar kreativ (1. Në forma të ndryshme të të shprehurit prezanton mënyrën e grumbullimit, të zgjedhjes dhe të klasifikimit të informatave për fusha të ndryshme mësimore apo për një temë të caktuar, ofron argumente për zhvillimet aktuale lidhur me temën përkatëse, p.sh., temë nga shkenca, nga kultura, nga arti, nga sporti, nga shëndetësia, nga shoqëria, nga mjedisi etj.).

III. Kompetenca e të nxënit - Nxënës i suksesshëm (Demonstron shkathtësi funksionale në lexim-shkrim, në matematikë, në jetën e përditshme, në përmbushjen e kërkesave të ndryshme për kryerjen e një detyre apo aktiviteti dhe gjatë të nxënit të dijeve të reja në ndonjë fushë të caktuar mësimore).

## Objektivat
Sipas Kurrikulës së Kosovës objektivat që synohen të arrihen përmes këtij filmi dokumentar janë: Promovimi i vlerave të përgjithshme kulturore dhe qytetare, Zhvillimi i përgjegjësisë ndaj vetes, ndaj të tjerëve, ndaj shoqërisë dhe ndaj mjedisit.

## Pikat e diskutimit

Çfarë është psikologjia e shëndetit?
Cilat janë sjelljet që promovojnë shëndetin?
Ç'rëndësi kanë sjelljet e shëndetshme?
Ç'rëndësi kanë sjelljet e shëndetshme?
Çfarë sjellje të shëndetshme praktikoni ju?

## Aktivitetet

### Stuhi mendimesh
Çka kuptoni me psikologji të shëndetit?

### Veprimtari me lexim të drejtuar (VLD)
Mësimdhënësi/ja ndan nxënësit në dy grupe. I orienton nxënësit të marrin informacion rreth çështjeve të mësimit. Grupi I: Studion sjelljet e shëndetshme Grupi II: Studion promovimin e sjelljeve të shëndetshme

### Shkrim i lirë
Nxënësit japin mendimin e tyre rreth temës: Rëndësia e shëndetit në jetën tonë.



Njësia mësimore

Paragjykimet, stereotipet, diskriminimi. Qëndrimet.

# I fshehur mes jush

**Regjia: Arbër Topalli**

Përgatitur nga
Jeta Rexha, SH. M. "Hajdar Dushi" Gjakovë

## Përshkrimi i filmit

Filmi dokumentar "I fshehur mes jush (Hidden among you)" flet për një adoleshent 19 vjeç nga Ferizaji i cili ka lindur në një familje të zakonshme shqiptare. Është fëmija i parë në familje pas disa vite martesë të prindërve të tij. Në kohën kur ka lindur, tensionet mes Kosovës dhe Serbisë kanë qenë shumë të mëdha.

"Kur kam qenë në klasë të shtatë, filloi me më pëlqy një djalë. Unë isha në korin e shkollës, dhe ai poashtu. Ai nuk ishte në dijeni që unë e pëlqeja. Në këtë kohë unë fillova të dyshoj te vetja që jam homoseksual, por në asnjë mënyrë unë nuk e kisha guximin me e pranu që jam i tillë. Natën e vitit të ri 2011-2012 e kuptova që jam homoseksual. Në atë kohë isha 13 vjeç dhe e dija që për shumëkënd kjo është diçka neveritëse."

Teksa tregon për ngjarje të ndryshme që kanë ndodhur në jetën e tij, ai flet për ndjenjat e tij të përziera dhe konfuzionin që e ka shoqëru. "Këto kanë qenë momentet më të vështira që i kam përjetu ndonjëherë. Ka pas raste edhe kur e kam mendu vetëvrasjen si alternativë rrëfen personazhi i filmit."

## Fushat e kurrikulës
Shoqëria dhe mjedisi.

## Përshtatshëm për
Shkalla 5, 6. Klasa: XI, XII.

## Kompetencat
I. Kompetenca e komunikimit dhe të të shprehurit - Komunikues efektiv (1. Shprehet përmes një forme të komunikimit, për një temë të caktuar në një material (prezantim) prej 200 fjalësh dhe veçon çështjet kryesore të ngritura në material (prezantim); 2. Diskuton në grup në mënyrë konstruktive, një diskutim në gjuhë amtare, apo në gjuhë angleze, në kohëzgjatje jo më shumë se 10 minuta, duke dhënë dhe duke marrë informata kthyese për një temë të caktuar nga ndonjë fushë mësimore formale dhe joformale etj.).

II. Kompetenca e të menduarit - Mendimtar kreativ (1. Në forma të ndryshme të të shprehurit prezanton mënyrën e grumbullimit, të zgjedhjes dhe të klasifikimit të informatave për fusha të ndryshme mësimore apo për një temë të caktuar, ofron argumente për zhvillimet aktuale lidhur me temën përkatëse, p.sh., temë nga shkenca, nga kultura, nga arti, nga sporti, nga shëndetësia, nga shoqëria, nga mjedisi etj.).

III. Kompetenca e të nxënit - Nxënës i suksesshëm (Demonstron shkathtësi funksionale në lexim-shkrim, në matematikë, në jetën e përditshme, në përmbushjen e kërkesave të ndryshme për kryerjen e një detyre apo aktiviteti dhe gjatë të nxënit të dijeve të reja në ndonjë fushë të caktuar mësimore).

## Objektivat
Sipas Kurrikulës së Kosovës objektivat që synohen të arrihen përmes këtij filmi dokumentar janë: Promovimi i vlerave të përgjithshme kulturore dhe qytetare, Kultivimi i identitetit personal, kombëtar, të përkatësisë shtetërore e kulturore.

## Pikat e diskutimit
Çfarë kuptoni me paragjykim, stereotipizim dhe diskriminim?
Si formohen paragjykimet?
Çfarë pasoja sjell diskriminimi?
Çfarë janë qëndrimet?
Cilët janë komponentët kryesorë të qëndrimeve?
Si i formojmë qëndrimet për të tjerët?

## Aktivitetet
### Kllaster
Paragjykimi - Diskriminimi - Qëndrimet

### Veprimtari me lexim të drejtuar (VLD)
Shtrohet për diskutim situata: Meli po ecte në rrugë, kur pa dy meshkuj të kapur për dore. Ajo u vrenjt në fytyrë dhe tundi kokën. Mësimdhënësi/ja nxit mendimin e nxënësve nëpërmjet pyetjeve të mëposhtme: 1. A e keni pyetur ndonjëherë veten pse mendojmë dhe sillemi kështu? 2. Nga na vijnë këto mendime dhe qëndrime? Argumentoni mendimin tuaj? Më pas mësimdhënësi/ja e ndan klasën në dy grupe. Grupi I: Studion paragjykimet dhe sterotipet Grupi II: Studion qëndrimet Nxënësve u lihet kohë në dispozicion për të marrë informacionin e nevojshëm nga teksti mësimor.

### Diskutim i lirë
Çfarë qëndrimi keni ndaj homoseksualëve? A do të donit t'i ndryshonit qëndrimet ndaj tyre? Si mund të veprosh për të ndryshuar qëndrimet?



Filmi dokumentar si një instrument për përmirësimin e procesit të mësimdhënies, si dhe zhvillimin e të menduarit kritik tek nxënësit trajton tema të ndryshme që evokojnë fenomene të ndryshme sociale.

# I kujt është flamuri?


Përgatitur nga
Driton Mallaku, SH. M. "Gjon Buzuku" Prizren
Fatlume Hyseni, SH. M. "Xhavit Ahmeti" Gjilan
Jeta Rexha, SH. M. "Hajdar Dushi" Gjakovë
Merita Shala, SH. M. "Ahmet Gashi" Prishtinë


**Regjia: Baris Karamuço**

## Përshkrimi i filmit

Dihet se me gjenerata të tëra kanë jap jetën për flamurin kombëtar Kuq e Zi, nuk ka kuptim ta kemi këtë flamur, kur as me referendum, as me votë nuk e kemi pas të drejtën me zgjedhë". Filmi dokumetar "I kujt është flamuri" trajton temën e simbolit të flamurit të shtetit të ri të Kosovës dhe identitetin kosovar.

Gjithashtu në këtë film bëhet gërshetimi i flamurit Kuq e Zi dhe flamurit të Kosovës që njihet si flamur me gjashtë yje, e që ngareh linja paralele në mes të këtyre dy identiteve të përkatësisë kombëtare dhe identitetit.

Gëzuar ditëlindjen Kosovë!

## Fushat e kurrikulës
Gjuhët dhe Komunikimi, Shoqëria dhe Mjedisi

## Përshtatshëm për
Shkallën kurrikulare 5 dhe 6, klasa XI - XII.

## Kompetencat
I. Kompetenca e të mësuarit,

II. Kompetenca qytetare,

III. Kompetenca personale,

IV. Kompetencat e komunikimit dhe të shprehurit.

## Objektivat
Kultivimi i identitetit personal, kombëtar, përkatësia etnike. Promovimi i vlerave të përgjithshme kulturore dhe qytetare. Zhvillimi i përgjegjësinë ndaj vetes, ndaj të tjerëve, ndaj shoqërisë dhe ndaj mjedisit.

## Pikat e diskutimit

Identitet kombëtar, etniciteti, dilemat.
Cili flamur e përfaqëson identitetin e qytetarëve të Kosovës?
Përceptimet e qytetarëve lidhur me simbolet e Republikës së Kosovës.
Pranimi ose mohimi i simboleve, konkretisht flamurit të Kosovës nga gjeneratat e reja dhe të vjetra.
Përceptimi i simbolit të flamurit të Kosovës nga komunitetet tjera që jetojnë në Kosovë.
Dashuria për simbolet e shtetit të Kosovës, respekti, krenaria.
Lidhja emocionale me flamurin e Kosovës dhe flamurin Kuq e Zi: si një kujtim dhe marrëdhënie me kombin shqipëtar të cilit i përkasin.
Si kanë ndikuar rrethanat shoqërore në përceptimin dhe pranimin e indentitetit të kosovarëve?
Pjesa përbërëse e historisë në raport me flamurin Kuq e Zi dhe flamurin e Kosovës.
Ndikimi i institucioneve e sidomos ato arsimore në arsimimin e gjeneratave dhe ngritjene vetëdijës për simbolet shtetërore.
Sa i përfaqëson kosovarët flamuri dhe sa e paraqet thelbin e shtetit?
Tekstet shkollore në paraqitjen e historisë së Kosovës deri te shpallja e Pavarësisë dhe krijimit të simboleve shtetërore.

## Aktivitetet

### Evokim –Stuhi mendimesh
Ora e mësimit fillon diskutimin lidhur me dy çështje kryesore për debat: Me cilin flamur identifikoheni dhe cila është përkatsia e juaj etnike? Flamuri kuq e zi apo flamuri i Kosovës me yje? Kosovar apo Shqipëtar? Cila është lidhja emocionale që keni në raport me këta flamuj? Dashuri, respekt, krenari, kujtim, mohim, apati.

### Realizimi – Ditari dy pjesësh
Nxënësit zgjedhin nga një paragrafë nga teksi apo shkëpusin pjesë nga filmi dokumentar, për të komentuar arsyen e zgjedhjes. Më pas i tregohet nxënësve që fleta të ndahet në mes me një vijë vertikale kurse në anën e majtë shkruhen citatet nga teksti, kurse në të djathtë komentet.

### Reflektim - Diskutim në çift dhe grup
Nxënësit ndahen në dy grupe (Pro dhe Kundër) dhe diskutohet çështja e pranimit apo mohimit të flamurit të Kosovës dhe identitetit Kosovar.



Njësia mësimore

Stresi dhe përballimi i tij

# Jetë brenda ekranit

**Regjia: Art Sylaj**

## Përshkrimi i filmit

Përgatitur nga

Sabina Halili, SH. M. "Gjon Buzuku" Prizren

Filmi dokumentar "Jetë brenda ekranit" përshkruan ndikimin negative të rrjetëve sociale, posaçërisht tek shkollat e mesme te ulta prej klasë 6 deri 9, ku në këtë moshë ende nuk kanë perceptime të qëndrueshme dhe kontrollë të plotë për veprimet e tyre.

Mungesa e komunikimit dhe bashkëpunimit prind–fëmijë që kemi, si dhe një përdorim i pa kontrolluar i rrjeteve sociale sjellë pasoja të përjetimit të dhunës psikologjike.

Fotografitë e postuara ju përdoren si mjete kërcenuese për t'i shfrytëzuar seksualisht, apo për qëllime tjera përfituese.

Mediat sociale në këtë kohë të teknologjisë për-pos përparësive, sjellin ngacmime të formave të ndryshme që ju ndodhin të rinjëve.

Për trajtimin e kësaj dukurie duhët të përdorën mekanizma të posaçëm instistucional, duke vetëdi-jësuar të rinjtë dhe prindërit për pasojat e këtyre ngacmimeve mediatike në shëndetin mendor siç janë ankthi, depresioni, stresi etj.

## Fushat e kurrikulës
Shoqëria dhe Mjedisi

## Përshtatshëm për
Shkallën; 5, 6. Klasa: XI

## Kompetencat
I Kompetenca e komunikimit dhe të të shprehurit - Komunikues efektiv (Shpreh mendimin e lirë, opinionin dhe qëndrimin për një temë të caktuar nga jeta, shkenca, shoqëria, duke përdorur forma të ndryshme të komunikimit me gojë me shkrim etj.)

II Kompetenca e të menduarit - Mendimtar kreativ (Në forma të ndryshem prezanton mënyrën e grumbullimit, të zgjedhjës dhe të klasifikimit të informatave për një temë të caktuar, ofron argumente për zhvilimin aktual lidhur me temën përkatëse.)

III Kompetenca e të nxënit – Nxënës i sukseshëm (Në mënyrë efektive shfrytzon përvojat paraprake gjatë zgjidhjes së situatave të ndryshme në jetën e përditshme apo gjatë kryerjës së një detyre, ndan përvojat me të tjerët për mënyrat më praktike të shfrytëzimit të përvojave pararake në arritjen e dijeve të reja)

IV. Kompetenca qytetare – Qytetar i përgjegjshëm (Shpjegon të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e individit në raste të ndryshme, si: në shtëpi, në klasë, në shkollë, në shoqëri, dallon rastët kur hyjnë në konflikt me njëri-tjetrin dhe paraqet alternativa të zgjidhjës së tyre.)

## Objektivat
-Përgjegjësia ndaj vetës si dhe shoqërisë,
-Evitimi i paragjykimeve ndaj të tjerëve,
-Aftësim për mësim gjatë gjithë jetës,
-Krijimi i identitetit personal.

## Pikat e diskutimit

Çfarë kuptoni me stres?
Cilët janë burimet e stresit?
Përmendni disa grupe stresorësh?
Bazuar në këtë dokumentar, cilët janë mekanizmat që kishit me i përdor për të parandaluar ngacmimet përmes mediave sociale?

## Aktivitetet

### Hapi I: Harta e konceptit
Mësimdhënësja fillimisht shënon konceptët kryesore në tabele dhe ju drejton pyetje nxënësve, për të marrë përgjigje rreth këtij koncepti: Cilët janë faktorët që shkaktojnë më shumë stres tek të rinjët?

### Hapi II: Veprimtari me lexim të drejtuar (VLD) dhe shikimi i filmit
Fillimisht nxënësve ju lëshohet filmi dhe pastaj klasa ndahet në dy grupe. Mësimdhënësi i orienton nxënësit të marrin informacion rreth këtyre çështjeve të mësimit. Grupi 1: Stresi dhe burimet e tij. Grupi 2: Reagimet ndaj stresit. Nxënësve u lihet kohë në dispozicion për të marrë informacionin e nevojshëm nga teksti mësimor. Pasi ata e shikojnë edhe filmin besojë që janë të motivuar të mendojnë dhe të parashikojnë rreth asaj që po lexojnë. Kur nxënësit janë gati, ata i diskutojnë informacionet me mësimdhënësin/en. Njohuritë e nxënësve plotësohen me informacione të tjera nga mësimdhënësi/ja.

### Hapi III: Shkrim i lirë
Bazuar në këtë dokumentar dhe në përvojat personale, cilët janë mekanizmat që do t'i përdornit për të parandaluar ngacmimet përmes mediave sociale?



Njësia mësimore

Agresiviteti

# Ka një mot

**Regjia: Donjetë Berisha**

Përgatitur nga

Jeta Rexha, SH. M. "Hajdar Dushi" Gjakovë

## Përshkrimi i filmit

Filmi dokumentar "Ka një mot" flet për gratë që kanë përjetuar dhunë të papërshkrueshme fizike, emocionale dhe seksuale. Autorja e filmit ka realizuar një intervistë anonime në një nga qendrat për mbrojtjen e grave dhe fëmijëve në Kosovë. Gruaja e intervistuar flet për jetën e saj në fëmijëri. Ajo thotë të ketë pasur një fëmijëri të lumtur. Gjithashtu ajo rrëfen edhe historinë e takimit për herë të parë me burrin e saj. Thotë të jetë takuar në Prishtinë. Pesë vitet e para të martesës thotë që ka kaluar mirë. Pastaj kanë filluar konfliktet dhe mosmarrëveshjet.

Ajo nuk e pati as përkrahjen e familjes, kur mori vendim për t'u ndarë nga bashkëshorti agresiv. Nëna i saj i thotë se "duhesh me duru", mirëpo ajo e pati të vështirë të duronte dhunën e burrit. Tregon për xhelozinë e burrit ndaj saj dhe tendencën e tij për t'ia kontrolluar jetën gruas. Gruaja rrëfën tmerrin e përjetuar nga bashkëshotri i saj. Ajo tregon ngjarje të ndryshme që kanë ndodhur gjatë kohës sa ka jetuar me të. Tregon që ka tentuar edhe vetëvrasjen.

## Fushat e kurrikulës
Shoqëria dhe Mjedisi

## Përshtatshëm për
Shkallën; 5, 6. Klasa: XI, XII.

## Kompetencat
I. Kompetenca e komunikimit dhe të të shprehurit - Komunikues efektiv (1. Shprehet përmes një forme të komunikimit, për një temë të caktuar në një material (prezantim) prej 200 fjalësh dhe veçon çështjet kryesore të ngritura në material (prezantim); 2. Diskuton në grup në mënyrë konstruktive, një diskutim në gjuhë amtare, apo në gjuhë angleze, në kohëzgjatje jo më shumë se 10 minuta, duke dhënë dhe duke marrë informata kthyese për një temë të caktuar nga ndonjë fushë mësimore formale dhe joformale etj.).

II. Kompetenca e të menduarit - Mendimtar kreativ (1. Në forma të ndryshme të të shprehurit prezanton mënyrën e grumbullimit, të zgjedhjes dhe të klasifikimit të informatave për fusha të ndryshme mësimore apo për një temë të caktuar, ofron argumente për zhvillimet aktuale lidhur me temën përkatëse, p.sh., temë nga shkenca, nga kultura, nga arti, nga sporti, nga shëndetësia, nga shoqëria, nga mjedisi etj.).

III. Kompetenca e të nxënit - Nxënës i suksesshëm (Demonstron shkathtësi funksionale në lexim-shkrim, në matematikë, në jetën e përditshme, në përmbushjen e kërkesave të ndryshme për kryerjen e një detyre apo aktiviteti dhe gjatë të nxënit të dijeve të reja në ndonjë fushë të caktuar mësimore).

## Objektivat
Sipas Kurrikulës së Kosovës objektivat që synohen të arrihen përmes këtij filmi dokumentar janë: Zhvilluar përgjegjësitë ndaj vetes, ndaj të tjerëve, ndaj shoqërisë dhe ndaj mjedisit.

## Pikat e diskutimit

Çfarë kuptoni me agresivitet?
Çfarë i shtynë njerëzit të jenë agresivë?
Çfarë pasojash sjell tek tjetri agresiviteti jonë?
Si mund ta paksojmë dhe kontrollojmë agresivitetin?

## Aktivitetet

### Stuhi mendimesh
Çfarë kuptoni me termin agresivitet?

### Diagrami piramidal
Klasa ndahet në dy grupe, Grupi I: Diskuton sjelljen agresive, Grupi II: Diskuton mbi kontrollin e agresivitetit.

### Tryeza e rrumbullakët
Grupi I: Sjellin argumente për shkaqet e agresivitetit, Grupi II: Sjellin argumente për pasojat e agresivitetit.



Njësia mësimore

Identiteti gjinor / Gjinitë

# KosovaTrans

**Regjia: Albrim Isufi**

Përgatitur nga
Arbnesha Kusari, SH. M. "Hajdar Dushi" Gjakovë
Fatlume Hyseni, SH. M. "Zenel Hajdini" Gjilan
Feride Thaçi, SH. M. "Ulpiana" Lipjan
Jehona Luma, SH. M. "Ulpiana" Lipjan
Kujtesa Salihu - Keka, SH. M. "Xhavit Ahmeti" Gjilan
Sabina Dishallari, SH. M. "Gjon Buzuku" Prizren

## Përshkrimi i filmit

Ky film dokumentar ka në objektiv çështjen e një adoleshenti transgjinor në Kosovë. Në film është rrëfimi në vetën e parë i një adoleshenti që nga momenti kur vëren shenjat e para që i pëlqejnë gjërat jokonvencionale e deri tek paragjykimet nga shoqëria dhe rrethi. Qysh nga fëmijëria, ky personazh nuk është ndjerë kurrë rehat me të qenurit i gjinisë mashkullore.

Gjithmonë e kanë tërhequr lodrat dhe gjësendet femërore, por duke qenë se është kritikuar nga prindërit e tij si dhe vet është ndjerë konfuz, ka filluar të besoj që është duke bërë gjëra të gabuara dhe të papranueshme për shoqërinë. Me kalimin e viteve, gjendja psikike dhe emocionale e tij është përkeqësuar sidomos në periudhen e pubertetit, kur djaloshi bie në depresion dhe përjeton krizë të identitetit gjinor.

Filmi trajton një temë që është shumë pak e përmendur e lëre më e trajtuar në shoqërinë tonë, kjo edhe paraqitet qartë në film. Së pari, identifikimi personal, vështirësitë në zbulimin e identitetit, pranimi gradual i tij pavarësisht rrethanave dhe ndikimi i faktorëve siç janë familja, shoqëria e mbi të gjtha stereotipet e krijuara për vajza dhe për djem. Protagonisti rrëfen momentin se si është ndjerë kur ka vendosur për herë të parë buzëkuq, një produkt i prodhuar enkas për gra.

Rrëfimi vazhdon me përshkrimin e momenteve kur për herë të parë motra e tij kupton gjendjen e personazhit. Paraqet reagimin e saj fillestar dhe në fund pranimin e të vëllaut si transgjinor, e cila vjenë gradualisht si pasojë e informimit më të madh të saj për këtë realitet. Filmi përfundon me protagonistin i cili kthehet jetës normale duke pranuar realitetin për identitetin e tij/saj.

## Fushat e kurrikulës
Gjuhët dhe komunikimi

## Përshtatshëm për
Shkallën kurrikulare 5, klasa X dhe XI.

## Kompetencat
I. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit (komunikon dhe gjykon në mënyrë të shëndoshë);
II. Kompeteca qytetare (promovimi i vlerave demokratike dhe qytetare);
III. Kompetenca personale (zhvillimi i identitetit personal, njohja dhe respektimi i diversitetit);
IV. Kompetenca e të menduarit (zhvillimi i të menduarit kritik, pasurimi me njohuri të reja);

## Objektivat
-Zhvillimi i përgjegjësisë ndaj vetvetës, ndaj të tjerëve (shoqërisë dhe mjedisit);
-Kultivimi i identitetit personal dhe kombëtar.

## Pikat e diskutimit

Si ndikojnë faktorët social dhe kulturor te koncepti për veten, qëndrimet, paragjykimet, stereotipet?
Krijimi i identitetit gjinor.
Lidhja social-emocionale me personat që na rrethojnë.

## Aktivitetet

### Evokim – Stuhi mendimesh
1. Çfarë njohuri kanë nxënësit rreth identitetit personal dhe identitetit gjinor (kl. XII)? 2. Çfarë kuptoni me pargjykim, stereotipizim dhe diskriminim (kl. XI)?

### Realizimi – Kuptimi
Shikimi i filmit, ditari dy pjesësh, gjatë dhe pas shikimit të filmit nxënësve u kërkohet të mbajnë shenime në formë "citati" dhe komenti".

### Reflektimi
Diskutim në çifte.



Njësia mësimore

Agresiviteti dhe sjellja ndihmuese

# Matrix

**Rexhia: Martin Xhoxhi**

Përgatitur nga
Sabina Halili, SH. M. "Gjon Buzuku" Prizren

## Përshkrimi i filmit

Filmi dokumentar "MATRIX" përshkruan varësinë e të rinjëve ndaj video lojërave nëpër lokale të qytetit. Aty shohim sjellje anti-sociale, gjuhë të papërshtatshme komunikuese, fyerje, sharje etj.

Kjo varësi ndaj video-lojërave çon edhe në rritje të agresivitetit, kur individi nuk arrin ta përfundojë me sukses lojën përkatëse.

Pra, me zhvillimin e teknologjisë është paraqitur edhe varësia ndaj saj.

## Fushat e kurrikulës
Shoqëria dhe Mjedisi

## Përshtatshëm për
Shkallën; 5, 6. Klasa: XI

## Kompetencat
I. Kompetenca e komunikimit dhe të të shprehurit - Komunikues efektiv (Shpreh mendimin e lirë, opinionin dhe qëndrimin për një temë të caktuar nga jeta, shkenca, shoqëria, duke përdorur forma të ndryshme të komunikimit me gojë me shkrim etj.)

II. Kompetenca e të menduarit - Mendimtar kreativ (Në forma të ndryshem prezanton mënyrën e grumbullimit, të zgjedhjes dhe të klasifikimit të informatave për një temë të caktuar, ofron argumente për zhvilimin aktual lidhur me temën përkatëse.)

III. Kompetenca e të nxënit – Nxënës i sukseshëm (Në mënyrë efektive shfrytëzon përvojat paraprake gjatë zgjidhjes së situatave të ndryshme në jetën e përditshme apo gjatë kryerjës së një detyre, ndan përvojat me të tjerët për mënyrat më praktike të shfrytzimit të përvojave pararake në arritjen e dijeve të reja.)

IV. Kompetenca qytetare – Qytetar i përgjegjshëm (Shpjegon të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e individit në raste të ndryshme, si: në shtëpi, në klasë, në shkollë, në shoqëri, dallon rastët kur hyjnë në konflikt me njëritjetrin dhe paraqet alternativa të zgjidhjës së tyre.)

## Objektivat
Aftësim për mësim gjatë gjithë jetës;
Përgjegjësia ndaj vetës si dhe shoqërisë;
Krijimi i identitetit personal.

## Pikat e diskutimit

Çfarë kuptoni me agresivitet?
Si mund të kontrollohet agresiviteti?
Shpjegoni altruizmin si sjellje ndihmuese?
Cilat janë efektët e video-lojërave në sferën mendore emocionale dhe sociale tek individi?

## Aktivitetet

### Hapi I: Harta e konceptit
Mësimdhënësja fillimisht shënon konceptët kryesore në tabele dhe ju drejton pyetje nxënësve, për të marrë përgjigje rreth këtij koncepti: Çfarë kuptoni me agresivitet?

### Hapi II: Veprimtari me lexim të drejtuar (VLD) dhe shikimi i filmit
Klasa ndahet në dy grupe. Mësimdhënësi i orienton nxënësit të marrin informacion rreth çështjeve të mësimit. Grupi 1: Agresiviteti; Grupi 2: Sjellja ndihmuese. Fillimisht nxënësit e lexojnë njësinë mësimore dhe më pastaj ju lëshohet filmi. Nxënësve u lihet kohë në dispozicion për të marrë informacionin e nevojshëm nga teksti mësimor dhe shikimi i filmit i nxit nxënësit ta diskutojnë këtë temë. Pasi nxënësit janë gati, ata i diskutojnë informacionet me mësimdhënësin/en. Njohuritë e nxënësve plotësohen me informacione të tjera nga mësimdhënësi/ja.

### Hapi III: Shkrim i lirë
Mendoni për sjelljen tuaj gjatë javës së kaluar, a e keni ndihmuar dikë? Mbani shënime sa herë më të vërtet keni ndihmuar, qoftë edhe me gjëra më të vogla dhe a ju bën të ndiheni mirë



Njësia mësimore

Përshtypja e parë dhe skemat. Stereotipat.

# Nuk jam vetëm...

**Regjia: Sonja Azizaj**

## Përshkrimi i filmit

Përgatitur nga
Jeta Rexha, SH. M. "Hajdar Dushi" Gjakovë

Filmi dokumentar "Nuk jam vetëm" flet për një grua moderne. Aleksandra, e cila jeton në një shoqëri urbane shqiptare të shek. XXI, duke veshur dhe pasqyruar tërë kompleksitetin e saj. Si është të jesh femër në ditët e sotme?

Aleksandra rrëfen jetën e të qenurit femër, i pëlqen që është femër, nuk do të donte të ishte mashkull. Si femër që është ajo tregon për tiparet e veta si ndjeshmëria, butësia, shprehëse e ndjenjave etj.

Në bashkëbisedim me një femër tjetër, personazhi tregon se për çfarë e ngacmojnë të tjerët. Ajo tregon se të tjerët e ngacmojnë kur vishet me minifund ose ndonjë fustan. Në dhomën e saj, ajo zgjedh rrobat për të veshur dhe bëhet gati për të dalë. Tregon për ngacmimet që ka pasur në rrugë nga persona të ndryshëm. Ndërkohë që ecën rrugëve të Tiranës, ajo që të bënë përshtypje është mënyra se si e shikojnë meshkujt. Çdo femër në botë ka përjetuar të paktën një herë në jetë ngacmime në rrugë.

## Fushat e kurrikulës
Shoqëria dhe Mjedisi.

## Përshtatshëm për
Shkallën; 5, 6. Klasa: XI dhe XII.

## Kompetencat
Kompetenca e komunikimit dhe të të shprehurit - Komunikues efektiv (1. Shprehet përmes një forme të komunikimit, për një temë të caktuar në një material/prezantim prej 200 fjalësh dhe veçon çështjet kryesore të ngritura në material/prezantim; 2. Lexon rrjedhshëm një tekst në gjuhën amtare, të përbërë prej 3-5 paragrafëve, u përgjigjet pyetjeve të shtruara për llojin e tekstit, stilet e të shkruarit, tregon qëllimin dhe lidhjen ndërmjet përmbajtjes së paragrafëve.)

Kompetenca e të menduarit - Mendimtar kreativ (1. Në forma të ndryshme të të shprehurit prezanton mënyrën e grumbullimit, të zgjedhjes dhe të klasifikimit të informatave për fusha të ndryshme mësimore apo për një temë të caktuar, ofron argumente për zhvillimet aktuale lidhur me temën përkatëse p.sh., temë nga shkenca, nga kultura, nga arti, nga sporti, nga shëndetësia, nga shoqëria, nga mjedisi etj).

Kompetenca e të nxënit - Nxënës i suksesshëm (1. Demonstron shkathtësi funksionale në lexim-shkrim, në matematikë, në jetën e përditshme, në përmbushjen e kërkesave të ndryshme për kryerjen e një detyre apo aktiviteti dhe gjatë të nxënit të dijeve të reja në ndonjë fushë të caktuar mësimore; 2. Parashtron pyetje dhe shfaq mendime të strukturuara për zgjidhjen e një problemi apo detyre të caktuar, bën përmbledhjen e së paku dy veprimeve të përdorura të cilat përcaktojnë drejtimin e mëtejmë të të nxënit të vet për temën apo problemin e caktuar).

## Objektivat
Zhvillon përgjegjësitë ndaj vetes, ndaj të tjerëve, ndaj shoqërisë dhe ndaj mjedisit.

## Pikat e diskutimit

Çfarë kuptoni me konceptin perceptim social?
Si i krijojmë ne përshtypjet për të tjerët?
Përshkruani procesin e kalimit nga përshtypja e parë te skemat?
Çfarë kuptoni me stereotipizim?
Pse veshja është më e rëndësishme më shumë për femrat se sa për meshkujt në formimin e përshtypjeve?
Pse femrat stereotipizohen më shumë se meshkujt?

## Aktivitetet

### Stuhi mendimesh.
Mësimdhënësi/ja organizon me klasën stuhi mendimesh për konceptin e perceptimit social.

### Veprimtari me lexim të drejtuar (VLD).
Mësimdhënësi/ja nxit mendimin e nxënësve nëpërmjet pyetjeve të mëposhtme: 1. Si i krijoni ju përshtypjet për të tjerët? 2. Si i formojmë stereotipat për meshkujt dhe femrat? Më pas klasa ndahet në dy grupe. I orienton nxënësit të marrin informacion rreth çështjeve të mësimit. Grupi 1: Nxënësit japin një shpjegim për formimin e përshtypjeve dhe skemave. Grupi 2: Nxënësit japin një shpjegim për stereotipet.

### Rishikim me rigrupim.
Secilit grup i ipet një fletë në të cilën shtrohet një mësim, detyrë, pyetje apo problem. Pastaj, kur grupet ta kryejnë punën në fletën e vet, fleta përcillet nga njëri grup tek tjetri derisa të gjitha grupet t'i shkruajnë mendimet e tyre për temën apo t'i plotësojnë mendimet që i kanë dhënë grupet tjera. Pyetja: Pse veshja është e rëndësishme më shumë për femrat sesa për meshkujt në formimin e përshtypjeve? Pyetja: Pse femrat stereotipizohen më shumë se meshkujt?



Njësia mësimore

Karakteristikat e jetës së të rriturve (Karakteristikat kryesore të përshtatjës në martesë) (kl. XII)

Të menduarit (Mendimi dhe vendimmarrja për sjellje të sukseshme) (kl. XII)

Seksualiteti dhe Gjinia (Rolet Gjinore) (kl. XI)

# Nën Duvak

Përgatitur nga
Sabina Dishallari, SH. M. "Gjon Buzuku" Prizren
Gyltene Isufi, SH. M. "Zenit" Prishtinë
Arbnesha Kusari, SH. M. "Hajdar Dushi" Gjakovë

**Regjia: Entela Hoxha**

## Përshkrimi i filmit

"Paqi nevojë për mu, aq sa keni për pare" Filmi dokumentar "Nën Duvak" trajton martesën tradicionale në Malësinë e Hasit, se si në të kaluarën vajzat janë martuar. Shikuar në mënyrë kronologjike vajzat dhe gratë në shoqërinë tonë në përgjithësi më shumë kanë shërbyer në kujdesin familjar në përgjithësi, thuajse as pak nuk janë marrë në konsideratë mendimet apo vendimet që kanë të bëjnë me jetën e tyre, siç janë; shkollimi apo martesa.

Tek ky film gjejmë kryesisht se cila ka qenë mundësia në mes të përzgjedhjes apo dëshirave në raport me familjen lidhur me vendimin e martesës, që do të thotë se përzgjedhja e partnerëve për martesë nuk përcaktohej nga dashuria por ishin prindërit ata që vendosni për fëmijët e tyre sa i përket martesës, ku imponimi ndërlidhet si mohimi i të drejtave të njeriut.

Qysh nga fëmijëria vajzat janë rritur me idenë se duhet të hynë në martesë, të krijojnë familje, janë këshilluar brez pas brezi në këtë mënyrë jetese. Kujdesi për mirëqenien e saj, psiko-social, nuk ka ekzistuar, por është krijuar izolimi dhe neglizhimi ndaj dëshirave, qëllimeve dhe ëndrrave të vajzave. E gjithë kjo mund të ketë ndikuar në mos krijimin e identitetit personal dhe përgjithësimin e tipareve të vetëpersonalitetit.

Kur e analizojmë në kontekstin kohor të tanishëm, ajo trajtohet më shumë si vegël materiale dhe shfrytëzuese për familjen ku do të jetoj. Në vazhdimësi të filmit kemi inserte se si gruaja trajtohet si pronë e burrit, e në ato rrethana një gjë e tillë konsiderohet si çështje normale, ku burri është ai që merr vendime për jetën e saj. Krahasimi i jetës familjare dhe i marrëdhënieve martesore në ditët e sotme me ato të priudhave të hershme, tregon se familja ka ndryshuar në mënyrë të dukshme si i përket mënyrës së stilit të jetesës.

## Fushat e kurrikulës
Shoqëria dhe mjedisi, Gjuhë dhe komunikim.

## Përshtatshëm për
Shkallën 4, 5, 6 Klasat IX, X, XII.

## Kompetencat
Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit,
Kompetenca e të menduarit,
Kompetenca për jetë, punë dhe mjedis,
Kompetenca qytetare.

## Objektivat
-Aftësim për mësim gjatë gjithë jetës,
-Promovimi i vlerave kulturore dhe qytetare.

## Pikat e diskutimit

Si e përceptoni martesën në këtë film?
Cili është roli vendimmarrës i personave në këtë film?
Cilat janë pasojat e martesave të hershme?
Krahasimi i martesave në periudha kohore.
Çfarë ndikimi ka imponimi i martesës në gjendjen emocionale?
Mungesa shkollore, pasojë e inferioritetit në shoqëri.
Patriarkaliteti dominant në familje dhe shoqëri.

## Aktivitetet

### Evokim – Stuhi mendimesh
Në fillim të orës mësimore pyesim nxënësit se çfarë njohurie kanë për martesën tradicionale në shoqërinë tonë dikur dhe tani. Bëjmë një hyrje të shkurtër dhe shkëmbejmë pyetje dhe përgjigje rreth asaj se çka kemi në fokus. Më pas shikojmë filmin.

### Realizimi – Këndet
Pas përfundimit të filmit marrim mendimet e përgjithshme për filmin, më pastaj nxënësit i informojmë për referencat që do të marrin në lidhje me filmin, ku do të kenë mundësinë të shënojnë në fletë ndonjë detaj nga ajo që shohin, që do të ju shërbej si pikë reference për diskutim. Ndahen në dy grupe dhe shënojnë pikat e diskutimit që do të realizohen.

### Reflektim
Pasi përcaktohemi për pikat e diskutimit i ndajmë nxënësit në dy grupe ku diskutohet. Grupi i parë do të mbrojë pikën e diskutimit: Martesa bashkëkohore dhe rolet gjinore; Grupi i dytë do të mbrojë pikën e diskutimit: Martesa tradicionale dhe rolet gjinore. Të dy nga grupet, do të mbrojnë gjithë përmbledhjen e diskutimit. Detyrë për nxënësit: Sygjerojmë nxënësit në mënyrë individuale të mbledhin më shumë materiale për këto dy pika diskutimi dhe të reflektojnë me një ese të analizuar me kritikën e tyre.



Njësia mësimore

Ndikimi social. Grupet.

# Origjina e radikalizimit

**Regjia: Anilë Shkodra**

Përgatitur nga
Jeta Rexha, SH. M. "Hajdar Dushi" Gjakovë

## Përshkrimi i filmit

Filmi dokumentar "Origjinë e radikalizmit" është një film që flet për prirjet ekstremiste, tendencat e tyre, tiparet e një ekstremisti si dhe çfarë i shtynë individët që t'i bashkohen grupeve ekstremiste. Anila, protagonistja e filmit ka zbuluar se të gjithë individët gjykohen për mënyrën e tyre ekstreme të të menduarit, cilado që të jetë ajo.

Ajo tregon për lloje të ndryshme të ekstremizmit dhe si ndikon ajo në shoqëri. Cilët janë njerëzit më të synuar dhe më të prekshëm që bien në grackën e radikalizmit ekstrem? Profesori i gjuhës frenge në një nga shkollat e mesme flet për personat që bien më lehtë pre e ekstremizmit të dhunshëm. Ai thotë se më të rrezikuar janë njerëzit më vështirësi ekonomike, njerëzit me vështirësi të natyrës psikologjike, ata që kanë përjetuar frustrime të ndryshme si dhe njerëzit që nuk kanë mundur t'i arrijnë synimet e tyre. Tutje profesori flet edhe për tendencat që ekzistojnë në vendin tonë që të imponohen të njejtat ideologji. Duhet të punojmë të gjithë për ta luftuar këtë fenomen.

## Fushat e kurrikulës
Shoqëria dhe Mjedisi.

## Përshtatshëm për
Shkallën; 5, 6. Klasa: XI dhe XII.

## Kompetencat
I. Kompetenca e komunikimit dhe të të shprehurit - Komunikues efektiv (1. Shprehet përmes një forme të komunikimit, për një temë të caktuar në një material prej 200 fjalësh dhe veçon çështjet kryesore të ngritura në material; 2. Lexon rrjedhshëm një tekst në gjuhën amtare, të përbërë prej 3-5 paragrafëve, u përgjigjet pyetjeve të shtruara për llojin e tekstit, stilet e të shkruarit, tregon qëllimin dhe lidhjen ndërmjet përmbajtjes së paragrafëve)

II. Kompetenca e të menduarit - Mendimtar kreativ (Në forma të ndryshme të të shprehurit prezanton mënyrën e grumbullimit, të zgjedhjes dhe të klasifikimit të informatave për fusha të ndryshme mësimore apo për një temë të caktuar, etj.).

III. Kompetenca e të nxënit - Nxënës i suksesshëm (Demonstron shkathtësi funksionale në lexim-shkrim, në matematikë, në jetën e përditshme, në përmbushjen e kërkesave të ndryshme për kryerjen e një detyre apo aktiviteti dhe gjatë të nxënit të dijeve të reja në ndonjë fushë të caktuar mësimore).

IV. Kompetenca personale - Individ i shëndoshë (1. Analizon përparësitë dhe dobësitë personale, duke i evidentuar masat përmes të cilave synon të mbështesë avancimin personal në përparësitë që ka dhe masat përmes të cilave synon të përmirësojë dobësitë personale).

## Objektivat
Kultivuar identitetin personal, kombëtar, të përkatësisë shtetërore e kulturore.

## Pikat e diskutimit

Çfarë kuptoni me vetë-koncept?
Çfarë është grupi?
Cilat janë karakteristikat e grupit?
Pse njerëzit i bashkohen një grupi?
Sikur njerëzit të mos jetonin së bashku në grup, si do të ishte bota sot?

## Aktivitetet

### Stuhi mendimesh.
Mësimdhënësi/ja u kërkon nxënësve t'i përgjigjen pyetjes si më poshtë: Si e përshkruani ju veten?

### Ditari dy-pjesësh.
Nxënësit informohen për atë që do të lexojnë (lexohet pjesa e tekstit në libër) dhe që gjatë leximit do të merren shënime, dhe do të shkruhen te rubrika përgjigje. Më pas klasa ndahet në dy grupe. Grupi I: 1.Çfarë është grupi? 2.Cilat janë karakteristikat e grupit? Grupi II: 1.Si qëndrojnë grupet së bashku?

### Ese.
Imagjinoni sikur njerëzit të mos jetonin së bashku. Si do të ishte bota sot? Çfarë do të mendonit për të tjerët?



Njësia mësimore

Diversiteti socio-kulturor midis individëve

# Pa vlla

**Regjia: Alba Demiri, Genta Sefa**

Përgatitur nga
Sabina Halili, SH. M. "Gjon Buzuku" Prizren

## Përshkrimi i filmit

Filmi dokumentar " Pa vlla" përshkruan historitë e tri femrave pa vëlla dhe ndjenjat e tyre kur njerëzit i pyesin "A nuk keni vlla"? si dhe një tjetër femër e cila tregon për dëshirën dhe përpjekjet e familjës për të pasur një djalë. Pas shumë vajzave lind një djal në familje, mirëpo ende vazhdon përpjekja për të pasur edhe një djalë tjetër për të qenë krahu i vëlluat. Por, lindë vajzë (personazhia e këtij filmi).

Kjo femër tregon për gjithë ato vështirësi, nënçmime, injorime, që i ka marr nga anëtarët e familjës pse ka lindur vajzë. Për të qenë e pranuar në familje kjo bën të gjitha punët që i bën një mashkull dhe çdo herë ka qenë bashkë me vëllaun në punët e rënda fizike, vetëm e vetëm për të qenë e pranueshme në familje.

Sipas filmit dokumentar, tregohet se në shoqërinë tonë ekzistojnë stereotipet gjinore dhe vajzat që nuk kanë vëlla në mënyrë të pavetëdijshme luajnë rolin e mashkullit që prindërve të ju plotësojnë boshllëkun e djalit.

## Fushat e kurrikulës
Shoqëria dhe Mjedisi

## Përshtatshëm për
Shkallën; 5, 6. Klasa: XI

## Kompetencat
I Kompetenca e komunikimit dhe të të shprehurit - Komunikues efektiv (Shpreh mendimin e lirë, opinionin dhe qëndrimin për një temë të caktuar nga jeta, shkenca, shoqëria, duke përdorur forma të ndryshme të komunikimit me gojë me shkrim etj.)

II Kompetenca e të menduarit - Mendimtar kreativ (Në forma të ndryshem prezanton mënyrën e grumbullimit, të zgjedhjës dhe të klasifikimit të informatave për një temë të caktuar, ofron argumente për zhvilimin aktual lidhur me temën përkatëse)

III Kompetenca e të nxënit – Nxënës i sukseshëm (Në mënyrë efektive shfrytëzon përvojat paraprake gjatë zgjidhjes së situatave të ndryshme në jetën e përditshme apo gjatë kryerjës së një detyre, ndan përvojat me të tjerët për mënyrat më praktike të shfrytzimit të përvojave pararake në arritjen e dijeve të reja.)

VI Kompetenca qytetare – Qytetar i përgjegjshëm (Shpjegon të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e individit në raste të ndryshme, si: në shtëpi, në klasë, në shkollë, në shoqëri, dallon rastët kur hyjnë në konflikt me njëri-tjetrin dhe paraqet alternativa të zgjidhjës së tyre.)

## Objektivat
Aftësim për mësim gjatë gjithë jetës;
Përgjegjësia ndaj vetës si dhe shoqërisë;
Krijimi i identitetit personal.

## Pikat e diskutimit

Ku ndryshon kultura individualiste nga ajo kolektiviste?
Si ndikojnë faktorët social dhe kulturor te: koncepti për veten, qëndrimet, tërheqja, paragjykimet dhe stereotipat?
A mendon se janë të sterotipizuara familjet që nuk kan djal në vendin tonë, krahasur me vendet tjera të botës?

## Aktivitetet

### Hapi I: Harta e konceptit
Mësimdhënësja fillimisht shënon konceptët kryesore në tabele dhe ju drejton pyetje nxënësve, për të marrë përgjigje rreth këtij koncepti: Çka kuptoni me diversitet socio-kulturor?

### Hapi II: Veprimtari me lexim të drejtuar (VLD) dhe shikimi i filmit
Klasa ndahet në tri grupe. Mësimdhënësi i orienton nxënësit të marrin informacion rreth çështjeve të mësimit. Grupi 1: Diversiteti socio-kulturor; Grupi 2: Stereotipat; Grupi 3: Diskriminimi. Fillimisht nxënëit e lexojnë njësinë mësimore dhe më pastaj ju lëshohet filmi. Nxënësve u lihet kohë në dispozicion për të marrë informacionin e nevojshëm nga teksi mësimor dhe shikimi i filmit i nxit nxënësit ta diskutojnë këtë temë. Pasi nxënësit janë gati, ata i diskutojnë informacionet me mësimdhënësin/en. Njohuritë e nxënësve plotësohen me informacione të tjera nga mësimdhënësi/ja.

### Hapi III: Shkrim i lirë
Duke u bazuar ne përvojen tuaj personale dhe filmin që e shikuat shënoni mbiemrat që ju vendosen vajzave dhe djemve në kulturën tonë si dhe rolet profesionale.



Njësia mësimore

Stresi dhe përballimi i tij.

# Për hatër

**Regjia: Anisa Krasniqi, Bardha Kryeziu**

Përgatitur nga
Jeta Rexha, SH. M. "Hajdar Dushi" Gjakovë

## Përshkrimi i filmit

Filmi dokumentar "Per hatër" flet për një grua në moshë të mesme e cila është martuar në moshën 25 vjeçare. Ajo rrëfen jetën e saj martesore e cila në fillim ka qenë e mirë, ka pasur marrëdhënie të mira deri në momentin kur burri i saj kishte filluar të përdorte alkool. Ajo ka pesë vajza dhe një djalë. Kur filloi të përdorte alkool, atëherë kishte filluar të sillte probleme në familje, thotë ajo. Gruaja tregon se si ai kishte filluar të përdorte edhe fjalë banale dhe të gjitha këto i bënte karshi fëmijëve.
Thotë ta ketë përkrah familja e saj, dhe kanë kërkuar të ndahet nga burri, meqë ai sillte probleme në shtëpi, mirëpo gruaja nuk pranon të ndahet hatri i fëmijëve. Ndarja nga burri po i shkakton gruas presion psiqik edhe për shkak të ndikimit social, fjalëve të të tjerëve. Gruas i bëjnë përshtypje fjalët e të tjerëve dhe pikërisht për këtë shkak ajo e ka të vështirë të ndahet.

Ajo rrëfen vuajtjen e saj shpirtërore, dhunën psiqike dhe fizike që ka përjetu sa herë që burri ka shkuar në shtëpi i dehur. Me gjithë vështirësitë që përjeton, ajo gjen forcë t'i motivojë fëmijët e saj për një jetë më të mirë.

## Fushat e kurrikulës
Shoqëria dhe Mjedisi

## Përshtatshëm për
Shkallën: V dhe VI; Klasa: XI dhe XII

## Kompetencat
I.Kompetenca e komunikimit dhe të të shprehurit - Komunikues efektiv (I.1 Shprehet përmes një forme të komunikimit, për një temë të caktuar në një material (prezantim) prej 200 fjalësh dhe veçon çështjet kryesore të ngritura në material (prezantim). I.2 Lexon rrjedhshëm një tekst në gjuhën amtare, të përbërë prej 3-5 paragrafëve, u përgjigjet pyetjeve të shtruara për llojin e tekstit, stilet e të shkruarit, tregon qëllimin dhe lidhjen ndërmjet përmbajtjes së paragrafëve.

II.Kompetenca e të menduarit - Mendimtar kreativ (II.1 Në forma të ndryshme të të shprehurit prezanton mënyrën e grumbullimit, të zgjedhjes dhe të klasifikimit të informatave për fusha të ndryshme mësimore apo për një temë të caktuar, ofron argumente për zhvillimet aktuale lidhur me temën përkatëse (p.sh., temë nga shkenca, nga kultura, nga arti, nga sporti, nga shëndetësia, nga shoqëria, nga mjedisi etj).

III.Kompetenca e të nxënit - Nxënës i suksesshëm (III.1 Demonstron shkathtësi funksionale në lexim-shkrim, në matematikë, në jetën e përditshme, në përmbushjen e kërkesave të ndryshme për kryerjen e një detyre apo aktiviteti dhe gjatë të nxënit të dijeve të reja në ndonjë fushë të caktuar mësimore.)

## Objektivat
Njeh përkufizimin e stresit;
Përcakton burimet kryesore të stresit;
Shpjegon reagimet fiziologjike dhe psikologjike ndaj stresorëve;
Harton plane për përballimin e stresit personal;
Vlerëson rëndësinë e shëndetit tonë fizik dhe mendor në një jetë pa stres.

## Pikat e diskutimit

Çka kuptoni me stres?
Identifikoni burimet e stresit?
Reagimi i trupit ndaj stresit (psikologjik, fizik, të sjelljes).
Pakësimi dhe tolerimi i stresorëve.
Stresi dhe shëndeti jonë mendor.

## Aktivitetet

### Rrjeti i diskutimit
Shtrohet për diskutim situata e filmit dokumentar. Çfarë mendimi keni ju ndaj kësaj situate?

### Punë në grupe
Nxënësit ndahen në tri grupe. Çdo grup zgjedh përfaqësuesin e tij. Ndahen temat për secilin grup. Grupi I: Burimet e stresit; Grupi II: Reagimet ndaj stresit; Grupi III: Strategjitë për përballimin e saj; Nxënësit, informacionet për temën i marrin nga libri si dhe bëjnë lidhjen midis këtyre informatave dhe sekuencave të filmit.

### Ese
Nxënësit shkruajnë ese për: “Ndikimin e stresit në shëndetin tonë mendor”.



Njësia mësimore

Fushat e sjelljes emocionale

# Përbrenda

**Regjia: Lejla Musanovic, Norika Sefa, Relja Pekic**

Përgatitur nga
Sabina Halili - Dishallari, SH. M. "Gjon Buzuku" Prizren

## Përshkrimi i filmit

Në këtë film dokumentar "Përbrenda" trajtohet veprimtaria dhe jeta e një familje në qëndër të Prizrenit. Aty shohim një ambient pak të izoluar, por Ergjani është nje djalë i ri, i cili i jep harmoni familjes dhe veprimtarisë së tij. Ai flet me shume pasion për profesionin e tij prej kasapi si dhe për historinë e familjës së tij, të cilët i kanë lënë si trashëgimi këtë shtëpi e cila ka qenë mjaftë e vjetër dhe vazhdon të jetë në vendin e njëjtë, por me disa ndryshime pozitive në
strukturën e shtëpisë.
Në këtë film shohim emocione të vetëdijshme siç janë krenaria, që Ergjani e ka ndaj profesionit të tij, pastaj e kemi ndjenjën e turpit që e ka përjetuar gjyshi i gjyshes së Ergjanit dhe nga kjo ndjenjë ai është fshehur duke e vendosur një kapelë për t'iu shmangur kontaktit me të tjerët.

Kurse Ergjani ka një lidhje të mirë me të tjerët dhe familjën, ku shohim një pranim social dhe në të njëjtën kohë shmang përjashtimin nga tjerët. Pra, në këtë film shohim se emocionet janë universale dhe kanë funksion adaptues.

## Fushat e kurrikulës
Shoqëria dhe Mjedisi

## Përshtatshëm për
Shkallën; 5, 6; Klasa: XI

## Kompetencat
I. Kompetenca e komunikimit dhe të të shprehurit - Komunikues efektiv (I.7 Shpreh mendimin e lirë, opinionin dhe qëndrimin për një temë të caktuar nga jeta, shkenca, shoqëria, duke përdorur forma të ndryshme të komunikimit me gojë me shkrim etj.)
II. Kompetenca e të menduarit - Mendimtar kreativ (II.1 Në forma të ndryshem prezanton mënyrën e grumbullimit, të zgjedhjës dhe të klasifikimit të informatave për një temë të caktuar, ofron argumente për zhvilimin aktual lidhur me temën përkatëse.)
III. Kompetenca e të nxënit – Nxënës i suksesshëm (III. 2. Në mënyrë efektive shfrytëzon përvojat paraprake gjatë zgjidhjes së situatave të ndryshme në jetën e përditshme apo gjatë kryerjës së një detyre, ndan përvojat me të tjerët për mënyrat më praktike të shfrytëzimit të përvojave pararake në arritjen e dijeve të reja.)
VI. Kompetenca qytetare – Qytetar i përgjegjshëm (VI. 1. Shpjegon të drejtat, detyrat dhe përgjegjësit e individit në raste të ndryshme, si: në shtëpi, në klasë, në shkollë, në shoqëri, dallon rastët kur hyjnë në konflikt me njëri-tjetrin dhe paraqet alternativa të zgjidhjës së tyre.

## Objektivat
Sipas kurrikulës së Kosovës objektivat që synohen të arrihen përmes këtij filmi dokumentar janë: Të përgjithshmet | Aftësim për mësim gjatë gjithë jetës, Përgjegjësia ndaj vetes si dhe shoqërisë, Aftësimi për jetë dhe punë në kontekste të ndryshme shoqërore.

Sipas lëndës dhe njësisë mësimore qëllimet që duhët të arrihen përmes këtij filmi dokumentar janë: Nxënësi njeh rolin e evolucionit në shprehjen e emocioneve, Nxënësi vlerëson funksionin adaptues të emocioneve, Nxënësi shpjegon intelegjencën emocionale.

## Pikat e diskutimit
Çfarë ju shtyen të mendoni ky film dokumentar?
Shpjegoni funksionin adaptues dhe universal të emocioneve sipas Çarls Darvinit?
Çfarë funksioni kanë emocionet?
Çfarë është inteligjenca emocionale?
Çfarë rëndësie ka familja në ushtrimin e profesionit dhe në gjendjen emocionale të individit?

## Aktivitetet
### Harta e konceptit
Mësimdhënësja fillimisht shënon konceptet kryesore në tabelë dhe ju drejton pyetje nxënësve, për të marrë përgjigje rreth këtij koncepti: Çfarë rëndësie kanë emocionet në jetën tonë?

### Veprimtari me lexim të drejtuar (VLD) dhe shikimi i filmit
Fillimisht nxënësve ju lëshohet filmi dhe pastaj nxënësit ndahën në grupe. Gr.1 Roli i evolucionit në emocione; Gr.2 Funksionet adaptuese të emocioneve; Gr.3 Inteligjenca emocionale. Nxënësve u lihet kohë në dispozicion për të marrë informacionin e nevojshëm nga teksi mësimor dhe shikimi i filmit i nxit nxënësit ta diskutojnë këtë temë. Pasi nxënësit janë gati, ata i diskutojnë informacionet me mësimdhënësin/en. Njohuritë e nxënësve plotësohen me informacione të tjera nga mësimdhënësi/ja.

### Shkrim i lirë
Interpretoni emocionet tuja që keni ndaj shkollimit tuaj të tanishëm pasi që kjo është veprimtari e juaj momentale apo çfarë emocione keni ndaj shkollës.



Njësia mësimore

Seksualiteti dhe gjinia

# Përtej ylberit

**Regjia: Vlera Azizi**

Përgatitur nga
Feride Thaçi, SH. M. "Ulpiana" - Lipjan

## Përshkrimi i filmit

"Përtej Ylberit" është një film dokumentar i shkurtër që përqendrohet në stilet shumëngjyrëshe të jetës së njerëzve gjithandej botës. Përmes dy 'drag-queens' vërehet dëshira e madhe dhe këmbëngulësia e tyre për të shfaqur dhe përqafuar personalitetin e tyre në mënyrë dinjitoze, pavarësisht vështirësive që hasin njerëzit e komunitetit të tillë në vendin tonë.
Gjithashtu, në pjesën e fundit të filmit dokumentar trajtohen çështjet e homofobisë dhe vështirësitë që komuniteti LGBTI ballafaqohet në vazhdimësi në vendin tonë.

Dokumentari përmban biseda midis 'drag-queen'-eve të njohura Agatha Bones dhe Diva.

## Fushat e kurrikulës
Shoqëria dhe mjedisi

## Përshtatshëm për
Shkalla VI; Klasa XII.

## Kompetencat
Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit (I);
Kompetenca e të menduarit - mendimtar kreativ (II);
Kompetenca personale - Individ i shëndoshë (V);
Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm (VI).

## Objektivat
Përshkruan qëndrimet dhe sjelljen seksuale;
Analizon rolet gjinore;
Identifikon ndikimin e faktorëve kulturor dhe social mbi seksualitetin;
Të demonstroj të kuptuarit për identitetin dhe rolet gjinore.

## Pikat e diskutimit

Cilat janë pasojat psikologjike që mund të kenë individët që janë të detyruar t'i përfillin rolet gjinore në mënyra strikte?
Cilat janë mitet dhe të vërtetat rreth seksualitetit?
Çfarë është opinioni juaj rreth komunitetit LGBTI?

## Aktivitetet

### Evokim - (3 min.)
"Minileksion procedural" , Shfaqja e filmit dokumentar "Përtej ylberit" (7 min).

### Realizim kuptimi - (20 min.)
"Të lexuarit në bashkëveprim", nxënësit punojnë në dyshe, nga mësimdhënësi kërkohet të lexohet me kuriozitet teksti. Në dyshe bashkëveprojnë nxënësit me qëndrime të ndryshme rreth roleve gjinore dhe LGBTI-së. Mendimet e tyre nxënësit duhet t'i hedhin në fletë dhe pastaj t'i diskutojnë me nxënësit tjerë në klasë.

### Reflektimi - (15 min.)
"Pyetja sjell pyetjen", mësimdhënësi nxit diskutimin mes nxënësve nëpërmjet pyetjeve: Cilat janë pasojat psikologjike që mund të kenë individët që janë të detyruar t'i përfillin rolet gjinore në mënyra strikte? Cilat janë mitet dhe të vërtetat rreth seksualitetit? Çfarë është opinioni juaj rreth LGBTI-së?



Njësia mësimore

Emigrimi. Imigrimi. Dyndjet e popullësisë.

# Rrëfimet e Emigrantit

**Regjia: Gazmir Lame**

Përgatitur nga
Gyltene Isufi, SH. M. "Zenit" Prishtinë
Jeta Rexha, SH. M. "Hajdar Dushi" Gjakovë
Merita Shala, SH. M. "Ahmet Gashi" Prishtinë

## Përshkrimi i filmit

Filmi dokumentar "Rrëfimet e emigrantit" trajton fenomenin e migrimit gjatë periudhës së migrimeve masive në vitin 2014 / 2016 në Kosovë. Papunësia dhe gjendja e rëndë ekonomike si dhe mungesa e përspektivës kanë ndikuar që shumë të rinjë të mësyejnë rrugët e Europës. Migrimet e para të shqiptarëve datojnë nga kohët më të lashta, por janë të njohura dyndjet masive në periudha të ndryshme përgjatë historisë.

Si shumica e qytetarëve të Kosovës në mungesë të liberalizimit të vizave dhe lëvizjes së lirë në vendet e Bashkimit Europian edhe Lundrimi është njëri ndër ata që nuk e ka bërë asnjë hap jashtë Kosovës, e që udhëtimi me autobus natën për në Serbi është vërtetë stresues. Kjo ishte dita më stresuese dhe më e gjatë për Lundrimin, edhe pse ai shfaq përsëri durim ani pse 10km. rrugë për në Suboticë dhe se kalimi nga Serbia për Hungari përmes malit është i rrezikshëm dhe mund të arrestohet nga policia. "Kurrë nuk përfundon," ofshan Lundrimi gjersa tymi i cigarës i'a mbulon fytyrën e dëshpëruar.

Çfarë ndodhë me migrantët kur nuk kanë para më? Lundrimi është i dëshpëruar, pa para, dhe nuk ka para për taksi për ta dërguar në kufi...

Lundrimi më në fund është me fat, takon një trafikant emigrantësh në stacion i cili ka ardhë më i marrë disa refugjatë... Largimi i qytetarëve të Kosovës për në vendet e Bashkimit Evropian vazhdon edhe sot e kësaj dite, mirëpo përmes marrjes së vizave të punës. Sfidë për autoritetet shtetërore është riatdhesimi i të ikurve dhe ripranimi i tyre në bazë të standardeve që i kërkon BE-ja.

## Fushat e kurrikulës
Shoqëria dhe mjedisi, Gjuhë dhe komunikim.

## Përshtatshëm për
Shkalla 5, 6. Klasa X, XI.

## Kompetencat
Nxënës i suksesshëm, Mendimtar kreativ, Komunikues efektiv

## Objektivat
-Promovimi dhe kultivimi i vlerave kulturore dhe qytetare;
-Përgjegjësia ndaj mjedisit;
-Përdorimi i teknologjisë;
-Aftësimi për punë dhe jetë.

## Pikat e diskutimit

Migrimet e shqipëtarëve në periudha të ndryshme kohore (Historiku i migrimeve).
Motivet që ndikojnë në migrimin e njerëzve.
Migrimet e jashtme/brendshme përkohshme/përhershme.
Faktorët (shkaktarët) e migrimeve.
Pasojat e migrimeve.
Integrimi/Riintegrimi.
Asimilimi dhe format e shprehjes së tij.
Mungesa e përspektivës te të rinjët.
Orientimi në tregun e punës.
Ballafaqimi me kultura/realitet tjetër.

## Aktivitetet

### Evokim – Stuhi mendimesh
1. Tendencat e njerëzve për lëvizje gjeografike dhe sociale. 2. Cilët janë faktorët që ndikojnë që individi apo grupi të migrojnë? 3. Pasojat e migrimeve: demografike, ekonomike, sociale, kulturore dhe politike. 4. Asimilimi dhe shembuj të funksionimit të modelit të asimilimit.

### Realizimi – ndahen nxënsit në grupe
1. Migrimet për shkaqe/arsye shkollimi/arsimimi si dhe pasojat. 2. Migrimet për shkaqe/arsye ekonomike/politike si dhe pasojat. 3. Migrimet për shkaqe/arsye konflikti/luftëra si dhe pasojat. 4. Migrimet për shkaqe sociale/kulturore si dhe pasojat.

### Reflektim - Pesëvargëshi
1. Emër. 2. Dy mbiemra. 3. Folje. 4. 1 fjali/mesazh. Shkrim i lirë: Arsyet pse duhet ne duhet të qëndrojmë në Kosovë?



Njësia mësimore

Adoleshenca

# Shokët e mi

**Regjia: Gentrit Kastrati**

Përgatitur nga
Jeta Rexha, SH. M. "Hajdar Dushi" Gjakovë

## Përshkrimi i filmit

Filmi dokumentar "Shokët e mi" përshkruan jetën e një adoleshenti, i cili është viktimë e bullizmit, qysh nga shkolla fillore. Por edhe në shkollë të mesme ka vazhduar e njejta dhunë psikologjike. Ky djal për çdo ditë ka përjetuar fjalë shumë fyese për pamjen e tij, të cilat fjalë kanë ndikuar negativisht në gjendjen emocionale, duke e shtyrë të ndihet i pa vlerë dhe i pa pranueshëm nga rrethi shoqëror.

Kjo dhunë psikologjike dhe injoranca sociale kanë ndikuar në paraqitjen e ankthit dhe depresionit. Mirëpo falë miqve virtual që ka krijuar nëpërmjet rrjeteve sociale, ka arritur të dalë nga kjo gjendje. Përkrahjen dhe mbështetjen që i kanë dhënë këta miq, adoleshenti është motivuar që këto përjetime t'i ritregojë me anë të xhirimit të një filmi.

Me anë të këtij filmi ky djal ka arritur të prekë 2 pika shumë të rëndësishme:
- Të bëjë një fushatë vetëdijesuese për fenomenin e bullizmit që ndodhë nëpër shkolla dhe
- T'i bëjë psikoterapi vetes.

## Fushat e kurrikulës
Shoqëria dhe Mjedisi

## Përshtatshëm për
Shkallën; 5, 6. Klasa: XI

## Kompetencat
I. Kompetenca e komunikimit dhe të të shprehurit - Komunikues efektiv (Shpreh mendimin e lirë, opinionin dhe qëndrimin për një temë të caktuar nga jeta, shkenca, shoqëria, duke përdorur forma të ndryshme të komunikimit me gojë, me shkrim, etj.)

II. Kompetenca e të menduarit - Mendimtar kreativ (Në forma të ndryshme prezanton mënyrën e grumbullimit, të zgjedhjës dhe të klasifikimit të informatave për një temë të caktuar, ofron argumente për zhvilimin aktual lidhur me temën përkatëse)

III. Kompeteca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm (Demonstron veprime të ndryshme që shprehin tolerancë, respekt dhe qëndrim të hapur ndaj dallimeve në komunitetin ku jeton (në klasë, në shkollë, në lagje dhe më gjerë) dhe i shpjegon ato në një debat me të tjerët)

## Objektivat
-Evitimi i paragjykimeve ndaj të tjerëve;
-Krijimi i identitetit personal;
-Promovon vlerat e përgjithshme kulturore dhe qytetare.

## Pikat e diskutimit

Çfarë kuptoni me egocentrizmin në adoleshencë?
Përshkruani kirzat e identitetit tek adoleshentët.
Tregoni rolin e moshatarëve për zhvillim social tek adoleshentët.
A mendon se ka bullizëm në shkollën tonë, por edhe nëpër shkollat tjera në përgjithësi?

## Aktivitetet

### Harta e konceptit
Mësimdhënësi/ja fillimisht shënon konceptet kryesore në tabele dhe ju drejton pyetje nxënësve, për të marrë përgjigje rreth këtij koncepti: Cilat janë sferat (aspektet) me më shumë ndryshime gjatë adoleshencës?

### Veprimtari me lexim të drejtuar (VLD) dhe shikimi i filmit
Fillimisht nxënësve ju lëshohet filmi dhe pastaj mësimdhënësi/ja i orienton nxënësit të marrin informacion rreth këtyre çështjeve të mësimit në libër. Nxënësve u lihet kohë në dispozicion për të marrë informacionin e nevojshëm nga teksti mësimor. Pasi ata e shikojnë edhe filmin besoj që janë të motivuar të mendojnë dhe të parashikojnë rreth asaj që po lexojnë. Kur nxënësit janë gati, ata i diskutojnë informacionet me mësimdhënësin/en. Njohuritë e nxënësve plotësohen me informacione të tjera nga mësimdhënësi/ja.

### Shkrim i lirë
Duke u bazuar në njohuritë që përfituat nga libri dhe shqetësimin që mund të përjetojnë shumë nxënës, cila është strategjia juaj për të parandaluar dhe luftuar dukurinë e bullizmit nëpër shkolla?



Njësia mësimore

Mosha e rritur dhe pleqëria.

# Stacioni i autobusit

**Regjisori: Magalie de Genova**

Përgatitur nga

Jeta Rexha, SH. M. "Hajdar Dushi" Gjakovë

## Përshkrimi i filmit

Filmi dokumentar "Stacioni i autobusit" flet për një grua të moshuar Anxhela e cila ngacmohet nga një grup adoleshentësh. Një nga ngacmuesit, Karteri, në një moment të papritur për të, ballafaqohet sërish me gruan e që çon në një rezultat të papritur. Filmi fillon pikërisht me tre adoleshentët që e sulmojnë mbrapa në kokë gruan.

Pavarësisht kësaj, të tre djemtë nuk i kërkojnë falje për sjelljen e tyre por vazhdojnë ta nënçmojnë duke e quajtur kokë-thinjur. Por ndodh diçka e papritur. Njëri nga ngacmuesit, Karter, qëlloi që Anxhelan, gruan që ditë më parë e ngacmoi, tashmë e kishte fqinj. Nëna e tij dhe Karter kishin shkuar në shtëpi te Anxhelas. Karter u habit kur e pa!

Anxhela kishte punuar si mësuese. Nëna e Karterit shpreh dëshirën që Anxhela të punojë me djalin e saj meqë ky kishte probleme me nota. Anxhela pranoi të ishte mësuese e

Karterit, pavarësisht që djali nuk donte që Anxhela të ishte mësuesja e tij. Karter filloi të ndjek mësimet tek Anxhela. Nuk ishte dëshira e tij, por detyrimi i nënës.

Metoda e mësimdhënies që zgjodhi Anxhela për ta edukuar Karterin, bëri që Karter të ndryshojë jo vetëm sjellje por edhe qëndrim se si duhet të trajtohet një person në moshë.

## Fushat e kurrikulës
Shoqëria dhe Mjedisi

## Përshtatshëm për
Shkallën: 5, 6
Klasët: XI, XII

## Kompetencat
I. Kompetenca e komunikimit dhe të të shprehurit - Komunikues efektiv (Shprehet përmes një forme të komunikimit, për një temë të caktuar në një material prej 200 fjalësh dhe veçon çështjet kryesore të ngritura në material (prezantim).
II. Kompetenca e të menduarit - Mendimtar kreativ (Në forma të ndryshme të të shprehurit prezanton mënyrën e grumbullimit, të zgjedhjes dhe të klasifikimit të informatave për fusha të ndryshme mësimore apo temë të caktuar, ofron argumente për zhvillimet aktuale lidhur me temën përkatëse (p.sh., temë nga shkenca, nga kultura, nga mjedisi etj).
III. Kompetenca e të nxënit - Nxënës i suksesshëm (Demonstron shkathtësi funksionale në lexim-shkrim, në matematikë, në jetën e përditshme, në përmbushjen e kërkesave të ndryshme për kryerjen e një detyre apo aktiviteti dhe gjatë të nxënit të dijeve të reja në ndonjë fushë të caktuar mësimore.)
IV. Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm (Demonstron veprime të ndryshme që shprehin tolerancë (klasë, shkollë, lagje, etj.) dhe i shpjegon ato në një debat me të tjerët.)

## Objektivat
-Përshkruan ndryshimet fizike në moshën e rritur;
-Njeh karakteristikat e zhvillimit mendor tek të rriturit;
-Vlerëson rëndësinë e zhvillimit socio-emocional në moshën e rritur.

## Pikat e diskutimit
Cilat janë karakteristikat fizike në moshën e rritur të hershme?
Cilat janë karakteristikat fizike në moshën e rrritur të mesme?
Cilat janë karakteristikat fizike në moshën e rritur të vonë?
Mendimi postformal, inteligjenca fluide dhe e kristalizuar kujt i referohet?
Cilat janë aspektet kryesore që prekin zhvillimin socio-emocional në moshën e rritur të hershme, mesme dhe vonshme?
Si trajtohen në shoqërinë tonë personat në moshë të vonë?
A mendoni që kur një burrë/grua pensionohet, mund ta vazhdojë akoma të jap kontribut në shoqëri?

## Aktivitetet
### Hapi I: Stuhi mendimesh
Pasi mësuesi/ja prezanton temën e mësimit në tabelë, nxënësit nxiten në një diskutim për pyetjet e mëposhtme: -Çfarë përfaqëson mosha e rritur? -Po pleqëria? Mësuesi/ja shënon në tabelë përgjigjet e nxënësve.
### Hapi II: Tabela e koncepteve
Klasa organizohet në tri grupe pune. Në tri fleta A4 të veçantë shënohen çështjet kyçe. Nxënësit orientohen që të lexojnë tekstin dhe të plotësojnë tabelat me çdo informacion që ata mendojnë se është i rëndësishëm. TABELA përmban këto kolona: Ndryshimet fizike në moshën e rritur / Zhvillimi mendor / Zhvillimi socio-emocional në moshën e rritur. Më pas, nxënësit diskutojnë së bashku për materialet e përzgjedhura, të cilat prezantohen nga liderët e grupeve.
### Hapi III: Shkrim i lirë
Çfarë marrëdhëniesh keni me gjyshërit tuaj?

### Vlerësimi
Vlerësohen nxënësit që kanë sjellë shembuj të qartë lidhur me temën. Vlerësohet aftësia për të pranuar opinionet e kundërta gjatë diskutimit.



Filmi dokumentar, si një instrument për përmirësimin e procesit të mësimdhënies, si dhe zhvillimin e të menduarit kritik tek nxënësit trajton tema të ndryshme që evokojnë fenomene të ndryshme sociale.

# Ushtarët që dhunojnë

Përgatitur nga
Arbnesha Kusari, SH. M. "Hajdar Dushi" Gjakovë
Jeta Rexha, SH. M. "Hajdar Dushi" Gjakovë

## Përshkrimi i filmit

Për një kohë të gjatë dhuna seksuale në konflikt është përdorur si një armë e heshtur dhe e efektshme në konfliktet anembanë botës. Historikisht përdhunimi është përdorur si një strategji për spastrim etnik dhe gjenocid, si një mjet për të shkatërruar familjet dhe komunitetet, si një metodë e nxitjes së terrorit dhe nxjerrjes së informacionit.

Për një kohë të gjatë dhuna seksuale ishte pothuajse e padukshme. Të mbijetuarit vuanin në heshtje, të turpëruar për diçka që nuk ishte faji i tyre, të turpëruar nga familjet e tyre, të stigmatizuar, të lënë për t'u përballur me veten dhe gjithmonë pa mirëkuptim dhe ndihmë. Në Republikën Demokratike të Kongos, përdhunimi në masë i grave nga ushtarët, është një armë e pranueshme e luftës. Në filmin dokumentar një numër ushtarësh tregojnë historitë e tyre në një përpjekje për të njohur mizoritë që ata kanë kryer.

## Fushat e kurrikulës
Shoqëria dhe mjedisi

## Përshtatshëm për
Shkallën 4, 5, 6 Klasat IX, X, XII

## Kompetencat
Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit;
Kompetenca e të menduarit,
Kompetenca për jetë, punë dhe mjedis;
Kompetenca qytetare.

## Objektivat
-Aftësim për mësim gjatë gjithë jetës;
-Përgjegjësia ndaj vetës dhe të tjerëve;
-Respektimi i të drejtave të njeriut;
-Evitimi i paragjykime në baza gjinore dhe profesionale.

## Pikat e diskutimit

Shprehjet emocionale a vlejnë të njejta si për gratë ashtu edhe për burrat?
Si e përceptoni termin burrë?
Cilat janë elementet e të qenurit burrë?
Cilat janë stereotipet gjinore më të shpeshta që j'u bëhen burrave dhe grave në shoqërinë tonë?
A është e duhur që profesionet ti ndajmë varësisht prej gjinisë?

## Aktivitetet

### Evokim
Pas përfundimit të filmit, së pari marrim përshtypjet e para për filmin që nxënësit shikuan dhe më pas fillojmë të diskutojmë rreth pyetjeve të lartëshënuara.

### Realizim
Në fazën e realizimit bëjmë diskutim interaktiv me nxënësit rreth çështjeve të ngritura duke e lënë nxënësin në qendër të diskutimit duke replikuar me njëri tjetrin, sugjeruar apo krahasuar në lidhje me temën e filmit. Nxënësit gjithashtu do të jenë të lirë të shprehin opinionet e tyre po gjithashtu të marrin informacione shtesë për tema të caktuara.

### Reflektim
Në fazën e reflektimit nxënësve do t'u jipet detyrë të shkruajnë shkurtimisht reflektimin e tyre mbi diskutimin e bërë.



skano këtu!

https://dokufest-lab.com/al/mesimdhenesit/sociologji

# Sociologji

Filma dokumentarë dhe materiale didaktike për lëndën e Socioloogjisë



Njësia mësimore

Ndërveprimi shoqëror dhe jeta e përdtishme në epokën e internetit.

# Blinera n’rrjet

**Regjia: Laberion Nitaj**

Përgatitur nga
Jehona Luma - Reçica, SH. M. "Ulpiana" - Lipjan

## Përshkrimi i filmit

Filmi dokumentar “Blinera n ‘rrjet” paraqet ndikimin e rrjeteve sociale ne jetën e adoleshentëve, ku tashmë rrjetet sociale janë shndërruar në një “ushqim” të përditshëm për ta.

Shumë të rinjë ditën e fillojnë me një postim në rrjetet sociale. Blerina pohon se postimet lidhen me anën emocionale se si ata ndihen ata. Adoleshentët gjithnjë e më shumë bëhen “të varur” nga interneti. Sepse rrjeti social mundëson të përjetosh shumë përvoja. Duke qëndruar në shtëpi, bën të mundur të krijosh një identitet tjetër, ndoshta krejtësisht të kundërt nga ç ‘janë në të vërtetë. Nuk mund të shihesh sy më sy me bashkëbiseduesin, nuk mund të dëgjohet zëri i tij apo i saj, por rrjeti na lejon të jemi çka duam, ku dhe kur dëshirojmë.

Shumë të rinjë bëhen pjesë e “Social media” sepse dëshirojnë ti bashkohen trendit pa i ditur pasojat. Blerina pohon se “social media” ndodhë të na largojë nga realiteti mirëpo, në vete bart edhe një realitet. Shpesh ka momente ku Blerina mendon mbylljen e rrjeteve sociale, sepse ky rrjet magjik ka filluar të bëhet sfidues për të. Sipas Blerinës sa më shumë “Like” që merr në një fotografi të postuar aq më e “vlerësuar” ndihesh. Megjithatë, marrim gjithmonë parasysh sa më shumë virtualisht të përfshihet një individ, aq më pak e jeton realitetin.

## Fushat e kurrikulës
Shoqëria dhe Mjedisi, Jeta dhe Puna.

## Përshtatshëm për
Shkallën Kurrikulare 5 dhe 6. Klasa XI, XII.

## Kompetencat
I. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit (1. Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike; 2. Komunikimi nëpërmjet teknologjisë informative)

II. Kompetenca e të menduarit (1. Kompetencat digjitale; 2. Vlerësimi dhe vetëvlerësimi)

## Objektivat
Promovimi i vlerave demokratike, kulturore dhe qytetare;
Aftësimi për mësim gjatë gjithë jetës;

## Pikat e diskutimit

Shpjegon nevojën e komunikimit përmes internetit në shekullin XXI?
Sa i përdorni rrjetet sociale?
Cilat janë përparësitë dhe dobësitë e përdorimit të rrjeteve sociale?
A ka parakushte që duhet të zotërojë individi që të mund të futet në rrjet?
Si ndikon përdorimi i rrjeteve sociale ne jetën tuaj?

## Aktivitetet

**Evokim.**
Mësimdhënësi kërkon nga nxënësit që të mendojnë dhe tregojnë se çfarë dinë lidhur me rrjetet sociale. Çfarë rreziku mund të shfaqet te ta nëse janë përdorues të cilët kalojnë kohë të gjatë në rrjete sociale.

**Realizim-kuptimi: Puna në grupe.**
Nxënësit ndahen në grupe Analizojnë dhe diskutojnë lidhur me "rrjetet sociale" gjatë shfaqjes së filmit dokumentar. Secili grup ka për detyrë që të analizojë anët pozitive dhe negative të përdorimit të rrjeteve sociale. Rreziku që shfaqet te ta si rezultat i postimeve të shpeshta, mendjes ndikimi tek gjendja psiko-sociale e tyre.

**Reflektimi: Rrjeti i diskutimit.**
Nxënësit diskutojnë rreth çështjes: A mund të zëvendësojë teknologjia marrëdhëniet e drejtpërdrejta mes njerëzve?



Njësia mësimore

Njeriu si qenie specifike shoqërore

# Faleminderit Afrikë, Faleminderit Ebola

**Regjia: Leart Raka**

Përgatitur nga
Jehona Luma - Reçica, SH. M. "Ulpiana" - Lipjan

## Përshkrimi i filmit

Filmi dokumentar "Thank You Africa, Thank You Ebola" paraqet rrëfimin e djaloshit si një katërmbëdhjetë-vjeçar që babai i tij iu kishte drejtuar me këto fjalë "ti je burri i shtëpisë, kujdesu për nënën dhe fëmijët".

Djali e kuptoi se babai kishte zgjedhur rrugën për në Afrikë më një mision human për t'u dalë në ndihmë mjekëve atje në luftimin e virusit të quajtur Ebola.

Të jesh human do të thotë të mbash qëndrim njerëzor e fisnik dhe të tregosh dashuri të thellë ndaj të gjithë njerëzve pa dallime.

Obligimet e këtij të riu veç sa shtoheshin, por edhe ndjenja e krenarisë për veprën dhe kontributin e babait në luftimin e këtij virusi.

## Fushat e kurrikulës
Shoqëria dhe Mjedisi

## Përshtatshëm për
Shkalla V, VI;
Klasa: XI, XII

## Kompetencat
I. Kompetenca e të menduarit – Mendimtar kreativ (Simulon një situatë për marrjen e një vendimi për jetën e vet ose zgjidhjen e një problemi me interes shoqëror, lidh vendimin me pasojat në mënyrë të përgjegjshme, e prezanton gjatë një debati me moshatarë në një kohëzgjatje të caktuar, duke u bazuar në këtë përvojë merr vendime dhe iniciativa të dobishme për vete, për shkollën dhe më gjerë)
II. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis – Kontribuues produktiv (Merr pjesë ose udhëheq një fushatë të informimit të qytetarëve për një fushë apo temë të caktuar, për përgatitjen e saj mbështetet në idetë progresive dhe në shembujt pozitiv, përgatitjet i prezanton para klasës duke vënë theksin mbi qëllimet dhe rezultatet e pritura nga ky organizim (p.sh., fushatëinformimi për mbrojtjen e mjedisit natyror dhe shoqëror, ose për mënyrat e jetës së shëndetshme etj.).
III. Kompetenca personale – Individ i shëndoshë (Ilustron me shembuj para të tjerëve modelet (praktikat) e sjelljeve që reflektojnë mënyrat e mbrojtjes dhe të kultivimit të kulturës së vet, vlerave, besimeve dhe kulturave të të tjerëve në mjedisin ku jeton dhe me gjerë)
IV. Kompetenca qytetare – Qytetar i përgjegjshëm (Tregon shembuj konkret të mbrojtjes së mjedisit natyror dhe atij të krijuar nga njeriu në aktivitete të jetës së përditshme në shtëpi; klasë, shkollë dhe komunitet, propozon alternativa etj.)

## Objektivat
Kultivimi i identitetit personal, kombëtar, i përkatësisë shtetërore e kulturore.

## Pikat e diskutimit

Si e kuptoni humanizmin njerëzor?
Pse njeriu quhet qenie humane?
Humanizmi është një qëndrim apo qasje në filozofi dhe etikë?

## Aktivitetet

### Hapi I: Stuhi mendimesh
Ç'do të thotë te jesh human?

### Hapi II: Veprimtari me lexim të drejtuar (VLD)
Nxënësve u lihet kohë në dispozicion për të marrë informacionin e nevojshëm nga teksti mësimor. Ata nxiten që gjatë leximit të mendojnë dhe të parashikojnë rreth asaj që po lexojnë. Njohuritë e nxënësve pasurohen me informacione të tjera nga mësimdhënësi që mban gjallë interesin e nxënësve deri në fund të orës mësimore.

### Hapi III: Rrjeti i diskutimit
Duke reflektuar rreth njohurive të ftuara gjatë kësaj orë mësimore, mësimdhënësi nxit në klasë një diskutim rreth çështjes: "Çfarë e bënë një njeri humanist? Nxënësit diskutojnë dhe argumentojnë mendimet e tyre duke sjellë shembuj konkretë për njësinë mësimore.
**Pikat e diskutimit**
Si e kuptoni humanizmin njerëzor?
Pse njeriu quhet qenie humane?
Humanizmi është një qëndrim apo qasje në filozofi dhe etikë?



Filmi dokumentar si një instrument për përmirësimin e procesit të mësimdhënies, si dhe zhvillimin e të menduarit kritik tek nxënësit trajton tema të ndryshme që evokojnë fenomene të ndryshme sociale.

# I kujt është flamuri?

**Regjia: Baris Karamuço**

Përgatitur nga
Driton Mallaku, SH. M. "Gjon Buzuku" Prizren
Fatlume Hyseni, SH. M. "Zenel Hajdini" Gjilan
Jeta Rexha, SH. M. "Hajdar Dushi" Gjakovë
Merita Shala, SH. M. "Ahmet Gashi" Prishtinë

## Përshkrimi i filmit

Dihet se me gjenerata të tëra kanë jap jetën për flamurin kombëtar Kuq e Zi, nuk ka kuptim ta kemi këtë flamur, kur as me referendum, as me votë nuk e kemi pas të drejtën me zgjedhë". Filmi dokumetar "I kujt është flamuri" trajton temën e simbolit të flamurit të shtetit të ri të Kosovës dhe identitetin kosovar.

Gjithashtu në këtë film bëhet gërshetimi i flamurit Kuq e Zi dhe flamurit të Kosovës që njihet si flamur me gjashtë yje, e që ngareh linja paralele në mes të këtyre dy identiteve të përkatësisë kombëtare dhe identitetit.

Gëzuar ditëlindjen Kosovë!

## Fushat e kurrikulës
Gjuhët dhe Komunikimi, Shoqëria dhe Mjedisi

## Përshtatshëm për
Shkallën kurrikulare 5 dhe 6, klasa XI - XII.

## Kompetencat
I. Kompetenca e të mësuarit,
II. Kompetenca qytetare, Kompetenca personale,
III. Kompetencat e komunikimit dhe të shprehurit.

## Objektivat
Kultivimi i identitetit personal, kombëtar, përkatësia etnike. Promovimi i vlerave të përgjithshme kulturore dhe qytetare. Zhvillimi i përgjegjësinë ndaj vetes, ndaj të tjerëve, ndaj shoqërisë dhe ndaj mjedisit.

## Pikat e diskutimit
Identitet kombëtar, etniciteti, dilemat.
Cili flamur e përfaqëson identitetin e qytetarëve të Kosovës?
Përceptimet e qytetarëve lidhur me simbolet e Republikës së Kosovës.
Pranimi ose mohimi i simboleve, konkretisht flamurit të Kosovës nga gjeneratat e reja dhe të vjetra.
Përceptimi i simbolit të flamurit të Kosovës nga komunitetet tjera që jetojnë në Kosovë.
Dashuria për simbolet e shtetit të Kosovës, respekti, krenaria.
Lidhja emocionale me flamurin e Kosovës dhe flamurin Kuq e Zi: si një kujtim dhe marrëdhënie me kombin shqipëtar të cilit i përkasin.
Si kanë ndikuar rrethanat shoqërore në përceptimin dhe pranimin e indentitetit të kosovarëve?
Pjesa përbërëse e historisë në raport me flamurin Kuq e Zi dhe flamurin e Kosovës.
Ndikimi i institucioneve e sidomos ato arsimore në arsimimin e gjeneratave dhe ngritjene vetëdijës për simbolet shtetërore.
Sa i përfaqëson kosovarët flamuri dhe sa e paraqet thelbin e shtetit?
Tekstet shkollore në paraqitjen e historisë së Kosovës deri te shpallja e Pavarësisë dhe krijimit të simboleve shtetërore.

## Aktivitetet
### Evokim – Stuhi mendimesh
Ora e mësimit fillon diskutimin lidhur me dy çështje kryesore për debat: Me cilin flamur identifikoheni dhe cila është përkatsia e juaj etnike? Flamuri kuq e zi apo flamuri i Kosovës me yje? Kosovar apo Shqipëtar? Cila është lidhja emocionale që keni në raport me këta flamuj? Dashuri, respekt, krenari, kujtim, mohim, apati.

### Realizimi – Ditari dy pjesësh
Nxënësit zgjedhin nga një paragrafë nga teksi apo shkëpusin pjesë nga filmi dokumentar, për të komentuar arsyen e zgjedhjes. Më pas i tregohet nxënësve që fleta të ndahet në mes me një vijë vertikale kurse në anën e majtë shkruhen citatet nga teksti, kurse në të djathtë komentet.

### Reflektim - Diskutim në çift dhe grup
Nxënësit ndahen në dy grupe (Pro dhe Kundër) dhe diskutohet çështja e pranimit apo mohimit të flamurit të Kosovës dhe identitetit Kosovar.



Njësia mësimore

Roli i kompjuterit dhe internetit sot;

Koha dhe hapësira në shoqërinë virtuale;

# Jetë brenda ekranit

**Regjia: Art Sylaj**

Përgatitur nga
Jehona Luma - Reçica, SH. M. "Ulpiana" - Lipjan

## Përshkrimi i filmit

Përveç ngacmimit në ambiente shkollore, që është fenomen shumë i përhapur, edhe ngacmimi në rrjetet sociale po ashtu përbën problem serioz në ditët e sotme. Filmi dokumentar "Jetë brenda ekranit" paraqet një fenomen i cili është përhapur shumë në jetën e të rinjve e që është ngacmimi i të rinjve në rrjetet sociale apo bulizmi online që ka mjaft ndikim në psikikën e individit krahasuar me bulizmin e drejtpërdrejtë.

Filmi paraqet raste të cilat ndodhin si raste sulmesh, talljesh dhe ofendimesh që cenojnë personalitetin dhe privatësinë e personit, duke u etiketuar negativisht, duke përdorur dobësi apo hendikap të tyre dhe duke shfrytëzuar faqen apo imazhe për t'u përbaltur moralin dhe dinjitetin.

Përhapja e bullizmit kibernetik (ngacmimit në rrjetet sociale) është shumë e madhe, pasi të pothuajse të gjithë sot kanë të paktën një llogari në rrjetet sociale. Kjo dukuri është shumë më e përhapur tek adoleshentet, të cilët supozohet të kalojnë shumë më shumë kohë se të tjerët në internet. Ky lloj ngacmimi zhvillohen në mënyrë elektronike te personi tjetër. Për shembull kërcënimet e ndryshme në biseda, shpërndarje të fotove të personit në rrjete sociale pa autorizim, të bërit shaka me të etj. hyjnë te ngacmimi në rrjetet sociale.

Pra, me pak fjalë, ngacmimi në rrjetet sociale përfshin çdo lloj fyerje, poshtërimi, përçmimi që i bëhet një personi në këto media.

## Fushat e kurrikulës
Shoqëria dhe Mjedisi

## Përshtatshëm për
Shkalla V, VI.
Klasa XI, XII

## Kompetencat
I. Kompetenca e komunikimit dhe të të shprehurit - Komunikues efektiv (Shpreh mendimin e lirë, opinionin dhe qëndrimin për një temë të caktuar nga jeta, shkenca, shoqëria, duke përdorur forma të ndryshme të komunikimit me gojë me shkrim etj.)

II. Kompetenca e të menduarit (Vlerësimi dhe vetëvlerësimi; Zgjidhja e problemeve)

III. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis (Zotërim i aftësive për menaxhim të konfikteve dhe vlerësim të rreziqeve; Ndërmarrje e veprimeve të pavarura dhe të përgjegjshme)

IV. Kompetenca personale (Dëshmim i aftësive për të bërë jetë të shëndoshë; Bërja e zgjedhjeve të përgjegjshme për shëndetin personal)

V. Kompetenca qytetare – Qytetar i përgjegjshëm (Shpjegon të drejtat, detyrat dhe përgjegjësit e individit në raste të ndryshme, si: në shtëpi, në klasë, në shkollë, në shoqëri, dallon rastet kur hyjnë në konflikt me njëri-tjetrin dhe paraqet alternativa të zgjidhjes së tyre)

## Objektivat
Aftësim për mësim gjatë gjithë jetës;
Përgjegjësia ndaj vetës si dhe shoqërisë;
Krijimi i identitetit personal.

## Pikat e diskutimit
Sa është i përhapur bulizmit kibernetik (ngacmimit në rrjetet sociale)?
Si zhvillohet ky ngacmim?
Cilat janë shkaqet e këtij ngacmimi?
Cilat janë pasojat e ngacmimeve përmes rrjeteve sociale?

## Aktivitetet
### Evokim – Stuhi mendimesh
Në fillim të orës mësimore pyesim nxënësit se çfarë njohurie kanë ngacmimet e të rinjve në rrjetet sociale apo bulizmi online. Bëjmë një hyrje të shkurtër dhe shkëmbejmë pyetje dhe përgjigje rreth asaj se çka kemi në fokus. Më pas shikojmë filmin.

### Reflektim – Rrjeti i diskutimit
Pas përfundimit të filmit marrim mendimet e përgjithshme për filmin, më pastaj së bashku konkludojnë rolin, rëndësinë dhe kujdesin të cilin duhet të kemi gjatë përdorimit të rrjeteve sociale, si dhe rrezikun që mund të kanoset tek të rinjtë.

### Realizim - Shkrim i lirë
Duke u bazuar ne përvojën tuaj personale dhe filmin që e shikuat tregoni rolin dhe ndikimit e rrjeteve sociale që shfaqin rrezik.



Njësia mësimore

Familja, Martesa, Seksualiteti dhe Gjinia

# Ka një mot

**Regjia: Donjetë Berisha**

Përgatitur nga
Jehona Luma - Reçica, SH. M. "Ulpiana" - Lipjan

## Përshkrimi i filmit

Ky rrëfim shqyrton ndërtimin gjinor brenda raporteve të dhunës në familje nga ana e burrave. Dhuna në familje është konsideruar si një plagë e vjetër e shoqërisë, shpesh herë ende e pambyllur, e cila i ka rezistuar zhvillimit që shoqëria ka bërë në mbarë botën. Në realitetin e padëshiruar është e pashmangshme që çdo ditë të mos shënojë një tjetër viktimë, femër, nënë, bashkëshorte apo motër!

Shumë vajza të reja presin me padurim të rriten dhe një ditë të krijojnë familjen e ëndrrave të tyre. Familja ka luajtur gjithmonë një rol të rëndësishëm në shoqërinë dhe
kulturën shqiptare. Por, ndërkohë që mbetet një ndër vlerat më të mëdha, ajo në të njëjtën kohë mund të kthehet në makth për shumë gra. Dokumentari "Ka një mot" rrëfen tmerrin dhe torturë të cilin e përjeton një grua nga bashkëshorti i saj.

Në mungesë të familje konkretisht babait dhe vëllait ajo ishte e pa mbrojtur gjë të cilën viktima u bë objekt i dhunë së papërshkrueshme fizike, emocionale dhe seksuale...

Dhuna ndaj grave dhe vajzave nuk është një fenomen i ri te ne. Ajo ka rrënjë të thella në traditat dhe zakonet patriarkale të cilat i kanë dhënë formën shoqërisë prej kohësh,
përfshirë identitetet dhe rolet e ngurta gjinore, dhunuesit patriarkalë, respektimin e sistemit të nderit dhe turpit, zakonet e urdhrave hierarkike brenda familjes dhe kontrollin midis brezave në familje.

## Fushat e kurrikulës
Shoqëria dhe Mjedisi;
Jeta dhe Puna.

## Përshtatshëm për
Shkalla V, VII;
Klasa XI, XII

## Kompetencat
I. Kompetenca e të menduarit (Vlerësimi dhe vetëvlerësimi. Zgjidhja e problemeve)

II. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis (Zotërim i aftësive për menaxhim të konfikteve dhe vlerësim të rreziqeve. Ndërmarrje e veprimeve të pavarura dhe të përgjegjshme. Angazhim për mbrojtjen dhe zhvillimin e mjedisit)

III. Kompetenca personale (Dëshmim i aftësive për të bërë jetë të shëndoshë. Bërja e zgjedhjeve të përgjegjshme për shëndetin personal)

## Objektivat
Aftësim për mësim gjatë gjithë jetës;
Përgjegjësia ndaj vetës dhe të tjerëve;
Respektimi i të drejtave të njeriut.

---

## Pikat e diskutimit

Si e perceptoni dhunën në këtë film?
A është dhuna pasojë e martesave të hershme?
Patriarkaliteti - dominant në familje dhe shoqëri?
Sa gjejnë përkrahje dhe mbështejte viktimat e dhunës në shoqëri?
Shkurorëzimi a është shpëtim i viktimave të dhunës?
Çfarë roli luajn në jetën e viktimës qendrat strehimore?

## Aktivitetet

### Evokim – Stuhi mendimesh
Në fillim të orës mësimore pyesim nxënësit se çfarë njohurie kanë për anët e errëta të jetës familjare. Bëjmë një hyrje të shkurtër dhe shkëmbejmë pyetje dhe përgjigje rreth asaj se çka kemi në fokus. Më pas shikojmë filmin.

### Reflektim – Rrjeti i diskutimit
Pas përfundimit të filmit marrim mendimet e përgjithshme për filmin, më pastaj së bashku konkludojnë rolin, rëndësinë e ndërtimit të familjes, konteksti i Kosovës në përhapjen dhe luftën kundër dhunës, të drejtën e divorcit si institucion i së drejtës famijare, po ashtu si do të jetë e ardhmja e familjes në dekadat e ardhshme.

### Reflektim - Diskutim në çift dhe grup
Pasi përcaktohemi për pikat e diskutimit i ndajmë nxënsitë në kater grupe ku diskutohet. Grupi i parë do të ketë pikën e diskutimit: Mbrojtja e familjes (Babë, vëlla etj) në parandalimin e dhunës? Grupi i dytë do të ketë pikën e diskutimit: Mungesa shkollimit, pasojë e dhunës në familje dhe shoqëri? Grupi i tretë do të ketë pikën e diskutimit: A konsiderohet shkurorëzimi si problem social apo si e drejtë e individëve për të përfunduar një martesë që nuk funksionon? Grupi i katërt do të ketë pikën e diskutimit: Rëndësia e qendrave strehimore në vendin tonë?



Njësia mësimore

Ndërveprimi shoqëror në hapësirat virtuale

# Kjo është Tringa

**Regjia: Tringa Berisha**

## Përshkrimi i filmit

Përgatitur nga

Jehona Luma - Reçica, SH. M. "Ulpiana" - Lipjan

Gjithnjë e më shumë rrjetet sociale po vjedhin kohën, jetën tonë, ashtu si asnjë formë tjetër e revolucionit teknologjik të realizuar ndër vite. Janë copëza informacionesh që rrezikojnë ta zhysin individin në një botë irracionale, supersticioze dhe jo të vërtetë, ndërkohë që në këto rrjete kemi dhe përmbysje të imazheve dhe fjalëve të shkruara.

Filmi dokumentar "This is Tringa" përshkruan ndikimin e rrjeteve sociale në jetën e të rinjve, duke shtrembëruar realitetin ekzistues me anë të postimit të fotografive në rrjetet sociale. Tringa një vajzë adoleshente ndan historinë personale për të treguar vështirësitë që ka hasur në shoqëri, edhe ajo nuk mund të shmang rëndësinë e ndikimet sociale tek gjendja shpirtërore e saj.

Në këtë film, Tringa mos pranimin social nga të tjerët, mundohet ta mbulojë duke postuar imazhe në rrjetet sociale si një person i lumtur dhe e rrethuar me miq, ndërsa realiteti ka qenë krejt ndryshe nga që ajo përjeton shumë ngacmime verbale, përjashtim nga grupi, diskriminim, përbuzje nga gjithë klasa dhe shoqëria.

## Fushat e kurrikulës
Shoqëria dhe Mjedisi

## Përshtatshëm për
Shkalla V, VI.
Klasa XI

## Kompetencat
I. Kompetenca e komunikimit dhe të të shprehurit - Komunikues efektiv (Shpreh mendimin e lirë, opinionin dhe qëndrimin për një temë të caktuar nga jeta, shkenca, shoqëria, duke përdorur forma të ndryshme të komunikimit me gojë me shkrim etj.)

II. Kompetenca e të menduarit - Mendimtar kreativ (Në forma të ndryshëm prezanton mënyrën e grumbullimit, të zgjedhjes dhe të klasifikimit të informatave për një temë të caktuar, ofron argumente për zhvillimin aktual lidhur me temën përkatëse)

III. Kompetenca qytetare – Qytetar i përgjegjshëm (Shpjegon të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e individit në raste të ndryshme, si: në shtëpi, në klasë, në shkollë, në shoqëri, dallon rastet kur hyjnë në konflikt me njëri-tjetrin dhe paraqet alternativa të zgjidhjes së tyre)

## Objektivat
Aftësim për mësim gjatë gjithë jetës;
Përgjegjësia ndaj vetës si dhe shoqërisë;
Krijimi i identitetit personal.

## Pikat e diskutimit

Çfarë rëndësie ka ndikimi social në vetëvlerësim?
Përdorimi i fotografive a ndikon në imagjinatën tonë se si të tjerët na shohin?
Çfarë është grupi dhe pranimi në grup ?
Bazuar në film, si e shpjegoni efektin e shtrembërimin e realitetit me anë të postimeve të fotografive në rrjetet sociale?

## Aktivitetet

**Evokimi: MPP (Marrëdhëniet Pyetje-Përgjigje)**
Mësimdhënësi/ja nxit në klasë diskutime rreth pyetjeve të mëposhtme: Cili është roli dhe rëndësinë e ndikimit social në krijimin e identitetit personal Përgjigjet më interesante të nxënësve shënohen në tabelë.

**Realizimi i kuptimit: Veprimtari me lexim të drejtuar (VLD) dhe shikimi i filmit.**
Fillimisht nxënësit e lexojnë njësinë mësimore dhe më pastaj ju lëshohet filmi. Nxënësve u lihet kohë në dispozicion për të marrë informacionin e nevojshëm nga teksti mësimor dhe shikimi i filmit i nxit nxënësit ta diskutojnë këtë temë.

**Reflektimi:**
Rrjeti i diskutimit.
Duke u bazuar ne filmin që e shikuat çfarë rëndësie ka faktori social për funksionimin e individit në mënyrë të shëndetshme?



Njësia mësimore

Identiteti gjinor / Gjinitë

# KosovaTrans

**Regjia: Albrim Isufi**

Përgatitur nga
Arbnesha Kusari, SH. M. "Hajdar Dushi" Gjakovë
Fatlume Hyseni, SH. M. "Zenel Hajdini" Gjilan
Feride Thaçi, SH. M. "Ulpiana" Lipjan
Jehona Luma, SH. M. "Ulpiana" Lipjan
Kujtesa Salihu - Keka, SH. M. "Xhavit Ahmeti" Gjilan
Sabina Dishallari, SH. M. "Gjon Buzuku" Prizren

## Përshkrimi i filmit

Ky film dokumentar ka në objektiv çështjen e një adoleshenti transgjinor në Kosovë. Në film është rrëfimi në vetën e parë i një adoleshenti që nga momenti kur vëren shenjat e para që i pëlqejnë gjërat jokonvencionale e deri tek paragjykimet nga shoqëria dhe rrethi. Qysh nga fëmijëria, ky personazh nuk është ndjerë kurrë rehat me të qenurit i gjinisë mashkullore.

Gjithmonë e kanë tërhequr lodrat dhe gjësendet femërore, por duke qenë se është kritikuar nga prindërit e tij si dhe vet është ndjerë konfuz, ka filluar të besoj që është duke bërë gjëra të gabuara dhe të papranueshme për shoqërinë. Me kalimin e viteve, gjendja psikike dhe emocionale e tij është përkeqësuar sidomos në periudhen e pubertetit, kur djaloshi bie në depresion dhe përjeton krizë të identitetit gjinor.
Filmi trajton një temë që është shumë pak e përmendur e lëre më e trajtuar në shoqërinë tonë, kjo edhe paraqitet qartë në film. Së pari, identifikimi personal, vështirësitë në zbulimin e identitetit, pranimi gradual i tij pavarësisht rrethanave dhe ndikimi i faktorëve siç janë familja, shoqëria e mbi të gjtha stereotipet e krijuara për vajza dhe për djem. Protagonisti rrëfen momentin se si është ndjerë kur ka vendosur për herë të parë buzëkuq, një produkt i prodhuar enkas për gra.

Rrëfimi vazhdon me përshkrimin e momenteve kur për herë të parë motra e tij kupton gjendjen e personazhit. Paraqet reagimin e saj fillestar dhe në fund pranimin e të vëllaut si transgjinor, e cila vjenë gradualisht si pasojë e informimit më të madh të saj për këtë realitet. Filmi përfundon me protagonistin i cili kthehet jetës normale duke pranuar realitetin për identitetin e tij/saj.

## Fushat e kurrikulës
Gjuhët dhe komunikimi

## Përshtatshëm për
Shkallën kurrikulare 5, klasa X dhe XI.

## Kompetencat
I. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit (komunikon dhe gjykon në mënyrë të shëndoshë);

II. Kompetenca e të menduarit (zhvillimi i të menduarit kritik, pasurimi me njohuri të reja);

III. Kompeteca qytetare (promovimi i vlerave demokratike dhe qytetare);

IV. Kompetenca personale (zhvillimi i identitetit personal, njohja dhe respektimi i diversitetit).

## Objektivat
Zhvillimi i përgjegjësisë ndaj vetvetës, ndaj të tjerëve (shoqërisë dhe mjedisit); Kultivimi i identitetit personal dhe kombëtar.

## Pikat e diskutimit

Si ndikojnë faktorët social dhe kulturor te koncepti për veten, qëndrimet, paragjykimet, stereotipet?
Krijimi i identitetit gjinor.
Lidhja social-emocionale me personat që na rrethojnë.

## Aktivitetet

### Evokim – Stuhi mendimesh
1. Çfarë njohuri kanë nxënësit rreth identitetit personal dhe identitetit gjinor (kl. XII)? 2. Çfarë kuptoni me pargjykim, stereotipizim dhe diskriminim (kl. XI)?

### Realizimi – Kuptimi
Shikimi i filmit, ditari dy pjesësh, gjatë dhe pas shikimit të filmit nxënësve u kërkohet të mbajnë shenime në formë "citati" dhe komenti".

### Reflektimi
Diskutim në çifte.



Njësia mësimore

Shteti dhe shoqëria, Sistemet politike, Migrimi

# Këta jemi ne

**Regjia: Arta Elezi**

Përgatitur nga
Jehona Luma - Reçica, SH. M. "Ulpiana" - Lipjan

## Përshkrimi i filmit

Filmi dokumentar "Këta jemi ne" është pasqyra më e mirë se si pushteti serb e vijoi zbatimin e fazave të dhunës e të terrorit ndaj shqiptarëve, të shpërnguljes së tyre nga atdheu dhe kolonizimin me elementin serb në Kosovë. Ishte periudha e ndjekjeve, burgosjeve, vrasjeve, shqiptarët arrestoheshin, vriteshin, masakroheshin dhe mbaheshin në burgjet e kampet e ndryshme të Jugosllavisë

Filmi paraqet presionet më të drejtpërdrejta për ndjekjen dhe shpërnguljen e shqiptarëve, helmimin e studenteve, përveç maltretimit të personave të pafajshëm dhe veçanërisht të inteligjencës së pakët dhe punëtorëve të arsimit, që u shpallën armiq të rendit socialist dhe u burgosën, madje një pjesë edhe u pushkatuan pa gjyq.

Siç shihet, presionet për shpërngulje ndaj shqiptarëve ishin aq të shumta e të shumëllojshme, sa jeta e tyre në Kosovë u bë e padurueshme. Prandaj, një numër jo i vogël u detyruan të largoheshin nga vendlindja e tyre me qëllime që një ditë do të ktheheshin në vendlindje për të kontribuar dhe edukuar fëmijët. Përkundër që familja ishte vendos në një shtet te zhvilluar, siç është Gjermania, prapë jeta ishte e vështirë për tu përballur e për tu shikuar si një i "huaj".

Thënia "Guri i rëndë peshon në vend të vet" e gjen përshkrimin më të mirë në këtë film dokumentar. Qysh në ditën e parë që ata u kthyen në vendin e tyre ata e gjetën ngrohtësinë dhe mbështetjen që s'e kishin pas asnjëherë.

## Fushat e kurrikulës
Shoqëria dhe Mjedisi;
Jeta dhe Puna.

## Përshtatshëm për
Shkalla V, VII.
Klasa XI, XII

## Kompetencat
I. Kompetenca e të menduarit (Lidhja e vendimeve me pasojat, Vlerësimi dhe vetëvlerësimi, Zgjidhja e problemeve)

II. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis (Zotërim i aftësive për menaxhim të konflikteve dhe vlerësim të rreziqeve. Ndërmarrje e veprimeve të pavarura dhe të përgjegjshme)

III. Kompetenca personale (Shfaqje e bashkë ndjesisë për të tjerët. Dëshmim i aftësive për të bërë jetë të shëndoshë)

IV. Kompetenca qytetare (Përkrahje dhe nisje e ndryshimeve të dobishme për jetën personale, për tërë shoqërinë dhe për mjedisin)

## Objektivat
Aftësimi për mësim gjatë gjithë jetës;
Promovimi i vlerave demokratike, kulturore dhe qytetare.

## Pikat e diskutimit

Çka dini për burgosjet politike në Kosovë?
A keni dëgjuar për helmimet e studentëve të viteve të '90-ta dhe nga kush janë bërë?
Çfarë vuajtje ka shkaktuar regjimi jugosllave në popullin shqiptar?
Cilat janë pasojat e jetesës në një shtet tjetër?
A e konsideroni gabim kthimin nga shtetet e huaja në Kosovë?

## Aktivitetet

### Evokimi
Mësimdhënësi kërkon nga nxënësit që të mendojnë dhe tregojnë se çfarë dijnë lidhur me burgosjet politike të regjimit jugosllav. Kur kanë ndodhë helmimet e nxënësve dhe nga kush janë helmuar nxënësit atëbotë.

### Realizim kuptimi: Puna në grupe
Nxënësit ndahen në grupe. Analizojnë dhe diskutojnë lidhur me burgosjet politike nga pushteti serb gjatë shfaqjes së filmit dokumentar. Secili grup merr si detyrë që të analizojë shkaqet e burgosjeve, helmimeve dhe dëbimit të shqiptareve nge atdheu i tyre.

### Reflektimi: Rrjeti i diskutimit
Nxënësit diskutojnë rreth çështjes: Si e konsideroni rikthimin e popullatës nga vendet e huaja në Kosovë?



Njësia mësimore

Devijimi dhe sjelljet devijante;

Kontrolli shoqëror i devijimeve.

# Matrix

**Rexhia: Martin Xhoxhi**

Përgatitur nga
Jehona Luma - Reçica, SH. M. "Ulpiana" - Lipjan

## Përshkrimi i filmit

Filmi dokumentar "Matrix" paraqet varësin në një botë të re përmes teknologjisë që nuk njeh moshë në rrugët e Prizrenit.

Filmi paraqet një realitet të ri e me ndikim shumë të madh në jetën antisociale.

Siç shihet, në këtë botë përkundër formave të tjera ku të rinjët janë më aktivë, në këtë film i shohim thuajse të gjitha moshat padallim që përballen me varësinë dhe sjellje antisociale.

Këtu shihen elemente antisociale, si: sharje, agresiviteti, lojëra të papërshtatëshme, momente rebelimi, pasojat e së cilave do t'i shoqërojnë dhe do t'i ndiejnë gjatë gjithë jetës.

## Fushat e kurrikulës
Shoqëria dhe Mjedisi.

## Përshtatshëm për
Shkalla V, VII.
Klasa: XI, XII

## Kompetencat
I. Kompetenca e të menduarit – Mendimtar kreativ (Modelon zgjidhjen e një problemi të dhënë (në klasë, apo jashtë saj) për një temë të caktuar nga një fushë mësimore, duke e zbërthyer në hapa të vegjël dhe jep sqarime të nevojshme për hapat e ndjekur në zgjidhjen e problemit, duke përdorur forma të ndryshme të të shprehurit)

II. Kompetenca personale – Individ i shëndoshë (Merr pjesë ose udhëheq një grup punues që bashkëpunon me përfaqësues të komunitetit për të ndihmuar moshatarët dhe anëtarët e tjerë të komunitetit të cilët kanë probleme shëndetësore, sociale, ekonomike etj, më pas raporton me gojë ose me shkrim për përvojat personale)

III. Kompetenca qytetare – Qytetar i përgjegjshëm (Përshkruan (në formë verbale ose të shkruar) mundësinë e përdorimit të internetit dhe të informative në mënyrë të përgjegjshme për tema të caktuara dhe argumenton domosdoshmërinë e përdorimit të drejtë).

## Objektivat
Zhvillimi i përgjegjësisë ndaj vetes, ndaj të tjerëve, ndaj shoqërisë dhe ndaj mjedisit.

## Pikat e diskutimit
Çka dini për sjellje antisociale?
Kur një sjellje mund të konsiderohet si sociale, e kur si antisociale?
Si trajtohen personat me sjellje antisociale në shoqërinë tonë?
Bazuar në film si kishit vepruar ju në këtë situatë?

## Aktivitetet
### Hapi I: Harta e konceptit
Për të bërë lidhjen me temën e re, mësimdhënësi kërkon nga nxënësit të thonë çfarë dinë rreth termit sjellje asociale dhe varësinë në përdorimin e lojërave kompjuterike.

### Hapi II: Veprimtari me lexim të drejtuar (VLD) dhe shikimi i filmit
Fillimisht nxënësve iu lëshohet filmi dhe pastaj klasa ndahet në dy grupe. Mësimdhënësi i orienton nxënësit të marrin informacion rreth këtyre çështjeve të mësimit. Grupi 1: Identifikimi i sjelljes antisociale? Grupi 2: Numëroni elemente antisociale? Nxënësve u lihet kohë në dispozicion për të marrë informacionin e nevojshëm nga teksti mësimor. Pasi ata e shikojnë edhe filmin besojë që janë të motivuar të mendojnë dhe të parashikojnë rreth asaj që po lexojnë. Kur nxënësit janë gati, ata i diskutojnë informacionet me mësimdhënësin/en. Njohuritë e nxënësve plotësohen me informacione të tjera nga mësimdhënësi/ja.
Duke u bazuar në përvojën tuaj personale dhe filmin që shikuat, tregoni parashikimin tuaj për efektin e lojërave kompjuterike në shoqërinë tonë.



Njësia mësimore

Karakteristikat e jetës së të rriturve (Karakteristikat kryesore të përshtatjës në martesë) (kl. XII)

Të menduarit (Mendimi dhe vendimmarrja për sjellje të suksesshme) (kl. XII)

Seksualiteti dhe Gjinia (Rolet Gjinore) (kl. XI)

# Nën Duvak

**Regjia: Entela Hoxha**

Përgatitur nga
Gyltene Isufi, SH. M. "Zenit" Prishtinë
Arbnesha Kusari, SH. M. "Hajdar Dushi" Gjakovë
Sabina Dishallari, SH. M. "Gjon Buzuku" Prizren

## Përshkrimi i filmit

"Paqi nevojë për mu, aq sa keni për pare" Filmi dokumentar "Nën Duvak" trajton martesën tradicionale në Malësinë e Hasit, se si në të kaluarën vajzat janë martuar. Shikuar në mënyrë kronologjike vajzat dhe gratë në shoqërinë tonë në përgjithësi më shumë kanë shërbyer në kujdesin familjar në përgjithësi, thuajse as pak nuk janë marrë në konsideratë mendimet apo vendimet që kanë të bëjnë me jetën e tyre, siç janë; shkollimi apo martesa.

Tek ky film gjejmë kryesisht se cila ka qenë mundësia në mes të përzgjedhjes apo dëshirave në raport me familjen lidhur me vendimin e martesës, që do të thotë se përzgjedhja e partnerëve për martesë nuk përcaktohej nga dashuria por ishin prindërit ata që vendosni për fëmijët e tyre sa i përket martesës, ku imponimi ndërlidhet si mohimi i të drejtave të njeriut.

Qysh nga fëmijëria vajzat janë rritur me idenë se duhet të hynë në martesë, të krijojnë familje, janë këshilluar brez pas brezi në këtë mënyrë jetese. Kujdesi për mirëqenien e saj, psiko–social, nuk ka ekzistuar, por është krijuar izolimi dhe neglizhimi ndaj dëshirave, qëllimeve dhe ëndrrave të vajzave. E gjithë kjo mund të ketë ndikuar në mos krijimin e identitetit personal dhe përgjithësimin e tipareve të vetëpersonalitetit.

Kur e analizojmë në kontekstin kohor të tanishëm, ajo trajtohet më shumë si vegël materiale dhe shfrytëzuese për familjen ku do të jetoj. Në vazhdimësi të filmit kemi inserte se si gruaja trajtohet si pronë e burrit, e në ato rrethana një gjë e tillë konsiderohet si çështje normale, ku burri është ai që merr vendime për jetën e saj. Krahasimi i jetës familjare dhe i marrëdhënieve martesore në ditët e sotme me ato të priudhave të hershme, tregon se familja ka ndryshuar në mënyrë të dukshme si i përket mënyrës së stilit të jetesës.

## Fushat e kurrikulës
Shoqëria dhe mjedisi, Gjuhë dhe komunikim.

## Përshtatshëm për
Shkallën 4, 5, 6 Klasat IX, X, XII.

## Kompetencat
Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit,
Kompetenca e të menduarit,
Kompetenca për jetë, punë dhe mjedis,
Kompetenca qytetare.

## Objektivat
-Aftësim për mësim gjatë gjithë jetës,
-Promovimi i vlerave kulturore dhe qytetare.

## Pikat e diskutimit

Si e perceptoni martesën në këtë film?
Cili është roli vendimmarrës i personave në këtë film?
Cilat janë pasojat e martesave të hershme?
Krahasimi i martesave në periudha kohore.
Çfarë ndikimi ka imponimi i martesës në gjendjen emocionale?
Mungesa shkollore, pasojë e inferioritetit në shoqëri.
Patriarkaliteti dominant në familje dhe shoqëri.

## Aktivitetet

### Evokim – Stuhi mendimesh
Në fillim të orës mësimore pyesim nxënësit se çfarë njohurie kanë për martesën tradicionale në shoqërinë tonë dikur dhe tani. Bëjmë një hyrje të shkurtër dhe shkëmbejmë pyetje dhe përgjigje rreth asaj se çka kemi në fokus. Më pas shikojmë filmin.

### Realizimi – Këndet
Pas përfundimit të filmit marrim mendimet e përgjithshme për filmin, më pastaj nxënësit i informojmë për referencat që do të marrin në lidhje me filmin, ku do të kenë mundësinë të shënojnë në fletë ndonjë detaj nga ajo që shohin, që do të ju shërbej si pikë reference për diskutim. Ndahen në dy grupe dhe shënojnë pikat e diskutimit që do të realizohen.

### Reflektim
Pasi përcaktohemi për pikat e diskutimit i ndajmë nxënësit në dy grupe ku diskutohet. Grupi i parë do të mbrojë pikën e diskutimit: Martesa bashkëkohore dhe rolet gjinore; Grupi i dytë do të mbrojë pikën e diskutimit: Martesa tradicionale dhe rolet gjinore. Të dy nga grupet, do të mbrojnë gjithë përmbledhjen e diskutimit. Detyrë për nxënësit: Sygjerojmë nxënësit në mënyrë individuale të mbledhin më shumë materiale për këto dy pika diskutimi dhe të reflektojnë me një ese të analizuar me kritikën e tyre.



Njësia mësimore

Familja dhe funksionet e saj;

Seksi dhe gjinia;

Ndikimet kulturore në formësimin e roleve gjinore.

# Pa vlla

**Regjia: Alba Demiri, Genta Sefa**

Përgatitur nga
Jehona Luma - Reçica, SH. M. "Ulpiana" - Lipjan

## Përshkrimi i filmit

Filmi dokumentar "Without a Brother - Pa vlla" paraqet mentalitetin shqiptar për sa i përket lindjes së fëmijëve. Vërtet që prej vitesh është thyer disi tabuja e të kërkuarit patjetër një fëmijë mashkull nga martesa, sidomos në zonat urbane, por nuk kanë të numëruar rastet kur vajza pritet si hidhërim.
Në këtë film paraqitet shoqëria patriarkale me botëkuptime të ngurta të ndërtuara mbi të drejtën zakonore, shoqëri që akoma toleron dhunën në familje, shoqëri që akoma i bën presion gruas me i lindë katër-pesë vajza derisa ta sjellë në jetë një djalë.

Katër gra, një histori e rrëfyer në gjithë Kosovën se si është barra e të qenit vajzë, në familjet pa djem.

Fatmirja, fëmija i nëntë në familje tregon se e gjithë familja e saj e ka pritur me padurim e shumë gëzim lindjen e një djali, kjo për shkak se familja kishte shtatë vajza e një djalë e që ardhja e saj në jetë e bëntë vajzen e nëntë në familje, e që sipas motrës së madhe nuk e meriton pagëzimi me emrin Fatmire pasi që ishte vajzë.

Rrëfimi i Gentës si fëmija i parë dhe i vetëm në familje përshkruan ndjenjën e "fajit" që ishte vajzë e nuk ishte djalë për t'i përmbushë kërkesat e familjes dhe rrethit.

## Fushat e kurrikulës
Shoqëria dhe Mjedisi

## Përshtatshëm për
Shkalla V, VI.
Klasa XI, XII

## Kompetencat
I. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit – Komunikues efektiv (Diskuton në mënyrë konstruktive (në gjuhë amtare dhe/ose në një gjuhë të huaj) me moshatarët dhe të rriturit për tema me interes mësimor, shoqëror ose nga jeta e përditshme, duke bërë pyetje, përgjigje dhe duke veçuar informacionin kryesor)

II. Kompetenca e të menduarit – Mendimtar kreativ (Modelon zgjidhjen e një problemi të dhënë (në klasë, apo jashtë saj) për një temë të caktuar nga një fushë mësimore, duke e zbërthyer në hapa të vegjël dhe jep sqarime të nevojshme për hapat e ndjekur në zgjidhjen e problemit, duke përdorur forma të ndryshme të të shprehurit.

III. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis – Kontribuues produktiv (Harton një projekt (individualisht ose në grup) për organizimin e një aktiviteti me karakter
edukativ brenda ose jashtë shkollës, në të cilin identifikon dhe vlerëson resurset e nevojshme njerëzore dhe materiale që mundësojnë arritjen e objektivave të caktuara)

## Objektivat
Kultivimi i identitetit personal, kombëtar, i përkatësisë shtetërore e kulturore

## Pikat e diskutimit
Çdo të thotë të jesh djalë/vajzë në familje?
Cila është barra e të qenit vajzë, në familjet pa djem?
Me çfarë paragjykime përballen familjet që kanë veç vajza?
Bazuar në film, si mund t'i kapërcejmë të streotipet gjinore?

## Aktivitetet
**Hapi I: Harta e konceptit.**
Mësimdhënësja u drejton pyetje nxënësve, për të marrë përgjigje rreth konceptit: Çfarë kuptoni me përbërjen e familjes?

**Hapi II: Veprimtari me lexim të drejtuar (VLD).**
Klasa ndahet në tri grupe. Mësimdhënësja i orienton nxënësit të marrin informacion rreth çështjeve të mësimit. Grupi 1: Funksioni biologjik -riprodhues në familje. Grupi 2: Në këndvështrimin social dëshira për të mos pasur vajza në familje? Grupi 3: Emri si mënyrë "që të na ndalet lindja e fëmijeve vajza". Nxënësve u lihet kohë në dispozicion për të marrë informacionin e nevojshëm nga teksi mësimor. Ata nxiten që gjatë leximit të mendojnë dhe të parashikojnë rreth asaj që po lexojnë. Pasi nxënësit janë gati, ata i diskutojnë informacionet me mësimdhënësin/en. Njohuritë e nxënësve pasurohen me informacione të tjera nga mësimdhënësi/ja.

**Hapi III: Shkrim i lirë.**
Mentaliteti këtu, e kërkon që të kesh një djalë patjetër?



Njësia mësimore

Filmi dokumentar si një instrument për përmirësimin e procesit të mësimdhënies, si dhe zhvillimin e të menduarit kritik tek nxënësit trajton tema të ndryshme që evokojnë fenomene të ndryshme sociale dhe kulturore.

# Rrëfimet e Emigrantit

**Regjia: Gazmir Lame**

Përgatitur nga
Gyltene Isufi, SH. M. "Zenit" Prishtinë
Jeta Rexha, SH. M. "Hajdar Dushi" Gjakovë
Merita Shala, SH. M. "Ahmet Gashi" Prishtinë

## Përshkrimi i filmit

Filmi dokumentar "Rrëfimet e emigrantit" trajton fenomenin e migrimit gjatë periudhës së migrimeve masive në vitin 2014 / 2016 në Kosovë. Papunësia dhe gjendja e rëndë ekonomike si dhe mungesa e perspektivës kanë ndikuar që shumë të rinjë të mësyejnë rrugët e Europës. Migrimet e para të shqiptarëve datojnë nga kohët më të lashta, por janë të njohura dyndjet masive në periudha të ndryshme përgjatë historisë.

Si shumica e qytetarëve të Kosovës në mungesë të liberalizimit të vizave dhe lëvizjes së lirë në vendet e Bashkimit Europian edhe Lundrimi është njëri ndër ata që nuk e ka bërë asnjë hap jashtë Kosovës, e që udhëtimi me autobus natën për në Serbi është vërtetë stresues. Kjo ishte dita më stresuese dhe më e gjatë për Lundrimin, edhe pse ai shfaq përsëri durim ani pse 10km. rrugë për në Suboticë dhe se kalimi nga Serbia për Hungari përmes malit është i rrezikshëm dhe mund të arrestohet nga policia. "Kurrë nuk përfundon," ofshan Lundrimi gjersa tymi i cigarës i'a mbulon fytyrën e dëshpëruar.

Çfarë ndodhë me migrantët kur nuk kanë para më? Lundrimi është i dëshpëruar, pa para, dhe nuk ka para për taksi për ta dërguar në kufi...

Lundrimi më në fund është me fat, takon një trafikant emigrantësh në stacion i cili ka ardhë më i marrë disa refugjatë... Largimi i qytetarëve të Kosovës për në vendet e Bashkimit Evropian vazhdon edhe sot e kësaj dite, mirëpo përmes marrjes së vizave të punës. Sfidë për autoritetet shtetërore është riatdhesimi i të ikurve dhe ripranimi i tyre në bazë të standardeve që i kërkon BE-ja.

## Fushat e kurrikulës
Shoqëria dhe mjedisi, Gjuhë dhe komunikim.

## Përshtatshëm për
Shkallën 5, 6

## Kompetencat
I. Nxënës i suksesshëm,

II. Mendimtar kreativ,

III. Komunikues efektiv.

## Objektivat

Promovimi dhe kultivimi i vlerave kulturore dhe qytetare, Përgjegjësia ndaj mjedisit, Përdorimi i teknologjisë, Aftësimi për punë dhe jetë.

## Pikat e diskutimit

Migrimet e shqipëtarëve në periudha të ndryshme kohore (Historiku i migrimeve).
Motivet që ndikojnë në migrimin e njerëzve.
Migrimet e jashtme/brendshme përkohshme/përhershme.
Faktorët (shkaktarët) e migrimeve.
Pasojat e migrimeve.
Asimilimi dhe format e shprehjes së tij.
Mungesa e përspektivës te të rinjët.
Orientimi në tregun e punës.
Ballafaqimi me kultura/realitet tjetër.
Integrimi/Riintegrimi.

## Aktivitetet

### Evokim – Stuhi mendimesh
1. Tendencat e njerëzve për lëvizje gjeografike dhe sociale. 2. Cilët janë faktorët që ndikojnë që individi apo grupi të migrojnë? 3. Pasojat e migrimeve: demografike, ekonomike, sociale, kulturore dhe politike. 4. Asimilimi dhe shembuj të funksionimit të modelit të asimilimit.

### Realizimi – ndahen nxënsit në grupe
1. Migrimet për shkaqe/arsye shkollimi/arsimimi si dhe pasojat. 2. Migrimet për shkaqe/arsye ekonomike/politike si dhe pasojat. 3. Migrimet për shkaqe/arsye konflikti/luftëra si dhe pasojat. 4. Migrimet për shkaqe sociale/kulturore si dhe pasojat.

### Reflektim - Pesëvargëshi
1. Emër. 2. Dy mbiemra. 3. Folje. 4. 1 fjali/mesazh. Shkrim i lirë: Arsyet pse duhet ne duhet të qëndrojmë në Kosovë?



Filmi dokumentar si një instrument për përmirësimin e procesit të mësimdhënies, si dhe zhvillimin e të menduarit kritik tek nxënësit trajton tema të ndryshme që evokojnë fenomene të ndryshme sociale.

# Rrëfimi

**Regjia: Ashish Ghadiali**

## Përshkrimi i filmit

Përgatitur nga
Merita Shala, SH. M. "Ahmet Gashi" Prishtinë

"Ky është vendi im, pse ka rëndësi të ma kujtoni këtë" Filmi dokumentar "The Confession" është një histori e bazuar në jetën e Mozzam Begg i cili përmes një interviste sjellë fakte rreth jetës së tij, ku është rritur duke përjetuar kriza identiteti dhe etiketimi duke i thënë "Paki go home".

Moazzam Begg ka lindur në Birmingham, djalë i një menaxheri bankash që emigroi në Britani nga Pakistani. Ai ishte arsimuar në një shkollë hebraike dhe pyetja e tij për identitetin e tij dhe vendimin për të përqafuar Islamin përputhej me trazirat e mëdha në botë, nga pastrimi etnik në Bosnje deri në sulmet e 11 shtatorit.

Gjatë intervistës së tij në dokumentar, Begg shpjegon përfshirjen në konflikte të armatosura, duke filluar nga vizita e tij në Bosnje dhe Hercegovinë, Çeceni, Afganistan për të përfunduar në Siri. Meqenëse Begg është i përfshirë në organizata botërore nga muxhahedinët në Bosnje e deri në grupin e talibanëve në Afganistan, ai shihet si person islamik radikal i dhunshëm dhe i rrezikshëm në sytë e Britanisë së Madhe. Mirëpo Begg pohon se bashkimi me organizata ka qenë për kurreshtje, për të eksploruar, studiuar përreth këtyre vendeve. Ai pohon se nuk iu bashkua grupit të talibanëve, thjeshtë dëshironte të rrinte, jetonte me ta, meqenëse kishte dëgjuar se talibanët nuk lejonin shkollimin/edukimin e vajzave/grave, gjë që sipas përvojës së tij nuk ishte e vërtetë, sepse ata lejonin shkollimin e tyre. Gjithashtu ai kundërshtonte dhe nuk pajtohej me al-Kaidan, e njohur si organizatë terroriste dhe ishte zë i fuqishëm kundër ISIS.

Begg është arrestuar në vitin 2001 nën akuza për vepra terroriste, akuza që janë hedhur poshtë nga gjykata, ku është vërtetuar pafajësia e tij, dhe asnjëherë nuk është dëshmuar e kundërta, nuk kishte prova që kishte kryer ndonjë krim, aludohej në alibi. Megjithatë ai thotë "Unë nuk jam antishtet, shteti është anti unë" duke i rikujtuar torturat psikologjike, fizike, kërcënimet dhe shantazhimin, panikun e përjetuar, rikthimin në familje e komunitet, pas qëndrimit në burg përreth tri vitesh.

## Fushat e kurrikulës
Shoqëria dhe mjedisi, Jeta dhe puna, Gjuhët dhe komunikimi.

## Përshtatshëm për
Shkallën kurrikulare 5 dhe 6, klasat XI -XII.

## Kompetencat
I. Kompetenca e të mësuarit,
II. Kompetenca qytetare,
III. Kompetenca personale,
IV. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit.

## Objektivat
Bazuar në Kurrikulën e re të Kosovës objektivat që synohen të arrihen përmes këtij filmi dokumentar janë: Promovimi i vlerave demokratike, kulturore dhe qytetare, Aftësimi për mësim gjatë gjithë jetës, Zhvillimi i identitetit personal dhe njohja dhe respektimi i identiteteve dhe përkatësive të ndryshme sociale, etnike, gjinore, fetare, sekulare, racore, kulturore etj.

## Pikat e diskutimit

Identiteti dhe kriza e tij. Kush jam unë? Ku jam duke shkuar? Humbja e identitetit. Zgjedhja e krizes së personalitetit?
Si identifikohemi: në bazë të gjinisë, nacionalitetit, përkatësisë etnike, religjionit, background-it familjar, kulturës etj.
Izolimi nga moshatarët, familja, shoqëria.
Radikalizimi - rrymë dhe qëndrim politik, synimi i fjalës "Radikalizëm".
Koncepti i terrorizmit dhe metodat e tij.
Çka konsiderohet "Ekstremist" apo "Radikal".
Përdorimi i termit "Radikal"- etiketimi, manipulimi dhe përjashtimi.
Motivet e bindjeve radikale.
Faktorët që ndikojnë në rritjen e rrezikut dhe kërcënimi nga radikalizimi.
Pasojat e radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm si dhe parandalimi.
Toleranca fetare dhe format ekstreme të Islamit.
Torturat fizike/ psikike.
Ndikimi i medias dhe "Propagandës" në botë.
Pikat e forta, dobësitë, mundësitë dhe rreziqet e radikalizimit në kontekstin social dhe kulturor në Kosovë.

## Aktivitetet

### Evokim – Stuhi mendimesh
Mësimdhënësi kërkon nga nxënësit që në fletët e tyre të vendosin nocionet psh, identitet, radikalizëm, ekstremizëm etj. Pastaj kërkon nga nxënësit që të japin mendimet dhe idetë e tyre që janë të lidhura me temën si dhe bëjnë degëzimin e tyre. Nxënësit mendojnë individualisht për temën dhe mund të punojnë në çifte apo grupe. Ata pastaj japin idetë dhe njohuritë e tyre për temën, si dhe bëjnë shkëmbimin e ideve të tyre në grup.

### Reflektim – Rrjeti i diskutimit
Së bashku konkludojnë rolin, rëndësinë e personalitetit dhe ndikimin që ka në shoqëri, rolin e familjes, shkollës dhe masmediave në nxitjen/ parandalimin e radikalizmit/ekstremizmit të dhunshëm, riintegrimin në familje, shoqëri, toleranca fetare, konteksti i Kosovës në përhapjen dhe luftën kundër radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm etj. Vlerësimi: Vlerësimi i nxënësit mbështet në rezultatet e të nxënit në kompetencat e fushës sipas temës mësimore. Vlerësimi është i vazhdueshëm dhe formues.

### Realizimi
Ndërtimi i njohurive të reja. Mbajtja e strukturuar e shënimeve (krahaso-dallo), harta e konceptit: Klasa ndahet në grupe, mësimdhënësi drejton nxënësit të analizojnë pjesë të caktuara të filmit (paragrafë/fjali) me qëllim dallimin e situatave varësisht nga konteksti social dhe kulturor në Kosovë.



Njësia mësimore

Familja, martesa, seksualiteti dhe gjinia.

# Shokët e mi

**Regjia: Gentrit Kastrati**

Përgatitur nga
Jehona Luma - Reçica, SH. M. "Ulpiana" - Lipjan

## Përshkrimi i filmit

"Shokët e mi" është një rrëfim i shkurtë mbi jetën e një adoleshenti, viktimë e bullizmit në Kosovë. Bullizëm konsiderohet ajo dukuri ku një/disa individë përdorin lëndimin si mënyrë për të dëmtuar vetëvlerësimin e viktimës.

Një person përfshihet në bullizëm kur ekspozohet vazhdimisht dhe për një periudhë kohe ndaj veprimeve negative, nga një apo më shumë personave. Bullizmi është një dhunë e zgjatur, fizike apo psikologjike, nga një person apo grup personash, e drejtuar ndaj një personi cili nuk mund të mbrohet në atë situatë. Bullizmi është ajo situatë ku një person përdor forcën në mënyrë të qëllimshme, me synimin për të lënduar tjetrin në mënyrë të përsëritur; është dëshirë e ndërgjegjshme për të lënduar dhe për të vendosur tjetrin nën stres.

Në këtë rrëfim kemi të përfshirë ofendimet, talljet, të folurin si ngacmim seksual. Viktima e këtij lloji të bullizmit tregon se si e ka vuajtur këtë gjersa ishte në shkollë fillore e me shpresë që në shkollimin e mesëm nuk do t'i përsëritet gjë e cila nuk ndodhi.

Tipet e bullizmit janë:

-Fizike-goditja, pengimi, shkelmi si dhe shkatërrimi i një prone të fëmijës
-Verbale-tallja, ngacmimi, komente të papërshtatshme
-Psikologjike ose sociale-shpërndarja e thashethemeve mbi fëmijën, vënia në lojë në publik, përjashtimi nga një grup.
-Elektronike-bullizmi online përfshin të gjitha mediumet elektronike si email-i, ueb faqet, rrjetet sociale, mesazhet, videot, etj. të përdorura për kërcënim ose lëndim.
-Të përballesh me një agresor është e vështirë për çdo adoleshent sidomos në ambientet e shkollës.
-Gjetja e një shoku që e mbështet ishte e vështirë, mirëpo mbështetjen me te fuqishme për të dal nga kjo gjendje e gjeti tek shokët virtual, të cilët e bën të ndihet i vlerësuar.

## Fushat e kurrikulës
Shoqëria dhe Mjedisi, Jeta dhe Puna.

## Përshtatshëm për
Shkallën Kurrikulare 5 dhe 6. Klasa XI, XII.

## Kompetencat
I. Kompetenca e të menduarit (Zgjidhja e problemeve)
II. Kompetenca personale (1. Shfaqje e bashkë ndjesisë për të tjerët; 2. Bërja e zgjedhjeve të përgjegjshme për shëndetin personal)
III. Kompetenca qytetare (1. Mirëkuptim dhe respektim i dallimeve ndërmjet njerëzve; 2. Tolerancë dhe respekt për të tjerët)

## Objektivat
Zhvillimi i përgjegjësisë ndaj vetes, ndaj të tjerëve, ndaj shoqërisë dhe ndaj mjedisit.

Aftësimi për mësim gjatë gjithë jetës.

## Pikat e diskutimit

Çka është bullizmi?
Cilët janë tipet e bullizmit?
Përse ndodhë bullizmi?
Cilët janë shkaqet dhe pasojat që shfaqet bullizmi?
Si kishit vepruar nëse shoku/shoqja juaj kishte qenë viktimë e bullizmit?
A keni qenë ndonjëherë viktimë e bullizmit?

## Aktivitetet

**Stuhi mendimesh. (5 minuta)**
1. Çfarë njohuri kanë nxënësit rreth dhunës? 2. Çfarë kuptoni me bullizëm?

**Realizim kuptimi. (30 minuta)**
Shikimi i filmit, ditari dy pjesësh, gjatë dhe pas shikimit të filmit nxënësve u kërkohet të mbajnë shënime në formë "citati" dhe "komenti".

**Reflektimi. (10 minuta)**
Diskutim në çifte.

## EDUKIM PËR BARAZI

Ky grant përkrahet nga "Programi i shoqërisë civile për Kosovë dhe Shqipëri" i financuar nga Ministria e Punëve të Jashtme të Norvegjisë dhe menaxhohet nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) në bashkëpunim me Partnerët shqiptarë për Zhvillim dhe Ndryshim (PA).

Norwegian Embassy

KCSF

FONDACIONI KOSOVAR PËR SHOQËRI CIVILE
KOSOVAR CIVIL SOCIETY FOUNDATION